PAQJA



REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti VI. Nr. 52. 19 mars - 19 prill 2011. Organ i Shoqatës Kulturore "Zëri Ynë" Çmimi 0.80€

Editorial
PSE TANI RUFI OSMANI?

Isa Mehmeti
KONSUMATOR, ÇFARË TË TË THEM?

Festim Rizanaj
SATANIZMI - IDEOLOGJI E DHUNËS

Intervistë me zv.kryeministren, Edita Tahiri

BISEDIMET ME SERBINË, VETËM PËR ÇËSHTJE PRAKTIKE




MREKULLITË
E
KUR'ANIT
SUKSESI I
GARANTUAR



FILOZOFIA
JONË
Islami
besim, ligj, kulturë dhe qytetërim


JETA
DHE
VDEKJA
E MIRA
DHE
E KEQJA


VIOLETË KOKOLLARI
SHPRESA RILIND


Flamur Maloku
Shtresimet
e
tekstit


Blerim HALILI
Çasti
bën
Çudira
Zëri Ynë
Prishtinë, 2008


SYHEJL HAVOLLI
LITAR LOTËSH



Sadbere Hashani
Fitorja është imja



MILAZIM KRASNIQI
VEPRA
Drama


Milazim KRASNIQI
NË ÇFARË KOSOVE DO TË JETOJMË
SPROVA E NJË GAZETARIE KOMENTUESE


Nexhat Ibrahimi
Aspekte të marrëdhënieve
islamo-kristiane
në Mesjetë


Milazim KRASNIQI
E vërteta e Islamit
ndër shqiptarë
Prishtinë, 2006


TË TJERËT
për
ISLAMIN
Ajni Sinani


Grup autorësh
HUTBE
Ramazani


ISLAMI I KEQKUPTUAR
DHE
FATKEQËSIA BOTËRORE
Dr. Milazim Krasniqi


Kronologji
e Historisë
Islame


Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE

përmbajtja


6 Ngritja e çmim-eve shqetëson...

Portreti i muajit: Formon Rilindjen Demokratike Kombëtare 2

Avni Avdiu: Pse tani Rufi Osmani? 3

Lulzim Ahmeti: Shënohet rënie e investimeve të huaja 4-5

Fatos Shala: Ngritja e çmimeve shqetëson qytetarët 6

Isa Mehmeti: Konsumator, çfarë të të them? 7

Drita Vitia: Edukatoret paguhen më së paku nga shteti 8

Fatos Rushiti: Gutenbergët shqiptarë 9-10

Flamur Hyseni: Neni i 86 i Kushtetutës 10-11

Milazim Mustafa: Konvertimi i të rinjve maqedonas në fenë islame 12-13

Mimoza Sinani: Diktati i laicizmit në demokraci 14-17

Intervistë me Edita Tahirin 18-19

Gëzim Qerimi: Revista 'Paqja' në Malajzi 20-21

Japonia e mbërthyer nga tërmetet dhe cunami 22-23

Milazim Krasniqi: Qelia e zbrazët në Sheveningen duhet të mirëpresë Gadafin 24-25

Arsim Jonuzi: Jemeni 25-26

Intervistë me Murad Hofmann 27-29

John Esposito: A kërkon fillimi i ri në Egjipt një kuadër të ri në marrëdhëniet SHBA – Lindje e Mesme? 30-31

Bernard Tahirbegolli: Në përkujtim të prof. dr. Nexhmetin Erbakanit 32-34

Gloria Aliaj: Një talent që premtonte shumë 35

Naser Shatrolli: Një sapun jete për të gjitha moshat 36

Festim Rizanaj: Satanizmi-ideologji e dhunës 37-38

Artan N. Bejta: Hani e pini, po mos e teproni! 38-39

Alban Bilalli: Orebro mbështetet tek sulmuesit shqiptarë 40


10 Neni i 86 i Kushtetutës


12 Konvertimi i të rinjëve...


32 Në përkujtim të Erbakanit


38 Hani e pini, po mos e teproni!

PAQJA



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti VI / Nr. 52
19 mars - 19 prill 2011
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!



Porterti i muajit

FORMON RILINDJEN DEMOKRATIKE KOMBËTARE

Rilindja Demokratike Kombëtare' quhet partia e re në Maqedoni, e themeluar pikërisht nga Rufi Osmani, i cili pretendon të fitojë 20 deputetë. "Do ta mundi BDI-në e Ali Ahmetit", - është prononcuar Osmani plot optimizëm, duke shtuar se 'partitë e tjera as që i llogarit". Përderisa partia është në konstituim e sipër të degëve e nëndegëve anekënd Maqedonisë, gjegjësisht viseve të banuara me shqiptarë, ky subjekt i ri hyn në zgjedhjet e parakohshme të paralajmëruara, pas një pakënaqësie të përgjithshme në Maqedoni. Pakënaqësia ka arritur kulmin sidomos te shqiptarët, të cilët viteve të fundit janë provokuar së tepërmi nga qeveria Gruevski, pjesë e së cilës është edhe partia shqiptare BDI, e cila doli fituese e zgjedhjeve të fundit parlamentare (2008), por pa fuqi ndikuese në pushtet për shkak se VMRO-DPMNE arriti të marrë numrin e mjaftueshëm të deputetëve sa të formonte edhe vetë qeverinë. Tani VMRO-DPMNE ushtron pothuajse pushtet të gjithanshëm shtetëror: kryeministrin, kryetarin e parlamentit dhe presidentin. Pritet që zgjedhjet e parakohshme, së paku, ta çekuilibrojnë këtë pushtet. Mbetet të shihet gjithashtu edhe forca e subjektit të ri shqiptar, pas zhgënjimit të madh me partitë e deritanishme. Sipas të gjitha gjasave, PDSH-ja e Menduh Thaçit do të minimizohet edhe më tepër, BDI-ja e Ali Ahmetit nuk do ta ndiejë komoditetin e dikurshëm, kurse partia e re e Rufi Osmanit pritet të fitojë numrin e konsiderueshëm të deputetëve. ■

BIOGRAFIA:

Rufi Osmani lindi më 20 gusht 1960 në Çajlë, në komunën e Gostivarit. Më 1983 kreu fakultetin ekonomik në Universitetin e Prishtinës, ku u shqua si student i dalluar. Më vitin 1994 u zgjodh deputet në Kuvendin e Maqedonisë. Dy vite më pas dha dorëheqje nga posti i deputetit pasi u kandidua dhe u zgjodh kryetar i Gostivarit, post të cilin e ushtroi me ndërprerje deri në prill të vitit 1998. Pas plot 6 muajsh rezistence institucionale dhe demokratike në funksion të legalizimit të flamurit kombëtar shqiptar, me rastin e ngjarjeve tragjike të 9 korrikut të vitit 1997, u arrestua dhe u dënua me 14 vite burg, gjegjësisht 7 vite burg në instancën e dytë gjyqësore. Pas miratimit të Ligjit për Amnisti në vitin u 1999 u lirua nga burgu, duke kaluar afërsisht 2 vite në burgjet e Maqedonisë. Më 2002 i përfundoi me sukses studimet pasuniversitare dhe mori titullin magjistër i shkencave ekonomike. Në janar të vitit 2005 mbrojti me sukses tezën e doktoratës me temë "Bashkëpunimi i Shqipërisë dhe Maqedonisë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, një analizë krahasimore" dhe mori titullin doktor i shkencave ekonomike. Që nga themelimi i Universitetit të Tetovës, në vitin 1994, ka qenë i inkuadruar në strukturat e financimit dhe në procesin mësimdhënies si ligjërues, deri në vitin 2003. Aktualisht punon si profesor në Universitetin e Evropës-Juglindore në Tetovë dhe udhëheq biznesin privat në kuadër të kompanisë familjare "Ardian", me seli në Gostivar. Në zgjedhjet e 22 marsit 2009 kandidoi për kryetar komune në Gostivar dhe fitoi bindshëm ndaj kundërkandidatëve të partive të tjera. Ka të publikuara shumë punime profesionale, shkencore dhe publicistike në revista lokale dhe rajonale nga lëmi i ekonomisë, politikës dhe arsimit. "Mendimi alternativ politik dhe ekonomik" është libri i tij i parë, ndërsa "Kontabiliteti menaxherial" është një libër universitar i prof.dr. Rufi Osmanit. Specializimi i ngushtë, në bazë të përvojës profesionale, lidhet me financën dhe kontabilitetin, ndërsa në bazë të hulumtimeve shkencore me financat ndërkombëtare dhe tranzicionin ekonomik.

Pse tani Rufi Osmani?


Avni AVDIU

Për nga natyra gjithnjë jam prirë të anoj nga partitë më radikale në Maqedoni, duke pasur parasysh faktin se sa më me kërkesa maksimaliste që del një parti në një shtet multinacional e multikonfesional, aq më shumë ka gjasa t'i realizojë objektivat në rrafshin politik. Dalja në skenë e PPD-së, menjëherë pas pluralizmit, ngazëlleu çdo shqiptar. Ishte shpresë e madhe se kjo parti do ta rikthente sadopak dinjitetin e nëpërkëmbur nga komunistët maqedonas, të cilën nën Maqedoninë jugosllave mbyllën shkollat shqipe, rrënuan muret e shqiptarëve, burgosën e torturuan shumë shqiptarë etj. etj. Shpresa ishte se me demokratizimin e Maqedonisë gjërat do të ndryshonin për të mirë. Për fat të keq, nga PPD-ja nuk doli ajo që pritej. Kreu i saj Nevzad Halili doli të ishte një amator në politikë dhe nuk arriti t'i shtrëngonte dizgjinët. Partia kalëronte ngarkuar me dy hejbe: njëra e mbushur me kërkesa kombëtare e tjetra me apetite të sëmura karrieriste të anëtarëve të saj, e cila peshoi më shumë dhe mori anë; e sinonim i së cilës u bë kryetari i mëpasshëm i saj, Abdurrahman Aliti. Ndodhën shumë ngjarje të rënda antishqiptare, kurse kërcënime serioze nga partneri shqiptar i koalicionit nuk kishte. Mjaftoi një bombë nga TVSH-ja për ta shkapërderdhur këtë parti të brishtë, pothuajse ende pa u konsoliduar si e sa duhet. Nga trungu i saj u shkëput fraksioni që më pas u quajt PPDSH, i shndërruar në parti me akronimin PDSH. Ana ideore e këtij fraksioni udhëhiqej nga Arbër Xhaferi (Marksi), kurse ajo praktike nga Menduh Thaçi (Engelsi). Sikurse mësonin klasikët e dikurshëm për radikalizimin e klasës punëtore përmes revolucionit dhe bashkimin e proletariatit për mposhtjen e borgjezisë, po me aq pasion tandemi Xhaferi-Thaçi proklamonin zgjimin e ndjenjave kombëtare, duke i stimuluar ato me këngë patriotike të Ilir Shaqirit dhe me ovacione 'shqip e vetëm shqip', me qëllim të zhbërjes së nomenklaturës së PPD-së. Natyrshëm kjo strategji kishte efektin e vet dhe gradualisht kjo parti e plandosi përtokë PPD-në. Mjerisht, më pas, u dëshmua se sloganet u përdorën sa për hallo efekt parazgjedhor dhe nuk kishin as lidhjen më të vogël pragmatike aty ku duhej e pritej – në qeveri. Për fat të keq, në një linjë me PPD, edhe kjo parti nuk iu kërcënua asnjëherë partnerit të koalicionit me lëshimin e qeverisë: u kall a u shkrumbua në popull. Rrjedhimisht plasi lufta. Dhe për këtë askush nuk mund të jetë më fajtor se sa partitë shqiptare në pushtet deri në 2001. Lufta filloi në mënyrë difuze (Tetovë – Kumanovë) dhe konfuze (s'dihej realisht çfarë kërkohej: filloi për territor dhe përfundoi në insistimin konsekuent për ruajtjen e integritetit territorial të Maqedonisë).



Nëse krahasohet lufta e serbëve në Bosnjë dhe pozita e serbëve në Kosovë me pozitën dhe me humbjen e përfitimin e shqiptarëve në Maqedoni, njeriu e ka vështirë a të qajë a të qeshë, a në histeri t'i kombinojë së bashku të dyja. Pas plot dhjetë vjetësh lufte, një marrëveshje me garanci ndërkombëtare po zvarritet sa për gjynah. Sado zjarr tash të hedhin të tjerët dhe benzinë mbi të (p.sh: enciklopedia, kisha në kala etj.), ish-luftëtarët pozicionohen si katalizatorë, qetësues e stabilizues. Kjo rokadë paradoksale që transformoi ish-luftëtarët në qetësues e paqtues të devotshëm, kërkon analizë të thellë psikologjike dhe sociologjike. Ajo çka është faktike dhe shumë e qartë të konstatohet me argumente të pamohueshme është se pozita e shqiptarëve vazhdon të jetë e pavolitshme. Megjithëkëtë, Ali Ahmeti si personalitet dhe karizmë me vokabularin dhe retorikën e tij ka arritur t'i përshtatet mentalitetit të një pjese dërrmuese të popullit, simpatinë e së cilës e ka fituar falë stilit identik të ish-presidenti të ndjerë Ibrahim Rugova, duke sfiduar edhe luftën e dosjeve, të cilat ateronin si pjatat fluturuese në oborre të ndryshme.

Tani, së fundi, në skenën politike u riaktivizua një emër tashmë i njohur për bëmat e tij. Është fjala për Rufi Osmanin, i cili në Gostivar arriti ta mundë BDI-në dhe PDSH-në. Janë disa arsye të cilat të shtyjnë të mendosh se Rufi Osmani dallon shumë nga liderët e partive të tjera: as oponentët e tij të hapur nuk mund të spekulojnë për mundësinë e vënies së biografisë së tij në dyshim me qëllim komprometimi; ka provuar guximin e tij drejtpërdrejt jo tërthorazi (ngjarjet e 1997 në Gostivar), ka bërë luftë brilante e të pakrahasueshme debatuese në kuvend, është i vetmi me ngritje intelektuale të një kalibri që i lë shumë larg të tjerët dhe përkundër kësaj ka kërkuar rreth vetes të ketë njerëz të dijshëm, për dallim nga të tjerët që madje edhe janë prononcuar se të dijshmit nuk u duhen se të dijshëm janë vetë, por u duhen duartrokitës. Deklarimet e Rufiut janë të matura, të mprehta me thellësi mendimi dhe të ekuilibruara, për dallim nga deklaratat e të tjerëve që janë përplot kontradikta. Në pika të shkurta këto tipare janë sinjale të mjaftueshme për të dhënë motive shtesë për të shpresuar se dalja e tij në skenën politike do të ndryshojë shumëçka. Pushteti maqedonas duhet ta dijë se me Rufiun s'do të mund ta luajë lojën e moçme 'fluturon-fluturon bualli'. Shqiptarët duhet ta dinë se u ka mbetur edhe kjo kartë në dorë, nëse dinë ta shfrytëzojnë si duhet si shpresë të vetme - ngase u provuan të gjitha të mundshmet. Nëse edhe paskëtaj s'do të ketë ndryshime, atëherë shqiptarët do ta marrin veten në qafë. ■



SHËNOHET RËNIE E INVESTIMEVE

Lulzim AHMETI

Investimet e huaja direkte në Kosovë, që nga viti 2007, kanë shënuar rënie të vazhdueshme. Në vitin 2009 vlera e tyre nga 350 milionë, që ishte në 2008, kishte rënë në 291 milionë euro. Për vitin 2010, ekspertët e ekonomisë vlerësojnë se kjo shifër nuk do të jetë aq e madhe. Projekti për përmirësimin e biznesit në Kosovë, i financuar nga Banka Botërore, pritet që gjatë vitit të ardhshëm të sjellë reforma në pesë fusha ekonomike. Këto reforma kanë ardhur si shkas për tërheqjen e investimeve të huaja. Ishte premtuar se këto reforma do të fillonin në muajin janar. Por, kriza institucionale e ka ndërprerë punën e ekipit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, bashkë me atë të Bankës Botërore, për të përgatitur dokumentin unik për ndryshimet që pritet të bëhen. Ekspertë të çështjeve ekonomike konsiderojnë se reformat për përmirësimin e kushteve në ambientin biznesor në Kosovë nuk mund të kryhen në një periudhë të shkurtër kohore.

Investimet e huaja, që nga viti 2007 në të cilin ishin 440 milionë euro, në të tjera vite shkuan duke shënuar rënie, më 2008 – 366 milionë euro, 2009 – 291 milionë euro, 2010 - 204 milionë euro.

Kryeshefi i Agjencionit për Promovimin e Investimeve në Kosovë, Mustafë Hasani , ka thënë se megjithatë ende nuk ka raport përfundimtar për tërë vitin e kaluar. “Ne presim që Banka Qendrore e Kosovës të dalë me një raport përfundimtar këtë vit, me shifra të sakta për vlerën e investimeve për vitin 2010, për sektorët në të cilët është investuar, ashtu edhe për vendet nga kanë ardhur investimet dhe të kemi një të dhënë të saktë krahasuar me vitin 2009”, - ka thënë ai. Hasani ka bërë të ditur se investimet e huaja direkte gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010 janë bërë nga investitorë nga Sllovenia, Gjermania, Austria, Zvicra, Britania e Madhe, Turqia, Holanda, Shqipëria, SHBA-ja dhe Franca.

Prin sektori financiar

Ndërsa sektorët në të cilët janë përqendruar investimet janë: në shërbime financiare, prodhim, transport, telekomunikacion, ndërtimtari, bujqësi, industri përpunuese dhe të tjera. Sipas tij, biznese të huaja të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, gjatë nëntëmujorit të vitit të kaluar, kanë qenë 583 kompani të huaja, të cilat kanë deklaruar se kanë të punësuar 2 mijë e 129 punëtorë. Hasani ka përmendur disa shembuj të investimeve gjatë vitit të kaluar, të cilat kapin shumën prej 35.4 milionë eurosh. Ai ka përmendur investitorin nga Turqia “Universal Food”, i cili ka investuar 15 milionë euro dhe ka punësuar 260 punëtorë në fabrikën e miellit në Fushë Kosovë. Në fabrikën e tekstilit “Kosovatex”, është investuar 4.6 milionë euro dhe ka të punësuar 330 punëtorë, me mundësi që deri në fund të vitit të punësohen deri në 450 punëtorë. Kompania “Tehno Betoni”, nga Varazhdini i Kroacisë, ka investuar 5.2 milionë euro me gjithsej 35 të punësuar. Kompania “Trepharm”, industri farmaceutike, investim i përbashkët kosovar dhe amerikan, ka investuar 6 milionë euro. Sipas



tij, kompania "Cemco Metal" nga Greqia ka planifikuar të investojë shumën prej 1 milion e 30 mijë eurosh. Kurse kompania "Liftkos" nga Gjermania ka planifikuar të investojë 1 milion e 500 mijë euro. Kompania "Rematex" i ka zgjeruar investimet në vlerë prej më shumë se 1 milion euro. Ndërsa kompania "Forneti Azzurro" ka investuar 650 mijë euro. Po ashtu, kompania "Nutzfahrzeuge Kling" nga Gjermania ka planifikuar investime prej 200 mijë eurosh.

Duhen reforma

Kushtrim Puka, nga Instituti për Studime të Avancuara (GAP), ka thënë se janë të nevojshme këto reforma, duke theksuar faktin se Kosova është radhitur në vendin e 119-të për bërjen e biznesit. "Duke marrë parasysh faktin se ky raport vlerësohet si një ndër raportet më prestigjioze nga investitorët e huaj, është shqetësues fakti që Kosova radhitet si vend shumë i dobët, pikërisht në fushat që janë me rëndësi të veçantë për investitorët e huaj", - ka theksuar Puka. Për vitin 2010, Kosova zë vendin e 163-të në fushën e themelimit të biznesit, e 173-të për marrjen e lejeve ndërtimore, e 155-të për zbatimin e kontratave, e 130-të në tregtinë ndërkufitare dhe në vendin e 173-të për mbrojtjen e investitorëve. Rënia e vazhdueshme e investimeve të huaja direkte në Kosovë, sipas tij, është edhe një fakt tjetër që paraqet dështimin e qeverisë për t'i përmirësuar kushtet në ambientin biznesor dhe për tërheqjen e sa më shumë investimeve. Ai shprehet skeptik se këto reforma do të arrihen për një kohë të shkurtër. "Reformat e nevojshme për përmirësimin e kushteve në ambientin biznesor në Kosovë nuk mund të kryhen në një periudhë të shkurtër kohore dhe në to duhet punuar intensivisht", - thotë Puka.

Eksperti i ekonomisë, Nagip Skenderi, ka deklaruar se fushat, të cilat i ka identifikuar Banka Botërore si fusha të interesit të përgjithshëm shoqëror për një rimëkëmbje ekonomike e sociale të vendit, janë në interes prioritar edhe të vetë Qeverisë së Kosovës, sepse janë këto fusha ku mendohet se do të bëhet përmirësimi ekonomik i vendit. "Me këtë rast në këto fusha do të krijohet klimë më e favorshme për investime, siç është krijimi i ambientit të biznesit përmes legjislacionit më të favorshëm fiskal, monetar e rregullativ, duke përshpejtuar dhe rregulluar çështjen e marrjes së lejeve ndërtimore , sepse dihet se në çfarë kaosi ndërtimor ka shkuar vendi këto vite të tranzicionit, posaçërisht Prishtina", - ka theksuar Skenderi. Po ashtu, ai vlerëson se çështja e marrëdhënieve ekonomike me jashtë, sidomos aspekti i nxitjes për eksporte, duhet vënë në fushën e prioriteteve, në mënyrë që ekonomia e vendit të shkojë drejt formave më të shpejta integruese e konkuruese me ekonominë ndërkombëtare.

Edhe drejtori ekzekutiv i Institutit "Riinvest", Lumir Abdixhiku, ka thënë se pak është punuar në tërheqjen e investitorëve potencialë. "Nuk mund të them se ka pasur punë nga institucionet tona për tërheqjen e investitorëve. Unë besoj se është punuar e kundërta, largimi i investitorëve potencialë. Ne asnjëherë nuk arritëm të jemi seriozë në promovimin e potencialeve ekonomike të vendit tonë. Ne vazhdimisht kemi dërguar sinjale korruptuese ndaj çdo investitori vendor ose të huaj. Gjykatat tona ekonomike kanë qenë plotësisht jofunksionale, duke pamundësuar kështu elementin bazë që do t'i jepte siguri një biznesi solid ndërkombëtar. Në anën tjetër, ambienti biznesor nuk ka qenë asnjëherë fer ose stimulues", - është shprehur Abdixhiku.

Investimet e shteteve në Kosovë

Sllovenia 177 milionë euro, Gjermania 190 milionë euro, Austria 113 milionë euro, Zvicra 79 milionë euro, Britania e Madhe 165 milionë euro, Turqia 47 milionë euro, Holanda 80 milionë euro, Shqipëria 6.2 milionë euro, SHBA 35 milionë euro, Franca 28 milionë euro.

Pasojat e rënies së investimeve

Qeveria dhe institucionet e tjera të Republikës të Kosovës, nëse duan të kenë më shumë investime, duhet të përmirësojnë në mënyrë urgjente ambientin biznesor në Kosovë. Nëse përmirësohet ambienti për të bërë biznes në Kosovë, sipas ekspertëve, tek investitorët e mundshëm të huaj jepet një mesazh i qartë se këtu po punohet.

Drejtori i Odës Ekonomike Amerikanë në Kosovës (OEAK), Lekë Musa, ka thënë se duhet të ulet shkalla e korrupsionit, se nevojitet eliminimi i barrierave për marrjen e licencave dhe lejeve, dhe se duhet të përmirësohet sistemi gjyqësor. Sipas tij, në rend të parë, duhet punuar me sektorin privat, për të përmirësuar ambientin afarist në Kosovë. "Këtë vit, shpresoj se Qeveria e re, do të punojë së bashku me sektorin privat dhe me agjencitë e huaja në Kosovë, të cilat janë të involvuara në reformimin e ambientit afarist", - ka theksuar Musa. Sipas tij, viteve të fundit, investimet e huaja kanë shënuar rënie. "Gjithashtu ka sektorë të cilët duhen liberalizuar, ku ka pasur dhe ka ende interes nga investitorët e huaj që të hyjnë në Kosovë. Shpresoj se në të njëjtën kohë do të vazhdohet me reforma strukturore, siç është privatizimi i PTK-së, distribuimi i KEK-ut, projekti i Termocentralit Kosova e Re. Të gjitha këto janë projekte mjaft të mëdha, ku mund të tërhiqen investitorë të huaj dhe të dërgohet një mesazh se në Kosovë mund të bëhet biznes", - ka deklaruar Musa.

Në raportet e ndryshme të mekanizmave ndërkombëtarë financiarë, gjatë vitit që lamë pas, Kosova nuk është paraqitur në nivel të kënaqshëm sa i përket ambientit të biznesit. ■



Vazhdon trendi i ngritjes së çmimeve

Ngritja e çmimeve shqetëson qytetarët

Viti 2011 ka filluar me rritjen e madhe të çmimeve të artikujve ushqimorë, duke rënduar edhe më shumë shportën edhe ashtu të varfër të konsumatorëve. Derisa ekspertët thonë se lëvizja e çmimeve ka ndodhur për shkak se Kosova është e varur më tepër nga importi, qytetarët ankohen se shtrenjtimi i artikujve ushqimorë po e rëndon jetën e tyre çdo ditë e më shumë.

Fatos SHALA

Prishtinë - Çmimet e larta të gjërave elementare ushqimore po ua vështirësojnë çdo ditë e më tepër jetën kosovarëve. Gjërat që mund t'i blinin më herët me pagën që e merrnin, tashmë me ngritjen e çmimeve mund të blejnë pothuajse përgjysmë më pak, pasi që shumë artikuj janë shtrenjtuar më shumë se 50 për qind. Sipas tregtarëve, 1 kilogram sheqer me të renë kushton 1 euro, prej 60 centëve sa ka qenë para rritjes. Kështu është edhe me vajin, ku nga 1,50 euro sa shitej para një jave, është ngritur në 1,80 euro. Këta dy artikuj së bashku me bukën janë shtrenjtuar më së shumti. Krahasuar me vitin e kaluar, çmimi i sheqerit është rritur për 40 për qind, kurse artikujt e tjerë, si vaji dhe buka, kanë pasur një ngritje nga 20 deri në 30 për qind. Tregtarët paralajmërojnë se rritje të çmimeve do të ketë edhe në ditët në vijim. Posaçërisht buka, edhe pse u rrit për 10 centë së fundi, mund të hipë deri ne 60 centë. Sipas tyre, kjo nuk varet nga ta, pasi furnizuesit po ua diktojnë këtë. Agroni, pronar i një marketi në Prishtinë, thotë se me rritjen e çmimeve ka rënë edhe fuqia blerëse, pasi sipas tij njerëzit janë duke blerë më pak. "Diku për 10 për qind më ka rënë fitimi. Kisha dashur që çmimet të kthehen siç kanë qenë", - thotë ai. Ai mohon se veç faktorëve të jashtëm, ka ndikuar edhe ndonjë faktor i brendshëm në rritjen e çmimeve. Kurse, Miftar Sinani punëtor krahu nga Prishtina , thotë se me paratë që fiton nga puna nuk mund të blejë as gjysmën e gjërave elementare ushqimore, të cilat i nevojiten t'i ketë në shtëpi. Sipas tij, çmimet e gjërave ushqimore kanë pësuar një ngritje të madhe, prandaj shumë artikuj ushqimorë i mungojnë në sofrën e familjes së tij. "Gjërat ushqimore kanë pësuar ngritje të çmimeve dhe çmimet vetëm sa po ngrihen, ndërsa unë me këtë punë dhe me këto para që marr nuk po arrij t'i kem të gjitha ato gjëra që më nevojiten në tryezë", - ka thënë ai. Ai ka pohuar se nëse më parë kishte blerë 6 litra vaj, 10 kilogramë sheqer, 1 tabak vezë etj, tani sipas tij nuk mund ta blejë as gjysmën e këtyre gjërave. "Unë nuk po arrij t'i mbuloj shpenzimet që më nevojiten për gjëra ushqimore, pasi që më duhet të paguaj edhe shërbime të tjera nga rroga ime dhe jo vetëm për ushqim", - ka shtuar ai. Edhe ekspertët tërheqin vërejtjen se një numër i madh i qytetarëve jetojnë në varfëri dhe një përkeqësim i fuqisë së tyre blerëse mund ta rëndojë situatën edhe më shumë. Në këtë mënyrë kërkojnë nga institucionet qeveritare të jenë syçelur në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut, duke eliminuar hapësirën për sjellje oportuniste nga ndërmarrjet. Musa Limani, ekspert i ekonomisë, ka thënë se ngritja e çmimeve është duke ndikuar rëndë në popullatë. "Çdo ngritje e çmimeve në artikujt ushqimorë ndikon rëndë në gjendjen e popullatës, edhe ashtu të varfër të vendit tonë. Kjo edhe e ul shumë standardin e jetesës së çdo qytetari. Këto ngritje po bëhen për shkak se ne kemi një nivel shumë të ulët të prodhimeve vendore dhe se tokat bujqësore po punohen shumë pak. "Qeveria e Kosovës duhen të ndajë subvencione për bujqit dhe për ata që merren me prodhime të artikujve ushqimorë, që gjendja të stabilizohet dhe të mos përsëriten çdo herë këto kriza sociale", - është shprehur Limani. Ai me tutje ka thënë se nëse vazhdohet me këto ritme, këto çmime do të ngrihen edhe më shumë. "Unë mendoj se këto çmimi do të ngrihen edhe më shumë, sepse gjendja ekonomike veç po vështirësohet gjithnjë e më shumë në vendin tonë. Dhe prognoza ime është se çmimet do të rriten dhe do të sjellin një gjendje shumë të rëndë sociale në vend. Por, unë gjithashtu mendoj se edhe Kosova, sikurse shtetet e tjera, duhet të ketë rezerva shtetërore, sepse mungesa e këtyre rezervave është edhe problemi kryesor i këtyre çmimeve", - ka përfunduar Limani. ■

Rritjet e fundit të çmimeve

Ngritje të çmimeve kanë pësuar artikujt ushqimorë elementarë si sheqeri, çmimi i të cilit ka arritur në 1 euro për 1 kilogram, ndërsa deri tani çmimi i tij ka qenë 85 centë. Ngritjes së çmimeve nuk i ka shpëtuar as vaji, çmimi i të cilit ka arritur 1.80 euro sa ishte 1.15 euro. Ndërsa mielli, i cili ditë më parë kishte një çmim prej 50 centë, tani në treg ofrohet për 63 centë, gjë që ka bërë që të ngrihet edhe çmimi i bukës nga 30 në 45-50 centë. Ngritjes së çmimeve nuk i kanë shpëtuar edhe shumë artikuj tjerë, të cilët janë të domosdoshëm, duke përfshirë këtu dhe mishin. Për një kilogram mish qytetarët tani duhet të paguajnë 7 euro. Më parë kushtonte vetëm 6 euro.

KONSUMATOR, ÇFARË TË TË THEM?

Isa MEHMETI

Konsumator! Është 15 marsi, dita jote. Dita e të drejtës tënde. Dita kur në vend se të të shtohet sofra, ajo po të ngushtohet. Dita kur t'i, në vend se të festosh, ngushëllon vetveten; në vend se të ndihesh i kënaqur, s'ke se si të gjesh mënyra për ta shprehur indinjatën tënde.

Është shtrenjtuar buka, sheqeri, vaji,… shumë artikuj. Kanë stagnuar të ardhurat, pensionet…Ti konsumator je në luftë me jetën. Je në stadin e dramës hamletiane. Ndërkaq ti ke lindur të konsumosh. Jeton duke konsumuar dhe ndalesh së konsumuari veçse kur t'i thuash lamtumirë kësaj bote. Çfarë të të them në ditën tënde për ditën tënde, kur ty të kanë shndërruar në robot që vetëm blen aq sa ke fuqi monetare dhe s'të pyet dot askush për asgjë? Ç'të thuhet për të drejtën tënde, kur ajo është reduktuar vetëm në blerje dhe kaq, këtu fillon dhe përfundon detyra jote. Ty të ofrojnë mallra me çmime që s'i përballon xhepi yt, të ofrojnë artikuj me afat të skaduar, artikuj kancerogjenë që të vijnë prej vendit që t'i bëri njëmijë të zeza. Konsumator i nderuar! E di se me shumicë je shtresë e nëpërkëmbur, në asistencë sociale dhe me pensione mjerane. E di se kur merr shportën me vete s'ke se me çfarë ta mbushësh. E di se shumë artikuj i shikon siç shikohet diamanti i paarritshëm. E di se pjesa dërrmuese e atyre pak të hollave që merr të shkon në blerjen e barërave nga kequshqyerja. E di se ti frekuenton më shumë barnatoret se dyqanet. Të gjitha i di, prandaj s'di se si të të drejtohem e çfarë të të them në këtë ditë; kur thuhet se megjithatë është dita jote. Vetëm një gjë e di: se kam plot dëshira, urime e shpresa që vitin e ardhshëm të mos e presësh këtë ditë në këtë farë gjendje. Gjashtë Zoti që të vijnë ditë më të mira, kur ti do të mund të konsumosh ashtu siç të ka hije…

Konceptet konsum dhe konsumator kanë lindur në një kohë dhe nuk mund të ekzistojnë pa njëri-tjetrin. Këto dy koncepte e kanë fillesën në shekullin e IV-të, pikërisht atëherë kur filloi të pranohet drejtësia në marrëdhëniet reciproke në mes të njerëzve. Pra shteti luan rolin e rregulluesit e të ekuilibruesit të marrëdhënieve konsum – konsumator. Dita e konsumatorit daton që në vitin 1936, kur brenda lëvizjes konsumatore fillojnë të krijohen organizata e shoqata konsumatore. Më 15 mars të vitit 1960, në Hagë, u krijua organizata e bashkimit të konsumatoreve (IOCU). Kjo organizatë hodhi themelet e një programi dhe të orientimeve për të vendosur mbi baza të organizuara ligjore veprimtarinë e shoqatave konsumatore kudo në botë. Në vitin 1962, presidenti i SH.B.A., Jon F. Kenedi, futi nocionin revolucionar të drejtave për konsumatorët. Ai në kongresin amerikan dha përkufizimin:- konsumatorët na përfshijnë ne të gjithëve. Ata janë grupi më i madh ekonomik në ekonomi që ndikojnë dhe ndikohen nga çdo vendim ekonomik privat e publik. Por ata janë i vetmi grup i rëndësishëm, pikëpamjet e të cilëve shpeshherë nuk dëgjohen. Po këtë vit, Kenedi parashtroi në senatin amerikan nevojën e respektimit të katër të drejtave të konsumatorit, ku përfshinte të drejtën për: siguri, informacion, përzgjedhjen në mes të variacionit të produkteve dhe shërbimeve me çmime rivale. Gradualisht u shtua edhe e drejta për dëmshpërblim, për edukimin e konsumatorëve, plotësimin e nevojave bazë dhe çështja e ambientit. O.K.B., gjatë viteve 1970, 1975 dhe 1985, i kushtoi vëmendje të veçantë dhe u preokupua seriozisht me mbrojtjen e konsumatorëve. Pra, që nga ajo kohë, data e 15 marsit 1985 është përcaktuar dita botërore e të drejtave të konsumatorëve. E gjithë bota i ka pranuar dhe i njeh të drejtat ligjore të konsumatorëve që përcaktohen në kartën e tetë të drejtave të konsumatorit. Kjo përbën bazën e punës së Organizatës së Konsumatorit Botëror (IC) dhe të lëvizjes botërore të konsumatorëve, të cilat janë njohur dhe iniciuar nga Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e konsumatorit të vitit 1985. Ato janë të drejtat: për të plotësuar nevojat bazë për mallra e shërbime të sigurta, për të zgjedhur mallra e shërbime, për t'u informuar, për t'u dëgjuar e përfaqësuar, për edukim konsumator, për kompensim dhe për një mjedis të shëndetshëm. Në vitin 1986, OKB formuloi një dokument special, mbi parimet bazë që udhëheqin mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, me theks të veçantë në tri drejtime: - mallrat e konsumit të gjerë, uji i pijshëm dhe aparatet kryesore. Aktualisht, çdo shtet ka organizata ose shoqata konsumatore, të cilat udhëhiqen nga parimet bazë të Udhëzuesit të OKB për të drejtat e konsumatorëve dhe nga orientimet e Organizatës Botërore të konsumatorëve, si dhe miraton ligje të veçanta për konsumatorët.



Edukatoret në Kosovë, në gjendje të papërmirësueshme

EDUKATORET PAGUHEN MË SË PAKU NGA SHTETI

Edukatoret në Kosovë kanë pagat më të ulëta nga të gjithë punonjësit e institucioneve arsimore e shëndetësore. Ato marrin afërsisht 140 euro pagë mujore, ndërsa herë pas here u janë paguar edhe shujtat ditore. Mirëpo, kohëve të fundit, në Komunën e Prishtinës është organizuar edhe një grevë në shenjë pakënaqësie ndaj pagesave, e cila është ndërprerë pas një premtimi të dhënë nga Komuna e Prishtinës

Drita VITIA

Hamdije Mustafa, zyrtare administrative në institucionet parashkollore, e bën këtë punë tash e 35 vjet. Ajo shprehet se gjatë rrugëtimit të saj si punonjëse e arsimit ka hasur në llojlloj vështirësish, duke filluar nga koha e paraluftës e deri më tani. Hamdija shprehet se ndihet shumë mirë me punën që bën, por shprehet se është e zhgënjyer nga institucionet e vendit tonë që nga paslufta, pasi, sipas saj, që nga çlirimi por edhe që nga shpallja e Kosovës shtet, gjendja e tyre nuk ka ndërruar shumë. Ajo shprehet se kushtet e punës janë të njëjta qysh prej para 30 vjetëve kur e ka nisur këtë profesion. Hamdija thotë se, madje, në të kaluarën nuk kanë pasur probleme me pagat dhe me vonesat e tyre, sepse janë paguar nga Bashkësia Vetëqeverisëse e Arsimit dhe Bashkësia Vetëqeverisëse e Shëndetësisë, të cilat i kanë paguar edukatoret, punonjëset e mirëmbajtjes, të shërbimit etj. "Ne deri më tani nuk kemi pasur asnjëherë probleme, por edhe në atë kohë kemi qenë nën nivelin e dëshiruar. Për shembull, infermieret në spital, gjithmonë kanë qenë më mirë të paguara se sa ne", - shprehet Hamdija.

Edukatoret e zhgënjyera

Ndërkohë, kohëve të fundit, gjendja e edukatoreve të nivelit 0-3 vjet, veçanërisht në komunën e Prishtinës, është bërë shqetësuese. Atyre u është përkeqësuar edhe më tej gjendja ekonomike kur tash e tre muaj nuk po u paguhen as të hollat e shujtave, të cilat ishin paraparë në bazë të një vendimi të nxjerrë në muajin mars të vitit të kaluar. Sipas atij vendimi, edukatoreve dhe punonjësve të tjerë të cilësuar si shërbyes civil, do t'u paguheshin nga 44 euro në muaj për muajt prill-dhjetor 2010, të cilat do t'u kompensoheshin përnjëherë në dhjetor. Mirëpo, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur në Prishtinë, derisa në komunat e tjera të Kosovës pagesa u është bërë qysh në dhjetor. Ndërkaq, mosinteresimi i zyrtarëve komunalë të Prishtinës i ka irrituar edhe më shumë edukatoret dhe përfaqësuesit e sindikatave të arsimit në Prishtinë, duke i shtyrë të hyjnë në grevë. Mirëpo, pas paralajmërimit të masave të tjera sindikale nga ana e edukatoreve, zyrtarët e Komunës u kanë premtuar se do të gjejnë një metodë dhe do t'ua paguajnë këtë shumë të hollash, por u kanë kërkuar një afat kohor prej dy javësh nga dhjetë marsi, në mënyrë që, sipas tyre, të gjejnë zgjidhje. ■

Edukatoret presin 2 javë

Nga data 10 mars, edukatoret kanë ndërprerë grevën e nisur më 7 mars për të pritur afatin e kërkuar nga Komuna e Prishtinës që t'ua paguajë shujtat e parapara me vendim të 2010-s. Edukatoret kanë thënë se do të presin dy javë, por kanë shtuar se në rast se pagesa nuk bëhet pas afatit të përcaktuar, institucionet e arsimit parafillor do të hyjnë në grevë të përgjithshme.

GUTENBERGËT SHQIPTARË

Fatos RUSHITI

Kur ndodhin disa gjëra të pahijshme nëpër botë, ngushëllojmë veten se nuk jemi të vetmit. Krahasimet na pëlqejnë. 'A e pe ish-kryeministrin kroat Sanader, edhe ai hajn?!', d.m.th korrupsion nuk ka vetëm te ne.

Së fundi, u vodh dituria. Edhe këtu nuk qenkemi të vetmit. Karl-Theodor Maria Nikolaus Johann Jacob Philipp Franz Joseph Sylvesterfreiherr von und zu Guttenberg, shkurt Karl zu Guttenberg, dha dorëheqje për këtë shkak. I zënë ngushtë nga "Copygate", skandali i plagjiaturës në tezën e tij të doktoratës, një nga politikanët më popullorë të vendit, ministri i ri i mbrojtjes, baroni Guttenberg lëshoi postin e ministrit dhe deputetit, veprim ky që solli edhe humbjen e imunitetit. Gjithçka nisi me denoncimin e disa ekspertëve akademikë në të përditshmen liberale "Sueddeutsche Zeitung". Me një ekzaminim të hollësishëm ishte bërë një krahasim mes tezës së Guttenbergut dhe dokumenteve të mëparshme, duke arritur në përfundimin se e gjithë puna e doktoratës përbëhej nga paragrafë të tërë, studime shkencore dhe fraza të kopjuara krejtësisht, pa cituar kurrë burimin origjinal se nga ato ishin marrë, në fund të faqes. Dhe sapo lajmi mori dhenë autoriteti i tij ra. Nuk i ndihmoi dot as prejardhja e tij dhe as reklama mediatike e një martese të shkëlqyer me mbesën e Bismarkut. I lindur më 5 dhjetor 1971, është pinjoll i një familjeje aristokrate franke. Ai është 40 vjeç dhe ka pas vetes një karrierë të menjëhershme në politikë. Ka qenë tri herë ministër në qeverinë federale dhe së fundi ishte Ministër Federal i Mbrojtjes. Ai konsiderohej si një prej politikanëve më të popullarizuar në Gjermani dhe shihej si favorit që në të ardhmen të zgjidhej si kancelar. Mediet gjermane madje e patën pagëzuar edhe si "Kennedy i Gjermanisë". Ai ka qenë një nga themeluesit e partisë Unioni Kristian - Social (CSU). Pas mbarimit të gjimnazit Karl- Theodor zu Guttenberg shkoi në ushtri prej së cilës doli si nënoficer rezervë. Ishte anëtar i aristokracisë së vjetër gjermane, me njërin gjysh princ e me tjetrin kont, edhe këta të dy politikanë profesionistë e të dëgjuar. Njëra nga gjyshet ishte nga familja e von Ribentropëve, nga ishte edhe ministri i Jashtëm i Hitlerit. Gjyshja tjetër, është stërmbesë e perandorit Leopold II. Një tjetër stërxhaxha të tij, që ishte marrë pjesë në komplotin e famshëm të 20 korrikut 1944 kundër Hitlerit, e kishin varë atë kohë. Pas mbarimit të studimeve në shkencat politike dhe juridike në Mynih dhe Bayreuth, ai filloi shkrimin e doktoratës, të cilën e mbaroi më 2006 me notën më të lartë "summa cum laude".


Karl zu Guttenberg - ish-ministër i mbojtjes së Gjermanisë

Ministrin zu Guttenberg në fakt u akuzua për kopjimin e doktoratës së tij, të cilën e ka mbrojtur para pesë vjetësh. Ai akuzohet se në doktoratën e tij ka kopjuar fjalë për fjalë paragrafë të tërë nga gazetat dhe botimet e tjera të ngjashme, pa shënuar askund se bëhet fjalë për citate. Disa pjesë të tëra, të cilat janë pjesë e hyrjes së disertacionit të ministrit zu Guttenberg, janë kopjuar nga një artikull i politikologes nga Universiteti i Pasaut, profesoreshës Barbara Zehnpfennig, që ishte botuar në gazetën 'Frankfurter Allgemeinen Zeitung'.

Profesori Peter Häberle, udhëheqësi i doktoratës së tij, u distancua hapur nga skandali i Guttenbergut.

Një notë proteste e nënshkruar nga rreth 30.000 shkencëtarë iu drejtua kancelares Angela Merkel.

Po të ndodhte rasti i tij te ne, çudia do të zgjaste vetëm dy-tri ditë. Ç'është më e keqja do të dilnin kolegët universitarë për ta mbrojtur (për shkak të pozitës). Megjithatë ky është perëndimi dhe kjo është kultura për të cilën aq fort lektisim, por që në momentet kur nuk na konvenon sikur tërhiqemi dhe na humb ai vrull.

Te ne ka me dhjetëra të vetëquajtura universitete (tanimë kolegje), të cilat janë të gatshme të të japin diploma pandërprerë. Në shumë fakultete, përfshirë edhe atë publik, ka me qindra konkurse për mastera, të cilët pranohen dhe diplomojnë. Mund të marrësh diplomën e universitetit, pa mbaruar hiç shkollën e mesme, ashtu siç mund ta marrësh titull shkencor pa kryer fakultetin…

Lum ne! Shumë *'dije'* po prodhohet!!!

Komisionet e ngritura për vlerësimin e punimeve kërkimore, si teza masteri ose teza doktoratash, e kanë të pamundur të bëjë verifikimin e plotë dhe të saktë të materialit përfundimtar. Një profesor udhëheq dhjetëra kandidatë, që edhe po të supozohej se është super-robot, vështirë do ta kishte, çka a priori nënkupton leximin shkel e shko. Dhe rrjedhimisht pasojat janë më evidente. Arsimi është liberalizuar më shumë se gjithçka tjetër. Urdhëroni: tema, tituj, diploma sa të doni, është koha e *'aksham pazarit'*!

Ana ndritshme e kësaj ngjarje të errët të Gutenbergut gjerman është pendesa e shpejtë e tij.

"Është vendimi më i vështirë i jetës sime. Kam qenë gjithmonë i gatshëm për të luftuar, por tani jam në kufijtë e forcës time", - deklaroi ai. Dikush mund të pyesë se përse po e jap dorëheqjen. Fillimisht për disa, një shkak ndoshta jo i kënaqshëm, por njerëzor. Askush nuk e ka të lehtë që të heqë dorë nga një post, të cilin e do me zemër, nga një post që do të thotë përgjegjësi për shumë njerëz dhe jetën e tyre. Kësaj i shtohet rrethana se unë, për të marrë një vendim

me përmasa të tilla, desha të kisha në dispozicion kohën e nevojshme jashtë presionit të medieve dhe të opozitës".

Te ne plagjiaturat janë gjëja më normale që mund të ndodhë e të arsyetohet. Ditëve të fundit një e tillë kaloi pa fort zhurmë. Një ueb-faqe publikoi zbulimin e plagjiaturave të artistëve shqiptarë të artit pamor. Kjo u dëshmua edhe me publikimin e veprave artistike. Përpos që janë ndier të indinjuar, albaniancontemporaryart.wordpress.com ka bërë që dekani i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës, Adem Rusinovci, ta procedojë rastin në polici. Kjo e fundit e ka përcjellë rastin në Prokurorinë e Prishtinës. Autorët anonimë të uebfaqes kanë futur në "listën e zezë" të plagjiatorëve artistë të njohur shqiptarë nga Kosova e Shqipëria. Olson Lamaj, Armando Lulaj, Gjovalin Delia, Endri Dani, Eltjon Valle, Heldi Pema, Dritan Hyska, Ardian Isufi, janë disa prej tyre. Jashtë listës nuk kanë mbetur as artistë të njohur si Sislej Xhafa e Anri Sala. Nga Kosova në këtë listë hyjnë Majlinda Kelmendi, Driton Hajredini e Flaka Haliti. Dy të parët thonë se autorët që pretendojnë se kanë zbuluar plagjiaturat e tyre, nuk kanë haber se çfarë është arti.

Pa dyshim.


Plagjiatura

NENI 86 I KUSHTETUTËS

Kushtetutën dhe ligjet e secilit shtet i nxjerr Kuvendi (Parlamenti), por ligjvënësit e këtij organi më të lartë shtetëror e nxjerrin Kushtetutën dhe ligjet për situata normale, duke krijuar mundësitë që përmes normave juridike të këtyre akteve të krijohen kushtet për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve të ndryshme në mes subjekteve të caktuara. Por ndodh që, në disa raste, ligjvënësi nuk mund të parashikojë zgjidhje afatgjata përmes normave juridike dhe kushtetuese dhe këto norma nuk mund t'u bëjnë ballë zhvillimeve dhe ndryshimeve institucionale të një shteti. Kështu po ndodh edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 86, paragrafin 3, 4 dhe 5, që përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës

Ma. sc. Flamur HYSENI

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008, erdhi si rezultat i dokumentit gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari për zgjidhjen përfundimtare të statusit politiko - juridik të Kosovës. Akti në fjalë, në aspektin politik, ishte një hap i rëndësishëm për Kosovën dhe bëri që shteti i shpallur më 17 shkurt 2008 të bëhet edhe me aktin më të rëndësishëm juridiko – politik të shtetit dhe u pranua ndërkombëtarisht nga shumica e shteteve më të rëndësishme, por siç po duket hartimi i kësaj Kushtetute është bërë me nguti të madhe, ndërsa nga krijimi i një klime politike mjaft dinamike që po zhvillohet pas shpalljes së pavarësisë, po del që kjo Kushtetutë vështirë se do t'i bëjë ballë krijimit të rrethanave të reja politiko – ekonomike të shoqërisë kosovare dhe po ballafaqohet me shumë sfida (Komisioni për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në radhët e veta pati një numër ekspertësh të njohur, por jashtë këtij komisioni mbeti po ashtu edhe një numër i madh ekspertësh dhe njohës të mirë të çështjeve kushtetuese!).

Në kapitullin e pestë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 86, i cili ka gjashtë paragrafë, parashihet zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës. Shikuar vetëm për nga teksti dhe përmbajtja, këta paragrafë të këtij neni duken mjaft të paqartë, ndërsa shikuar dhe analizuar për nga aspekti juridik, ata paraqesin një situatë konfuze dhe vetë formulimi i këtij neni, si normë kushtetuese, është shumë i komplikuar, aspak i kuptueshëm dhe me mangësi elementare për të ekzistuar si normë e plotë kushtetuese. Si për shembull, nuk është caktuar saktësisht kuorumi për zgjedhjen e Presidentit (për të vërtetuar pakuptimësitë si formë teksti, shih paragrafët 2 dhe 6 të nenit 86).

Paragrafët 4 dhe 5 të nenit 86 janë shumë të komplikuar dhe nuk përcaktojnë në mënyrë të saktë mënyrën e vendimmarrjes nga ana e Kuvendit për ta zgjedhur Presidentin dhe lë mundësinë diskutuese të kuptimit të këtyre dy paragrafëve, sepse në këta dy paragrafë, përkatësisht në paragrafin 4 thuhet që: Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa në paragrafin 5 thuhet që: Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë, formulimit të këtyre dy paragrafëve del që u mungon përcaktimi i saktë, se a është dashtë të jenë të pranishëm të gjithë deputetët (120), është dashtë të votojnë 2/3 e 120 deputetëve, apo 2/3 e të pranishmëve? Nëse i referohemi paragrafit 5, që përcakton mundësinë e tretë të votimit, ai lë të kuptohet se kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve zgjidhet President i Republikës së Kosovës. Këtu ngrihet diskutimi, se cila shumicë duhet ta ketë votuar kandidatin për President, shumica relative, absolute, ose e kualifikuar (2/3)? (Shih mënyrën e zgjedhjes së Presidentit në rundin e tretë, ku ai zgjidhet me 62 vota, pa kundërkandidat, edhe pse paragrafi i pestë i nenit 86 parasheh që në rundin e tretë të jenë në garë dy kandidatë).

Edhe si e tillë, kjo pjesë e kësaj dispozite kushtetuese, edhe kështu në këtë



gjendje çfarë është, nuk është respektuar, sepse kjo dispozitë përcakton se me të filluar procedura e zgjedhjes së Presidentit nga deputetët, së paku duhet të jenë në konkurrencë tre kandidatë, kështu që krijohet mundësia e zbatimit adekuat të kësaj dispozite dhe krijohet mundësia që dy nga tre kandidatët që kanë marrë vota më shumë në rundin e dytë, të hyjnë në garë në rundin e tretë dhe ai i cili merr më shumë të zgjidhet President (të analizohet me kujdes të veçantë paragrafi 5 i nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Në kuadër të nenit 86, bien ndesh (nuk janë në harmoni) paragrafi 3 me paragrafin 5, sepse në paragrafin 3 thuhet: Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës, sipas interpretimit në kuptim të ngushtë, kjo formë e formulimit e përjashton mundësinë e nominimit të ndonjë kandidati tjetër dhe bie ndesh me paragrafin 5 që lë mundësinë e nominimit të më shumë se dy kandidatëve, ndërsa sipas kësaj logjike të formulimit të këtij paragrafi, sidomos fjalisë së fundit të tij, del që po të interpretohej logjikisht, do të duhej të ekzistonte mundësia e nominimit të katër kandidatëve në garë për President, sepse Kuvendi ka 120 deputetë (katër kandidat do të kishin mundësinë e mbledhjes nga 30 nënshkrime të deputetëve, kjo mundësi ekziston sipas kuptimit të një interpretimi të zgjeruar. Në lidhje me zbatimin e kësaj mundësie, do të ishte i nevojshëm edhe angazhimi aktiv i opozitës, së paku me prezencën e saj gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatit për President dhe do të kishte mundësi të votimit kundër, ose të abstenimit, sepse veprimi që bëri opozita është në kundërshtim me rregullat e demokracisë).

Prandaj, duke e analizuar në mënyrë profesionale dhe të hollësishme bazën kushtetuese aktuale, gjegjësisht paragrafin 3, 4 dhe 5 të nenit 86, del që zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, është bërë duke mos e respektuar saktë procedurën e përcaktuar sipas kësaj dispozite kushtetuese, lidhur me zgjedhjen e Presidentit.

Sipas kësaj situate kushtetuese të komplikuar dhe paraqitjes së kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim të kushtetutshmërisë së zgjedhjes së Presidentit nga ana e deputetëve të opozitës, dhe nëse kjo gjykatë do të japë një vendim duke anuluar procedurën e zgjedhjes së Presidentit dhe obligimin e përsëritjes së procedurës për zgjedhjen e Presidentit (sipas interpretimit në kuptimin e zgjeruar të paragrafit 3, 4 dhe 5 të nenit 86 të Kushtetutës) do të paraqitet edhe një mundësi për krijimin e një situatë mjaft të rëndë për funksionimin e institucioneve shtetërore dhe shkuarjes prapë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, sepse shikuar në aspektin politik, askush nuk do të garantojë se deputetët do ta votojnë kandidatin për President me aq vota sa do të jenë të nevojshme.

Në mesin e shumë zgjidhjeve, duke iu referuar situatës së komplikuar, si politike ashtu edhe kushtetuese, mundësia është të kemi zgjidhje të paqarta për rastin konkret. E vetmja zgjidhje e pranueshme dhe pak më afatgjate do të jetë shprehja e vullnetit të mirë nga ana e opozitës, duke propozuar kundërkandidatin për President, ose mundësia e arritjes së ndonjë "ujdie politike", për të mos e thelluar krizën qeveritare në vend, pra kërkohet roli dhe vullneti konstruktiv nga ana e opozitës si mundësi e vetme për të mos u futur në krizë qeveritare më të thellë. ■

(Autori është asistent në Katedrën e shkencave Kushtetuese – Administrative, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)

Konvertimi i të rinjve m

- sfidat dhe problemet

Milazim MUSTAFA

Fetë e mëdha botërore janë universale. Ato ndiqen dhe pranohen nga njerëz të kombeve e kombësive të ndryshme (në përjashtime të vogla ku feja nacionalizohet dhe lidhet ekskluzivisht me një grup të caktuar etnik a racor), por kemi edhe raste ku feja në shoqëri të caktuar është e ndarë edhe në baza etnike. I tillë është rasti deri-diku edhe në Maqedoni. Ata që janë shqiptarë identifikohen me Islamin, d.m.th se janë muslimanë, kurse ata që janë maqedonas janë të krishterë ortodoksë (normalisht, gjithmonë duhet t'i kemi parasysh përjashtimet, sepse sidomos në pjesën maqedonase kemi një grup të konsiderueshëm etnik maqedonas që janë me përkatësi islame, mirëpo edhe brenda këtij grupi ka gjithnjë e më shumë zëra që e kontestojnë identitetin e tyre maqedonas, duke e deklaruar veten si torbeshë, turq, goranë, e kështu me radhë).

Përveç kësaj, në këtë vend edhe kontaktet në mes të grupeve etnike janë gjithnjë e më të vogla. Më parë shqiptarët dhe maqedonasit jetonin në lagje të përziera, tash ky numër është shumë i vogël. Gjithnjë e më shumë maqedonasit i lëshojnë lagjet ku shumica janë shqiptarë, edhe pse po t'i pyesësh se si janë sjell me ta fqinjët e tyre shqiptarë, prej tyre do të dëgjojmë vetëm fjalë miradije. Gjithashtu, edhe të rinjtë sot shumë pak kontaktojnë dhe shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre të kombësisë tjetër. Ndjekin shkolla të veçanta, studiojnë në universitete të ndryshme, frekuentojnë lokale të ndryshme e kështu me radhë. Ky është një fenomen që vërtet ia vlen të studiohet dhe të hulumtohet në të ardhmen.

Shqiptarët dhe maqedonasit shumë pak dinë për besimin dhe fenë e bashkëqytetarëve të tyre. Ndoshta ajo urrejtja kombëtare që kanë për njëri-tjetrin i ka bërë që ta urrejnë edhe fenë e njëri-tjetrit. Shumë herë, sidomos gjatë ndeshjeve sportive, shqiptarët fyhen në baza fetare, pastaj edhe gjatë luftës së vitit 2001 xhamitë u dogjën dhe u shembën si rezultat i urrejtjes që kishin për shqiptarët, edhe përkundër faktit se disa xhami që u dogjën, sidomos në pjesën qendrore të Maqedonisë, nuk ishin vend adhurimi i shqiptarëve, por i romëve, turqve dhe torbeshëve.

Si rezultat i kësaj ndasie edhe konvertimet, që janë të zakonshme gjithkah nëpër botë, këtu në Maqedoni, janë të rralla, jo të zakonshme, por për shoqërinë edhe të panjohura.

Shumë kush u habit kur u publikua lajmi se një e re, studente e përkatësisë etnike maqedonase, e kishte pranuar fenë islame. Filluan të qarkullojnë lajmet, bisedat, spekulimet e shumëçka tjetër. Edhe pse ky lajm ishte jo i zakontë për masën e gjerë, ne e dimë se raste të tilla ka pasur edhe më parë, por që nuk kanë dalë publikisht që ta shfaqin besimin e tyre dhe se numri i atyre që janë muslimanë, por e mbajnë këtë në fshehtësi, është shumë më i madh.

Ndërmorëm hapin që t'i hulumtonim rastet e tilla dhe kjo rezultoi me faktin se shumica ishin të rinj, studentë ose sapo kishin mbaruar studimet e tyre, që do të thotë se kishim të bënim me një shtresë të ngritur intelektualisht. Nëpërmjet disa miqve e shokëve arritëm të gjejmë kontaktet e tyre, mirëpo ajo që ishte më e keqe ishte ajo që pasoi. Mënyra më e lehtë për të arritur deri tek ata ishte nëpërmjet rrjeteve sociale, ku shumica kishin profilet e tyre. Edhe pse të rrallë ishin ata që kishin vendosur emrat dhe mbiemrat e tyre në profil. Shumë kush prej tyre kishin kombinime të emrave të tyre maqedonas, me ndonjë emër të historisë islame, si emër pejgamberi, emra të grave të njohura në historinë islame e kështu me radhë. Kurse ata që ishin me emra e mbiemra, nuk kishin asnjë shenjë të përkatësisë islame. Me këtë rast, konsultuam njërin nga bartësit e ueb faqes www.makislam.com ,faqe kjo që i bashkon shumicën e maqedonasve dhe maqedonaseve të konvertuara në islam. Kryesisht kjo faqe merret me prezantimin e fesë islame në gjuhën maqedonase. Ai thotë se kohëve të fundit është vështirësuar puna dhe veprimtaria jonë, por edhe kontakti me personat në fjalë është bërë gjithnjë e më i vështirë.

Më parë kishim mundësi edhe të përkthenim libra në gjuhën maqedonase, broshura, bënim CD të ndryshme, që kishin jehonë të madhe te maqedonasit që ishin të interesuar për Islamin.



Por tani më tepër jemi të koncentruar në ueb faqet tona www.makislam.info dhe www.islamski-centar.org. faqe këto të dedikuara për muslimanët dhe jomuslimanët që flasin gjuhën maqedonase. Më parë, uleshim e bisedonim me të gjithë të interesuarit dhe mundoheshim t'u ndihmonim personalisht, por edhe me ndihmën e disa vëllezërve tanë maqedonas që ishin konvertuar në Islam më herët. Mirëpo, kohëve të fundit kjo dukuri ndodh shumë rrallë. Sipas njohurive tona, raste të tilla janë mbi 50, meshkuj dhe femra, të cilët e kanë pranuar fenë islame, mbi 20 prej tyre e kanë deklaruar dëshminë e pranimit të Islamit para meje, kurse me mbi 30 prej tyre njihem personalisht, deklaroi Jasmin Rexhepi, njëri nga bartësit e këtyre ueb faqeve. Shumica e tyre janë nga Shkupi, por ka edhe nga qytetet e tjera të Maqedonisë, si Velesi, Kavadari, Shtipi, Berova, Struga, Ohri, Kërçova, Gostivari e kështu me radhë. Mirëpo fatkeqësia është se këtyre askush nuk u jep përkrahje. Jemi shumë të dëshpëruar nga sjellja e Bashkësisë fetare islame në Maqedoni, që nuk kontribuon aspak për t'u dalë në ndihmë këtyre të rinjve, së paku të botojë ose financojë botimin

aqedonas në fenë islame





e librave ose broshurave në gjuhën maqedonase. BFIM-ja gjithmonë ka kundërshtuar bashkëpunimin në këtë fushë. Të vetmit jemi ne, si shoqëri, që kemi botuar mbi 15 libra dhe mbi 50 broshura në gjuhën maqedonase. Kemi pasur raste ku edhe disa shtëpi botuese dhe OJQ shqiptare kanë botuar ndonjë titull në gjuhën maqedonase, si shtëpia botuese Nun, Logos-A, Qendra Islame, FRI etj", - deklaroi Rexhepi.

"Tani edhe gjendja aktuale në shtet e ka bërë të vetën", - vazhdon ai. Jemi të mendimit se njerëzit frikohen të flasin për këto tema. Kemi edhe më shumë raste që e ushtrojnë privatisht besimin e tyre islam, sepse nuk mund të marrin guximin ta bëjnë këtë në mënyrë publike. Disa që e patën shfaqur besimin e tyre u patën përjashtuar nga puna, nga fakulteti, ose nuk kishin mundësi të punësoheshin për një kohë gjatë, ose akoma kanë probleme me institucionet e pushtetit, si edhe vizita të shpeshta nga organet e shërbimeve shtetërore", - na thotë Jasmini.

Në kontaktet tona me disa prej të konvertuarve në fenë islame, shumica nuk pranuan të flasin për besimin e tyre. Ata që pranuan ishin të përmbajtur në deklaratat e tyre, por të gjithë kërkuan që deklaratat e tyre të jenë anonime, respektivisht mos të përmenden emrat dhe mbiemrat e tyre, ose diçka që do të asoconte në identitetin e tyre. Me shumicën prej tyre kërkuam që të zhvillonim një bisedë për revistën tonë, por asnjëri nuk pranoi ta bënte këtë me arsyetimin se refuzojnë të flasin "për çështje personale". Njëra prej tyre na tha se për të njëjtat shkaqe nuk dëshiron të flasë publikisht, por se, përkundër kësaj, ndihet më mirë në këtë fe të re për të dhe se është shumë e lumtur. Ajo tha se jeton në një lagje maqedonase dhe se nuk ka pasur kontakte me muslimanë. Kontaktet e saj të para me muslimanët kanë qenë në shkollë të mesme, ku në veçanti i ka pëlqyer qetësia e brendshme te të rinjtë muslimanë, afërsia e tyre me njeri-tjetrin dhe qasja e tyre për jetën. Pyetjes sonë se pse nuk pranon të flasë publikisht ajo iu përgjigj se 'kur vendosa ta përqafoj fenë islame, shkova në BFIM që ta bëj këtë gjë zyrtarisht. Ata kërkuan që të publikojnë diçka në lidhje me këtë rast dhe, pasi u bë kjo, unë u gjeta në një situatë tepër të pavolitshme, sepse u ballafaqova me njerëz që u pengonte vendimi im që unë të bëhem muslimane', pa dëshiruar të na tregojë se kush ishin këta njerëz që u ka penguar pranimi i fesë islame nga studentja në fjalë. E pyetur për jetën e saj dhe kontaktet e saj, ajo na tregoi se më shumë shoqërohet me muslimane shqiptare, kurse me ato maqedonase nuk ka asnjë kontakt. Më tepër për fenë islame kam mësuar nga shoqet e mia shqiptare, por edhe lexoj nëpër faqe të ndryshme të internetit. Në pyetjen tonë për literaturën në gjuhën maqedonase, ajo tha se kjo është gjëja më e keqe që po na ndodh, sepse askush nuk përpiqet të botojë diçka në gjuhën maqedonase. Të gjitha librat me tematikë islame janë në gjuhën shqipe dhe se ne që nuk e njohim gjuhën shqipe vështirë e kemi të përfitojmë nga këta tituj. Ajo, gjithashtu, tha se informohet për Islamin edhe nga interneti, por shprehi revoltën se shumica e këtyre faqeve po janë me tematikë ekstreme dhe se kjo gjë, kësaj të reje po i pengon shumë. Gjithashtu tha se dëshiron që sa më shpesh të shkojë në xhami dhe të dëgjojë derse në gjuhën e saj, por fatkeqësisht këto gjëra po i mungojnë.

Disa të tjerë dyshonin ndaj thirrjeve tona që të merremi me çështjen e tyre dhe këtë e arsyetonin se janë jashtë shtetit ose nuk mund ta bëjnë këtë gjë, pa ofruar arsye, kurse shumica as që u lajmëruan ndaj kërkesës sonë. Vlen të ceket edhe rasti i një personi, i cili i revoltuar tha se nuk është musliman, por beson në Zot dhe ka vetëm simpati për Islamin dhe kërkoi që mos ta ngacmojmë më tej se do të na paraqes pranë organeve gjegjëse, përkundër faktit se profili i tij i Facebook-ut ishte i mbushur me fotografi me tematikë islame dhe personi që na drejtoi deri tek ai, ishte shumë i sigurt se kishim të bënim me një musliman.

Këta të rinj, janë lënë në skajet e shoqërisë që, me mundin e tyre dhe të vetëm, të ballafaqon me problemet e shumta që kanë në jetën e tyre. Fatkeqësisht, askush nuk iu del në ndihmë, përveç disa individëve të caktuar që ndajnë problemet dhe brengat me ta.

Ajo që na brengos është edhe frika që ndiejnë këta të rinj. Prej kujt frikësohen këta të rinj e të reja? Mos vallë, kanë probleme në familjen e tyre, apo frikësohen nga izolimi i shoqërisë ku jetojnë, apo më e keqja, që është edhe më evidente, është frika nga institucionet e shtetit ku jetojnë dhe shtetësinë e të cilit e bartin, shtet ky i cili garanton me kushtetutë liritë fetare dhe ushtrimin e lirë të besimit...?

Mbetet që subjektet kompetente të interesohen më shumë për gjendjen e këtyre të rinjve, sidomos Bashkësia Fetare Islame, por edhe OJQ-të e tjera aktive në Maqedoni, me qëllim që t'u krijojnë kushte për ushtrimin e lirë të fesë së tyre, por edhe për pajisjen me njohuri burimore mbi fenë së cilës kanë vendosur t'i përkasin. Sepse integrimi i tyre në shoqëri do ta bënte shoqërinë edhe më të larmishme, por edhe më të pasur për nga vlerat, kurse mbyllja e tyre në vetvete mund të sjellë edhe gjëra të padëshirueshme. Andaj, shpresojmë që organet dhe organizatat që merren me këtë lëmi, ta bëjnë të vetën, sidomos në përkthimin e literaturës burimore në gjuhën maqedonase, por edhe në përkrahjen e tyre maksimale që të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë në këtë vend. ■

DIKTATI I LAICIZMIT NË DEMOKRACI

Mimoza SINANI

Diversiteti fetar dhe kulturor i një shoqërie duhet kuptuar si një pasuri që duhet përqafuar dhe promovuar. Qëllimet dhe objektivat, që duhet t'i orientojnë shoqëritë e sotme demokratike, duhet të jenë multikulturalizmi dhe gjithëpërfshirja.

Bashkëbisedim gjithëpërfshirës, jo dialog përjashtues e imponues

Elita jonë intelektuale i transformon ligjet në një amalgamë të kulturave juridike perëndimore dhe mundohet t'i injektojë ato në shoqëri pa i studiuar mirë dhe pa i përshtatur aspak me traditat dhe kushtet aktuale të vendit.

Qëndrimet e klasës intelektuale post-komuniste shqiptare, qoftë kjo akademike por edhe politike, flasin për një mentalitet përjashtues, i cili nuk pranon diversitetin shoqëror, kulturor e ideor. Ajo mendon se ka të drejtë t'i imponohet individit në mënyrë arbitrare dhe e shikon atë ose si subjekt që duhet t'i nënshtrohet verdiktit të saj, ose të vetpërjashtohet.

Politikanët vendimmarrës duhet të kenë parasysh se nuk duhet të miratojnë ligje dhe të imponojnë modele arbitrare në marrëdhëniet fe-shoqëri, pa u kujdesur për një konsensus minimal që vjen vetëm përmes debatit të mirëfilltë publik dhe konsultimit me shoqërinë civile. Ky konsensus duhet të arrihet nëpërmjet një procesi të hapur dialogues, ku palët duhet të marrin pjesë si interlokutorë dhe jo si stigmatizues.

Shteti i Kosovës: laik apo shekullar?

Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe thotë se: "Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare", ndërsa në gjuhën angleze thuhet: "The Republic of Kosovo is a secular state and is neutral in matters of religious beliefs", pra, del se Kosova është shtet shekullar.

Në fjalorë të ndryshëm anglisht-shqip fjala angleze "secular" përkthehet si "laik", mbasi këto nocione kanë një sinonimi mes tyre. Por, nga pikëpamja përmbajtjesore dhe ideologjike ato kanë konotacione të ndryshme.

Në mjaft raste këta dy terma ngatërrohen me njëri-tjetrin dhe në vend të laicizmit përdoret shekullarizmi dhe anasjelltas.

Në lidhje me këtë nen të kushtetutës, Myftiu i Kosovës, Mr. Naim Tërnava, është shprehur: "Bashkësia Islame e Kosovës ka pasur vërejtjen e saj për sa i përket përkufizimit të Kosovës si shtet laik. Unë e kam thënë edhe një herë dhe po e ripërsëris se Kosova nuk është shtet laik, nuk është shtet laik as me planin e Presidentit Marti Ahtisari, por është shtet shekullar, prandaj unë edhe përmes kësaj interviste, i ftoj përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës të bëjnë dallimin në mes laicizmit dhe shekullarizimit, që është një dallim jashtëzakonisht i madh.

Mund të themi që Kosova është shtet shekullar, po jo assesi shtet laik, sepse Kosova ka besimtarët e saj dhe populli i Kosovës është besimtar." Bashkësia islame e Kosovës, duke mos qenë tërësisht e kënaqur me vendin dhe pozitën që kanë fetë në Kushtetutën e vendit, i ka dërguar edhe vërejtje me shkrim Komisionit Kushtetues.


Vërejtje dhe pakënaqësi të tilla ndaj laicitetit kanë shprehur edhe përfaqësuesit e klerit katolik. Më 27 Shkurt 2004, Papa Gjon Pali i Dytë, para ipeshkëve francezë në Vatikan, ka thënë: "Shekullarizmi nuk duhet të ngatërrohet me Laicizmin. Laicizmi është atëherë kur shteti pretendon të injorojë dimensionin shpirtëror të individit ose të shoqërisë…"

Po ashtu, Papa Benedikti XVI-të, më 12 Tetor 2008, në Pallatin Elysie, para kryetari francez Nicolas Sarkozy, ndër të tjera ka thënë:

"Jam plotësisht i bindur se tani është e nevojshme që laicizmi të ketë një kuptim të ri…" ... duke shtuar se: "duhet një formë e shëndetshme e laicizmit…"

Dallimet ndërmjet këtyre dy koncepteve

Vetë laicizmi dhe shekullarizmi nuk janë be-



sime ose ideologji, por struktura legjislative. Ato nuk mund t'i identifikojmë me ndonjë ideologji ose pikëpamjeje kundrejt botës, sikurse janë për shembull: materializmi, realizmi, natyralizmi, ekzistencializmi etj.

Fjala "laik" (gr. laïkós) ka kuptimin: "që i përket popullit", "njeri civil", "jashtë organeve zyrtare dhe administrative, jo qeveritare," "në opozitë me priftërinjtë dhe ushtarët".

Kurse fjala "shekullar" rrjedh nga fjala latine (lat. saeculum) që do të thotë "shekullar", "i këtij shekulli", "i kësaj bote", "i jetës njerëzore". Pra me shekullarizmin kuptojmë përshtatje ose adaptim me shekullin dhe me kohën aktuale në të cilën jemi duke jetuar.

Shpeshherë shekullarizmi kuptohet si ndarje e shtetit nga feja, por në fakt, në shekullarizëm kemi të bëjmë me një bashkëpunim të shtetit me shoqërinë civile dhe institucionin e fesë, për ta ndihmuar njëra-tjetrën drejt reformimit dhe modernizimit. Një botëkuptim të këtillë të shekullarizmit politik e kemi në Angli, Amerikë etj. Kurse laicizmi, veçanërisht ai francez, nënkupton ndarjen e shtetit nga feja, por jo edhe të fesë nga politika dhe shoqëria. Me laicizëm ndalohet të ketë 'fe shtetërore' dhe 'shtet fetar'. Laicizmi i vërtetë arriti të instalohet vetëm në Francë, që njihet edhe si vendi i celulës së përhapjes së laicizmit, ose ndryshe edhe si djepi i laicizmit, që ishte produkt i Revolucionit Francez.



Studiuesit dallojnë midis laicizmit francez dhe shekullarizmit amerikan. Një nga dallimet kryesore të tyre është qëndrimi i ndryshëm ndaj fesë. Modelet amerikane dhe franceze artikulojnë dy koncepte të ndryshme mbi marrëdhënien e qytetarit me shtetin.

- Shekullarizmi amerikan është kuptuar si arena ku diferencat sociale, kulturore, fetare e racore, negociohen, ndërsa laicizmi francez është kuptuar si përballja e qytetarit me shtetin, pasi qytetari është zhveshur nga gjithë bagazhi i tij kulturor, fetar, e social.
- Shekullarizmi amerikan është akuzuar se i jep hapësirë fraksionalizimit të shoqërisë, ndërsa laicizmi francez është akuzuar se parashikon që qytetari të jetë abstrakt dhe jo siç është në realitet.
- Shekullarizmi amerikan parashikon mbrojtjen e shtetit nga feja, por dhe mbrojtjen e fesë nga shteti dhe pavarësinë e saj. Shteti ndalohet nga Kushtetuta të promovojë fenë, se kjo do sillte diskriminimin e feve të tjera minoritare. Laicizmi francez pretendon mbrojtjen e qytetarit nga kthetrat e fesë dhe laicizmi zë rolin e fesë së promovuar prej shtetit.
- Shekullarizmi amerikan e pranon se në shoqëri ekzistojnë diskriminime. Shteti francez pretendon se nuk ekzistojnë diskriminime, sepse të tërë janë të barabartë para republikës.
- Në emër të shekullarizmit, shteti amerikan ndalon përfshirjen e kreacionizmit në kurrikulumin shkollor. Në emër të laicizmit shteti francez ndalon hyrjen e vajzave me shami në shkollë.
- Shteti amerikan ndalon besimin e një pakice, të shprehur te teoria e kreacionizmit, t'i imponohet shumicës. Shteti francez ndalon të drejtën e shumicës, e drejta e shkollimit, t'u jepet dhe pakicës, për shkak të besimit të tyre fetar.

Konceptimi aktual i laicitetit nga zyrtarët tanë shtetërorë

Ligjet që prodhon shteti ynë bazohen në një keqkuptim të thellë të konceptit të laicitetit si një qëndrim antifetar, ose kundër fesë.

Ky është një konceptim që laicitetin e kupton si ateizëm, ose si agnosticizëm. Në këto dy raste, laicizmi përkthehet si mosbesim ose dyshim tek ekzistenca e Zotit. Laiciteti qëndron në garantimin e bashkëjetesës fetare, por ky nuk duhet kuptuar si një laicitet që ngrihet mbi fobinë ndaj fesë. Laikja nuk është ateizëm, por është një ndarje e shtetit nga feja.

Duke i ndaluar besimtarët të shfaqin besimin e tyre në hapësirën publike, shteti ynë nuk sillet si një aktor laik dhe jofetar, por si një aktor antifetar dhe ateist (ose agnostik). Shteti ynë e ka kthyer ateizmin në fenë e tij institucionale, duke shkelur kështu parimin themelor të laicizmit sipas të cilit shteti nuk ka fe, qoftë ky ateizmi ose agnosticizmi. Rrjedhimisht, laicizmi perceptohet si një mekanizëm i ndërtuar për të përjashtuar besimet nga mjediset publike dhe jo si një rregullator që ruan balancat e diversitetit fetar.

Laicitet do të thotë ndarje e shtetit nga feja dhe jo luftë e shtetit me fenë. Kjo ndarje nënkupton që shteti nuk përkrah



ose nuk mbështet asnjë pikëpamje fetare. Pra, shteti është neutral në çështjet e religjionit dhe të besimit dhe kjo nënkupton gjithashtu edhe trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve të tij, pa marrë parasysh fenë e tyre dhe numrin e tyre në një komunitet, duke e respektuar plotësisht lirinë e mendimit.

Në kuadrin e demokracisë liberale, laiciteti nënkupton lehtësira të barabarta për të gjitha fetë, pa përqafuar dhe pa predikuar asnjërën prej tyre. Kjo do të thotë që në hapësirën publike, shteti nuk duhet të shfaqë simbole fetare. Pra, institucionet shtetërore nuk duhet të vendosin simbole fetare në hapësirën e tyre. Por kjo nuk do të thotë që shteti është kundër çdo shfaqje fetare në hapësirën publike.

Sa i takon qytetarëve, ata gjenden në pozita krejt të ndryshme nga shteti dhe pushtetet publike në përgjithësi. Ata janë njerëz të lirë, të cilëve kushtetuta ua lejon dhe ua njeh të drejtën e lirisë së besimit, që do të thotë, mundësinë e përzgjedhjes së njërës ose tjetrës fe, ose edhe asnjërën prej tyre. Njëherazi, u garanton atyre që ta shprehin besimin e tyre lirshëm në publik, përfshirë këtu edhe prozelitizmin, gjithmonë duke respektuar edhe të drejtat e të tjerëve. Shteti, duke qenë laik, është i detyruar të shfaqë paanshmërinë e tij, por nga ana tjetër, qytetarët janë të lirë të përzgjedhin besimin fetar ose bindjet e tyre jofetare

Laicizmi nuk mund të ekzistojë pa prezencën e fesë, pikërisht sepse nuk mund të flitet për ndarje të fesë nga shteti pa ekzistuar feja. Kjo ndërlidhje prodhon forma kundërshtie nga të dyja palët. Për të zëvendësuar fenë, regjimet laiciste prodhojnë modelin e tyre “fetar” me ritualet e tempujt përkatës, të cilët sociologët i quajnë pjesë e religjionit civil.

Feja nuk është çështje vetëm personale. Disa nga sociologët më të njohur të religjionit si Jose Casanova ose Peter Berger kanë vënë në dukje se globalisht feja, qysh nga fillimi i viteve ’80 është çprivatizuar dhe ka hyrë në sferën publike. Shumë studiues, duke komentuar fenë në shoqërinë civile, thonë se sot jemi në fazën post-shekullariste. Kjo nuk do të thotë se kemi përmbysje të shekullarizmit, por një rinegociim të prezencës së fesë në shoqëri.

Profesori i Universitetit të Yale-s, Jeffrey Alexander, shprehet se demokracitë liberale, në vend të ‘mureve izoluese’ për t’u mbrojtur nga grupet e tjera kulturore, duhet të promovojnë komunikimin dhe integrimin. Shteti duhet të krijojë hapësirat e mundshme për këtë qëllim dhe jo të sillet ‘armiqësisht’ dhe në forma ‘militare’ me të ‘kundërtit’. Ai ka nënvizuar se mekanizmat që e përdorin laicitetin si platformë ideologjike për t’u mbrojtur nga traditat e reja kulturore ose fetare, janë të dështuara dhe nuk kanë sjellë efekte pozitive në shoqëritë liberale.

Politika e përjashtimit nën petkun e laicizmit

Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit të Kosovës, me të cilin nxënësve të shkollave të mesme dhe të larta u ndalohet bartja e 'uniformës fetare' në objektet e institucioneve arsimore, u perceptua si ruajtje e laicizmit të Kosovës.

Fatkeqësisht, ky është koncepti i laicitetit që mbrohet nga shteti ynë. Laiciteti është kuptuar si një hapësirë publike, ku gjithçka duhet të zhvishet nga dimensioni fetar. Qytetari, që të marrë pjesë në hapësirën publike, duhet të heqë dorë nga besimi i tij /ose i saj/ fetar. I vetmi individ që mund të marrë pjesë në këtë hapësirë publike është individi ateist ose agnostik.

Kjo shfaq në formë të qartë konfliktin mes lirisë së besimit dhe laicitetit, i cili gjatë tranzicionit është duke u përpjekur për të zëvendësuar diktaturën e ateizmit në Shqipëri me diktatin e laicizmit në demokraci.

Laicizmi përjashtues në institucionet publike rrezikon të zhvlerësojë në sistemin e edukimit një ndër vlerat më kryesore, siç është ajo e respektit për kulturën, fenë dhe mendimin e tjetrit. Kjo lloj qasje rrezikon të prodhoje një shoqëri me identitete të steriotipizuara dhe me deformime sociale.

Shkolla publike është vendi ku fëmijët socializohen përmes një programi që promovon kohezion social dhe laiciteti garantohet nga mungesa e promovimit

në programet mësimore të superioritetit të një feje ndaj një tjetre. Potencialisht, kjo bën që nxënësit t'i shohin praktikat fetare të feve të tjera si praktika të zakonshme dhe jo si abstraksione me të cilat nuk janë familjarizuar. Në këtë aspekt, politikat e arsimit duhet të bazohen në multikulturalizëm dhe jo në 'laicizmin' diskriminues.

Logjika "laiciste" bazohet te binomi: 'shamia muslimane'– 'simbol'

Ne kemi një tendencë djallëzore për t'i drejtuar gishtin tjetrit në formë akuze dhe për të gjetur fajtorin në çdo hap, në vend që të mos harrojmë se për të jetuar në këtë vend na duhet shumë mirëkuptim dhe dashuri mes nesh. Kjo po ndodh shumë shpesh këto vitet e fundit me fenë islame dhe me njerëzit që e përfaqësojnë atë.

Rasti i vajzave që largohen nga shkolla, sepse mbajnë shami, është edhe rasti më i parë i këtij lloji. Njerëzit pozicionohen në dy taborë të kundërt: 'ne' dhe 'ata'. "NE"-ja pretendon të jetë pjesa e përparuar dhe mendjehapur (open mind) e shoqërisë dhe shpeshherë ka fytyrën e shtetit. Po, është interesante se, shpeshherë, "ne"-ja që është më aktive dhe që bën më shumë zhurmë, ka emra tipikë muslimanë…

Flakja e besimtareve të fesë islame jashtë institucioneve arsimore dhe administrative të vendit, për shkak të mbajtjes së shamisë, përbën një shqetësim të madh dhe shkakton precedentin e mohimit me ligj të të drejtave universale.

Këto raste janë bërë objekt i debateve mediatike. Opinioni publik, në përgjithësi, e ka mbështetur dëshirën e vajzave që të shkollohen në sistemin e arsimit publik, ndërsa administratat e shkollave kanë mbajtur një qëndrim të ngurtë, të justifikuar me rregulloren e shkollës që nuk lejon mbajtjen e "simboleve fetare".

Shamia muslimane nuk përbën simbol të Islamit. Feja Islame nuk ka asnjë simbol të njohur zyrtarisht si i tillë. Simboli është diçka konkrete që shpreh përmbajtjen e domethënies së një ideologjie. Ai i ka të përcaktuar karakteristikat e veta dalluese: ngjyrën, formën, përmasat. Ndërsa shamia muslimane nuk ka ndonjë formë, ngjyrë, ose përmasë të përcaktuar etj. Ajo është element i besimit dhe gëzon atributin e një detyrimi fetar të panegociueshëm. Në besimet e tjera simbolika të tilla nuk e gëzojnë këtë status.

Izolimi dhe getoizimi i muslimanëve

Asnjë kushtetutë e vendeve që pretendojnë të jenë demokratike nuk mund ta kundërshtojë ose të mos e marrë parasysh parimin madhor të lirisë së ndërgjegjes dhe të drejtës së besimit. Laiciteti i institucioneve publike nuk përbën një vlerë të të njëjtit nivel me atë të lirisë së ndërgjegjes. Liria e besimit është vlerë më madhore se sa laiciteti i institucioneve publike arsimore,

Shoqërisë sonë nuk i vjen asnjë e mirë nga margjinalizimi, përjashtimi dhe etiketimi i pabazë dhe i pavend i besimtarëve të fesë islame. Madje mosdhënia e hapësirës së duhur nga shteti për integrim dhe përjashtimi i tyre i padrejtë nga hapësira publike krijon premisa për radikalizim. Është naivitet të besosh se shtypja artificiale e identiteteve fetare na shpëton prej tyre. Historia ka dëshmuar se presioni gjithmonë jep efektin e kundërt: në vend që të shkaktojë tkurrje shkakton shtrirje më të madhe. Vallë çfarë kuptimi do të kishte zgjedhja në momentin kur e ne kemi asgjësuar shumësinë për të zgjedhur? Nga kjo rezulton vetvetiu se ne nuk kemi shkuar asgjëkund, por thjesht jemi duke i pohuar pafundësisht sistemet totalitare. Sigurisht, ngjarje të tilla do simulojnë vetizolimin dhe getoizimin e grupeve të caktuara. Atmosfera dhe realiteti shoqëror, në vend të ngritjes së kufijve ndarës të përjashtimit dhe barrierave të steriotipeve për 'tjetrin' të ndryshëm nga 'unë', duhet të promovojë, të përkrahë dhe të stimulojë gjithëpërfshirjen me anën e bashkëbisedimit dialogues, komunikativ dhe integrues.

Morali fetar është zgjidhja e të gjitha vështirësive

Është një fakt i pranuar se në shoqëritë ku nuk ka fe njerëzit bëhen të pabindur dhe shkaktojnë anarki dhe i kundërvihen shtetit. Ndërkohë për dikë që jeton me vlerat e fesë, ligjet e shtetit janë supreme. Nëse kërkohet, ai do të vinte jetën në rrezik për këto vlera. Pasi për një njeri të tillë, interesat e vendit të tij gjithmonë do të vijnë para interesave të veta. Ata ngrihen për vlerat shpirtërore dhe bëjnë gjithçka që kanë mundësi për t'i mbrojtur ato vlera. ■



Intervistë me zëvendëskryeministren dhe udhëheqësen e Republikës së Kosovës në negociatat

Bisedimet me Serbinë, ve

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë nacionale, njëherësh e emëruar nga Qeveria e Kosovës si udhëheqëse e delegacionit të Republikës së Kosovës në dialogun për çështje praktike me Republikën e Serbisë, Edita Tahiri, ka bërë të ditur se me Republikën e Serbisë do të bisedohet vetëm për çështje praktike.

"Dialogu me Serbinë ka një koncept shumë të qartë. Dialogu do të ndërtohet mbi konceptin e dy shteteve të pavarura dhe sovrane, të cilat kanë nevojë të adresojnë çështje praktike, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të cilat u ndihmojnë të dyja shteteve, sidomos në përmirësimin e jetesës së qytetarëve", - ka deklaruar Tahiri.

Ajo ndër të tjera ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi do të kontribuojë në kuptimin e ndërtimit të vlerave demokratike në rajon.

"Ky dialog është edhe një kontribut shumë i rëndësishëm për rajonin, në kuptimin e ndërtimit të vlerave demokratike, të bashkëpunimit rajonal, ndërfqinjësor dhe të shteteve, të cilat kanë për synim integrimin në strukturat euroatlantike", - është shprehur Tahiri.

Ajo ka deklaruar se institucionet e Kosovës janë të gatshme të nisin bisedimet praktike me shtetin e Serbisë. Sipas saj, Kosova gjatë bisedimeve do të jetë e barabartë me shtetin fqinj dhe aty do të bisedohet për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Për më shumë flet për revistën 'Paqja' zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë nacionale, njëherësh e emëruar nga Qeveria e Kosovës si udhëheqëse e delegacionit të Republikës së Kosovës në dialogun për çështje praktike me Republikën e Serbisë, Edita Tahiri.

PAQJA: ***Znj. Tahiri, përpos postit të zëvendëskryeministres së Kosovës, keni marrë edhe një detyrë shtesë, atë të kryenegociatores për ta udhëhequr dialogun Kosovë - Serbi. Cila mendoni se ka qenë arsyeja që kryeministri Thaçi ju ka emëruar në këtë pozitë?***

Tahiri: Në kuadër të kompetencave të mia si zëvendëskryeministre e Kosovës në Qeverinë Thaçi jam e ngarkuar me punët e politikës së jashtme dhe sigurisë nacionale. Duke marrë parasysh kompetencat e mia, kryeministri Thaçi ka vendosur të më emërojë mua për ta udhëhequr dialogun me Serbinë për çështje praktike.

PAQJA: ***Cilat do të jenë angazhimet tuaja konkrete para dhe gjatë dialogut Kosovë - Serbi?***

Tahiri: Dialogu me Serbinë ka një koncept shumë të qartë. Dialogu do të ndërtohet mbi konceptin e dy shteteve të pavarura dhe sovrane, të cilat kanë nevojë t'i adresojnë çështjet praktike, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të cilat u ndihmojnë të dyja shteteve, sidomos në përmirësimin e jetesës së qytetarëve të të dyja shteteve. Ky dialog është edhe një kontribut shumë i rëndësishëm për rajonin në kuptimin e ndërtimit të vlerave demokratike, të bashkëpunimit rajonal, ndërfqinjësor dhe të shteteve, të cilat kanë për synim integrimin në strukturat euroatlantike.

PAQJA: ***Tashmë, çdo ditë e më shumë, po flitet për fillimin e bisedimeve. A është i përgatitur ekipi i Kosovës për të nisur dialogun?***

Tahiri: Ne kemi filluar përgatitjen dhe kompletimin e ekipit negociator i cili do ta udhëheqë dialogun me shtetin serb.

PAQJA: ***Çfarë negociatash do të bëhen dhe si do të zgjidhet ekipi negociator? Çfarë përbërje do të ketë ai?***

Tahiri: Dialogu me Serbinë do të jetë vetëm për çështje praktike dhe sipas fushave që do të jenë në agjendën e bisedimeve. Sigurisht se unë do të përqendrohem për të marrë në këtë ekip profesionistët më të mirë që ka Kosova, që të kontribuojnë në fusha të caktuara. Në këtë drejtim, nuk do të ketë dallim



me Serbinë, Edita Tahirin

etëm për çështje praktike


Edita Tahiri - Zëvendëskryeministrja e Kosovës

se a do të jenë nga opozita a shoqëria civile. Të gjithë do të jemi të bashkuar për Kosovën dhe të ardhmen e saj. Sigurisht se unë do ta shfrytëzoj tërë potencialin e mundshëm që Kosova të dalë sa më mirë në këto bisedime.

PAQJA: ***Sa është e përgatitur Republika e Kosovës për negociata me Republikën e Serbisë, kur kihet parasysh se negociatat me atë shtet kanë qenë gjithmonë të vështira?***

Tahiri: Kosova si shtet i pavarur, sovran dhe me integritet territorial, ka Kushtetutën e saj demokratike dhe ne, si institucione, jemi në zbatim të plotë të Kushtetutës. Në këtë kontekst, në kuadër të konceptit tonë për politikën e jashtme, e mbështesim bashkëpunimin dhe dialogun si vlera perëndimore dhe demokratike. Gjithmonë kemi thënë, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dhe vazhdimisht e kemi bërë të qartë se ne jemi të gatshëm për dialog, i cili ndihmon zhvillimet dhe përparimet në të mirë të qytetarëve të dy shteteve dhe të rajonit.

PAQJA: ***E konsideroni të vështirë dialogun me Serbinë?***

Tahiri: Mendoj se dialogu çdoherë ka sukses nëse ka qasje konstruktive dhe kreative. Ne, si shtet i pavarur, do ta bëjmë këtë. Kosova ka përvojë në bisedime, por tani do ta shohim palën tjetër.

PAQJA: ***A do të kërkohet që, përpos BE-së, si ndërmjetësuese e këtyre bisedimeve të jetë edhe SHBA-ja?***

Tahiri: Tashmë dihet se palë e tretë në bisedime do të jenë Bashkimi Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), të cilët edhe më herët, por në rrethana krejt të tjera, kanë qenë ndërmjetësues. Më 17 shkurt të vitit 2008 ka përfunduar gjithçka sa u përket bisedimeve për status ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Vendi ynë është njohur nga vendet më të fuqishme që ka globi. Kosova është e gatshme të bëjë dialog me të gjitha ato shtete me të cilat mund të bisedohet për bashkëpunime, pra për bisedime të cilat ngrenë fqinjësinë e mirë, kontribuojnë në stabilitet dhe në zhvillim të suksesshëm. Për bisedime të nivelit bashkëpunues kanë nevojë të gjitha shtetet, sikurse ka nevojë edhe Kosova dhe Serbia.

PAQJA: ***Për çfarë temash Kosova nuk është e gatshme të negociojë me Serbinë?***

Tahiri: Çdo temë e cila e kalon kontekstin e dialogut praktik për Kosovën është e papranueshme dhe, mbi këtë bazë, ne do të bisedojmë me Serbinë vetëm për çështje praktike, në të kundërtën një dialog për çështje politike as që do të vijë në shprehje, sepse Kosova është shtet dhe ka institucionet e saj tashmë legjitime. Prandaj, i bëj thirrje Serbisë të jetë palë konstruktive në bisedime me Kosovën dhe të jetë shumë e vetëdijshme se do të bisedojë me një shtet fqinj, për të cilin duhet të ketë respekt. ■











REVISTA 'PAQJ

Gëzim QERIMI

Me ftesën e Universitetit Islamik Ndërkombëtar të Malajzisë, një delegacion nga revista 'Paqja' realizoi një vizite disaditore në Malajzi, përkatësisht në kryeqytetin Kuala Lumpur.

Delegacioni drejtohej nga drejtori i përgjithshëm i revistës për Aktualitet, Kulturë, Arsim, Etikë PAQJA, Muhamed Jusufi, redaktori teknik Osman Gashi dhe bashkëpunëtorët e revistës: Gëzim Qerimi, Sead Ujkani, Bernard Tahirbegolli, Arbër Zeka dhe Lavdim Gashi.

Gjatë vizitës, delegacioni i revistës 'Paqja' vizitoi institucione të ndryshme kulturore dhe arsimore të Malajzisë. Ndërsa aktiviteti kryesor gjatë vizitës ishte pjesëmarrja në ditën finale të aktivitetit edukativo-kulturor të titulluar 'Një Umet ose takimi i Umetit', aktivitet i përvitshëm që organizohet nga Universiteti Islamik Ndërkombëtar i Malajzisë, ku mysafir i këtij manifestimi të madh ishte edhe delegacioni ynë nga Kosova, përkatësisht delegacioni i revistës 'Paqja' dhe i studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në këtë aktivitet u paraqitën mbi 48 shtete të ndryshme të botës që kanë studentë në këtë universitet dhe që ishin pjesëmarrëse të këtij aktiviteti. Të gjithë studentët, me paraqitjet e tyre artistike e kulturore, paraqitën kulturën, traditat dhe përvojën e shteteve prej nga vinin.

Gjatë kësaj vizite vlen të ceket edhe takimi me drejtuesit më të lartë të Universitetit Islamik Ndërkombëtar të Malajzisë, duke përfshirë edhe rektorin e këtij universiteti, ku u diskutuan të gjitha format e mundshme të bashkëpunimit. Delegacioni i revistës 'Paqja' u takua edhe me studentët shqiptarë që studiojnë në universitetet e ndryshme të Malajzisë, të cilëve ju dhuroi disa qindra kopje të revistës 'Paqja', veprim i cili u



JA' NË MALAJZI

mirëprit jashtëzakonisht mirë nga studentët shqiptarë të Malajzisë.

Historiku

Malajzia është një vend në Azinë Juglindore, që përbëhet nga trembëdhjetë shtete dhe tre territore federale, me një sipërfaqe toke në një total prej 329.845 kilometrash katrorë.

Kryeqytet është Kuala Lumpuri, ndërsa Putrajaya është selia e qeverisë federale. Malajzia ka një popullsi mbi 28 milionë. Në aspektin gjeografik, Malajzia kufizohet me këto shtete: Tajlandën, Indonezinë, Singaporin dhe Brunein. Ky vend është pranë ekuatorit dhe ka një klimë tropikale.

Malajzia, si një shtet i bashkuar, nuk ka ekzistuar deri në vitin 1963. Në shekullin e 18-të, Britania e Madhe kishte themeluar kolonitë e saj në territorin e këtij vendi. Gjysma perëndimore e Malajzisë moderne përbëhej nga disa mbretëri të veçanta. Ky grup i kolonive britanike ishte i njohur si Malaya, deri në shpërndarjen e saj në 1946, kur ajo u riorganizua si Bashkimi malejzian. Për shkak të kundërshtimit të gjerë, ajo u riorganizua sërish si Federata e Malayas në 1948 dhe, më pas, fitoi pavarësinë më 31 gusht 1957. Më 16 shtator të vitit 1963, Singapori, Sarawaku, Borneo dhe Federata e Malayas u bashkuan për të formuar Malajzinë. Tensionet në vitet e para të bashkimit të ri ngjallën një konflikt të armatosur me Indonezinë, gjë që shkaktoi veçimin e Singaporit më 9 gusht të vitit 1965.

Gjatë shekullit të 20-të, Malajzia ka përjetuar një bum ekonomik dhe një zhvillim të shpejtë. Ajo kufizohet me ngushticën e Malacas, një vend ky me rëndësi në udhëkryqin ndërkombëtar, ku anijet e huaja kontribuojnë në ekonominë e vendit. Prodhimi përbën një sektor të madh të ekonomisë së vendit. Malajzia ka një gamë të biodiversitetit të florës dhe faunës dhe konsiderohet një nga 17 vendet e megadiversit.













JAPONIA E MBËRTHYER NG

Pas katastrofës me pasoja tragjike në Japoni, të shkaktuara nga tërmeti dhe cunami që e pasoi atë, gjendja vazhdon të jetë alarmante, ndërsa në vend vazhdon të rritet në mënyrë të frikshme bilanci i viktimave: vetëm në Miyagi konsiderohen të humbur dhjetë mijë vetë, ku më shumë se gjysma e popullsisë u përplas me dallgët e fuqishme. Aktualisht, përmasat e vërteta të katastrofës nuk janë të parashikueshme dhe tragjedia më e madhe deri tani mendohet se është regjistruar në prefekturën e Miyagi-t ku qyteza thuajse nuk ekziston më. "Japonia po përballet kështu me krizën më të rëndë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore", - tha Kryeministri Naoto Kan. "Japonia është gjunjëzuar, por nuk është nënshtruar", tha me zërin që i dridhej kryeministri i vendit, i cili u kërkoi qytetarëve të bëjnë përpjekje kolektive për të kontribuuar në nxjerrjen e vendit nga kjo krizë, më e rënda që prej 65 vjetëve, pikërisht që nga fundi i luftës së Paqësorit që përfundoi me bombardimet bërthamore në Hiroshima dhe Nagasaki. "Ju lutem ta konsideroni gjendjen aktuale si më të keqen në këto 65 vitet e fundit", - tha kreu i qeverisë së Tokios, teksa foli për shtypin nga Kantei. Kan u ktheu në vëmendje japonezëve përpjekjet e tyre për të ndërtuar vendin. "Vetëm duke bashkuar forcat, duke ndihmuar njëri-tjetrin mund ta kalojmë këtë krizë, mund të ndihmojmë Japoninë. Është kjo lutja që bëj për secilin prej jush. Ju falënderoj nga zemra për gjakftohtësinë në këto situata të vështira". Kan foli edhe për situatën në centralin bërthamor të Fukushimës. "Gjendja mbetet shumë e rëndë, por besoj se do të mund të shmangim një Çernobil të dytë". Por kësaj situate kaotike i shtohet edhe frika e ndonjë shpërthimi të mundshëm bërthamor, pasojat e të cilit do të ishin të pariparueshme. Pas tërmetit shkatërrimtar të së premtes dhe cunamit, qeveria japoneze nuk e përjashtoi mundësinë që në dy reaktorë të impiantit bërthamor Fukushima të dëmtuar rëndë, të ketë pasur shkrirje bërthamore të pjesshme. Në vend ekziston frika për një shpërthim të dytë në centralin bërthamor Fukushima 1. Teknikët po përpiqen me të gjitha mjetet të ftohin reaktorin 3, pas shpërthimit që ndodhi të shtunën në ndërtesën ku ndodhet edhe ai me numër 1. Shefi i stafit në qeverinë japoneze, Jukio Edano, tha se impianti mund t'i bëjë ballë ndikimit dhe vetë reaktori bërthamor nuk do të dëmtohet. Megjithëse zyrtarët po përpiqen të ulin frikën, punonjësit në centralin elektrik të Tokios thanë se nivelet e radioaktivitetit përreth centralit janë shtuar ndjeshëm, mbi nivelet e lejuara. Të paktën 200 mijë persona u shpërngulën nga zona pranë centralit. Sipas specialistëve, shpërthimi në reaktorin 3 do të jetë shumë më serioz, sepse aty ka plutonium dhe uranium. Ekspertët thonë se për aq kohë sa autoritetet japoneze mund të ftohin shufrat me lëndë djegëse, duke i mbuluar me ujë, ata mund të shmangin një tragjedi të





GA TËRMETET DHE CUNAMI

përmasave të mëdha. Teknikët hapën valvulat e reaktorit 3, duke lejuar daljen e avujve radioaktivë, për të ulur presionin e brendshëm. Qeveria japoneze zgjeroi kufijtë e zonës së shpërnguljes përreth Fukushimës, nga 1 në 20 km, fill pas shpërthimit të parë. Miliona japonezë nuk kanë energji elektrike dhe deri në muajin prill mendohet se do të ketë ndërprerje të programuara të energjisë. Vazhdojnë përpjekjet e ushtrisë dhe ekipeve të ndihmës, ndërsa vendi po sheh tanimë shkallën e pasojave të tërmetit shkatërrues. Organizata e Kombeve të Bashkuara po koordinon operacionet ndërkombëtare të ndihmës. Luftanije amerikane kanë mbërritur në brigjet e Japonisë për të ndihmuar në operacionet e ndihmës. Në pesë provinca janë ngritur më shumë se 1400 kampe emergjence. Qeveria ka dyfishuar numrin e ushtarëve për mbështetjen e forcave të shpëtimit në 100000. Pamjet satelitore tregojnë përmasat e shkatërrimit me të cilat u përball Japonia pas tërmetit, më i madhi që ka goditur vendin, i pasuar nga të tjera lëkundje që vazhdojnë të regjistrohen ende. Ekspertët besojnë se tërmeti 8.9 ballë i shkallës Rihter ka zhvendosur ishullin qendror të Japonisë me 2.4 metra dhe boshtin e Tokës me 10 cm.

Frika e tërmeteve, tajfuneve dhe efekteve anësore si cunami, një term me origjinë japoneze, është e rrënjosur në ADN e banorëve të këtij vendi, sepse prej mijëra vjetësh ata jetojnë me këto fenomene natyrore më shumë se çdo qytetar tjetër i planetit tonë. Këtë here Tokio e shmangu tërmetin e tmerrshëm, ku epiqendra ishte afër Sendait dhe Fukushimës. Për katastrofën e fundit të Tokios duhet të kthehesh në vitin 1923, kur qyteti u shua që nga themelet, ku pati më shumë se 100 mijë viktima dhe intensiteti i lëkundjeve që zgjatën dhjetë minuta, ishte 7.9 ballë. Pra kombinimi i të gjithë elementeve më të këqij të mundshëm. Pas tij, një tajfun me epiqendër afër ishujve të Izu Oshima, cunami dhe zjarri që la rreth 2 milionë banorë pa shtëpi. Vetëm bombardimet e amerikanëve në vitin 1945 shkaktuan të tilla dëme. Kuptohet se përse Tokio është një qyet i ri. Ajo që kemi kuptuar shumë mirë është se japonezët janë të stërvitur ndaj këtyre fenomeneve natyrore. Në çdo qytet mësohet si t'u përshtaten ngjarjeve të tilla. Çdo shtëpi ka mjetet e nevojshme për mbijetesë dhe banorët mësojnë vazhdimisht se çfarë duhet të bëjnë dhe si të sillen. Për të huajt duket diçka qesharake, por për japonezët dhe për fëmijët në shkollë është një lëndë që duhet ta dinë përmendësh. Stereotipi se shtëpitë e vjetra prej druri janë më rezistente, tregoi që ishte i rremë. Shtëpitë tradicionale janë të bukura, por tërmeteve të tilla nuk mund t'u bëjë ballë askush. Megjithatë shtëpitë pa themele, siç u pa edhe në këto ditë, nuk mund t'u rezistojnë cunameve dhe merren ashtu siç janë nga dallgët.

Përmblodhi A. A

Qelia e zbrazët në Sheveningen duhet të mirëpresë Gadafin

Tribunali i Hagës duhet urgjentisht që të ngrejë padi edhe kundër Gadafit, për krime kundër njerëzimit, që të marrë edhe ai atributin e merituar të kriminelit, njësoj si miku i tij, Slobodan Millosheviqi, i cili nuk doli i gjallë prej Sheveningenit

Milazim KRASNIQI

Moamer Gadafi po e vret popullin e vet, ashtu si vriste kroatët, boshnajkët dhe shqiptarët gjatë viteve nëntëdhjeta miku i tij, Sllobodan Millosheviqi. Ka zëra në mediet serbe që thonë se një kontingjent mercenarësh serbë të luftërave në ish-Jugosllavi, janë bërë garda kryesore e Gadafit në luftën civile që po e shkatërron Libinë. Taktikat e krijimit të tokës të djegur, duke bombarduar popullsinë civile edhe me avionë luftarakë, janë një film që është parë më herët në regjinë e Milloshevigit. Por, nga prirja kriminale e Moamer Gadafit, e cila në shumëçka është origjinale dhe mbase e papërsëritshme, mbesin të habitur vetëm ata që shtiren se janë të habitur. Karriera e tij prej psikopati dhe vrasësi serik nuk lë vend për asnjë habi. Mjafton një shpalosje e shpejtë e disa prej bëmave të tij, që të shihet se monstruoziteti i tij ka qenë dhe ka mbetur konsekuent që nga ardhja në pushtet me anën e grushtit të shtetit. Vitin e kaluar Moamer el Gadafi pati kremtuar dyzetvjetorin e ardhjes së tij në pushtet, ku binte posaçërisht në sy pjesëmarrja e presidentit të Serbisë, Boris Tadiqit, sepse mungonin mysafirë nga Europa. Natyrisht, në festime mungonte me arsye presidenti i Zvicrës, sepse Gadafi angazhohej për zhbërjen e konfederatës helevetike. Urrejtja e tij ndaj Zvicrës kishte lindur ngase i biri i kolonelit nuk ishte lejuar që në atë shtet të keqtrajtonte njerëz e të mos përgjigjet, ashtu si bën në shtetin privat të babës së vet. Nga punët e tjera të pista të Gadafit të vitit të shkuar ishte edhe pritja që i bëri al Megrahit, njeriut që ka pasur dorë në rrëzimin e avionit në Lakërbi të Skocisë me ç'rast patën humbur jetën 270 njerëz. Pritja si hero e një terroristi, tregonte se çfarë standardesh përdorte Gadafi për vlerat njerëzore. Ai nuk mund të gënjente e të thotë se Megrafi ishte i pafajshëm, meqë Megrahin e pati dorëzuar vetë dhe familjeve të viktimave u pati paguar dëmshpërblim në vlerë prej dy miliardë e shtatëqind milionë dollarësh. E dyta, për pjesëmarrjen në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, pati kërkuar që të vendoste shator në oborrin e godinave të ambasadës libiane në Nju Jork, sigurisht për ta vërtetuar para botës beduinizmin e tij të pakorrigjueshëm dhe për ta paraqitur botën muslimane si primitive dhe të paadaptueshme me standardet e botës tjetër.

Ndërsa, në planin doktrinar, Gadafi është autor i një ngatërrese ideologjike, të cilën truri normal nuk e honeps: "socializmi islamik". Shpikjet e tjera po aq bizare të tij nuk i kap kalemi. Por këtu po rikujtojmë edhe disa: Gadafi propozonte krijimin e një shteti të përbashkët izraelito-palestinez, me emrin Izratina (pra duke i bashkuar fjalët Izrael dhe Palestina!), krejt në kundërshtim me aspiratat palestineze dhe me projektin ndërkombëtar për krijimin e dy shteteve të veçanta. Gadafi deklaronte se mushkonjat që e shkaktojnë malarien, janë të vogla dhe nuk janë të rrezikshme. Për aidsin deklaronte se nuk e rrezikon Afrikën, ndërsa Afrika është një epiqendër e kësaj katastrofe. Gadafi ka qenë i deklaruar kundër Al Kaidës para 11 shtatorit 2001, por ka sponsorizuar organizatën "Shtatori i Zi", e cila ka qenë përgjegjëse për vrasjen e sportistëve të Izraelit në Lojërat Olimpike në Mynih, në vitin 1972.

Në planin e brendshëm, Gadafi për dyzet vjet i ka shkuar në plumb opozitarët potencialë, duke mbetur që të sundojë me të bijtë e të bijën e shfrenuar pas qejfeve e skandaleve.

Populli i Libisë, duke jetuar për dyzet vjet nën regjimin e tij brutal, ka mbetur i paemancipuar, i ndarë në fise dhe i pazhvilluar. Njerëz që kanë punuar e jetuar për disa vite në Libi, tregojnë se në atë vend ka sjellje shumë primitive të



qytetarëve të paarsimuar. Populli libian, po edhe kombi arab, kanë pasur shumë dëme nga ajo formë brutale e qeverisjes së Gadafit, sepse shembulli i tij u shërben edhe shumë abuzuesve të tjerë që sundojnë me brutalitet në shtetet arabe dhe afrikane.

Po Perëndimin a e ka penguar ajo formë brutale e qeverisjes? Pas Ronald Reganit, i cili pati bërë një përpjekje për eliminimin e këtij monstrumi, nuk ka mbetur asnjë trashëgimtar i denjë. Përkundrazi, ata që e këmbyen lirinë e Megrahit me transaksione të naftës, ata që e lënë Gadafin të ketë aksione në klubin e futbollit Juventus dhe të bëjë negociata për ta blerë Milanin, dëshmonin se Gadafi jo vetëm që nuk u pengonte, por e kishin partner të besueshëm. Pra, jo vetëm Tadiqi. Prandaj, ata heshtnin kur Gadafi i propozonte OKB-së zhbërjen e Zvicrës dhe heshtin edhe sot kur ai vret popullin e vet. Mirëpo, edhe Gadafi është duke shkuar drejt fatit të mikut të tij, Milloshevigit, fundit të turpshëm, që është i rezervuar për kriminelët psikopatë. Por, Tribunali i Hagës duhet urgjentisht që të ngrejë padi edhe kundër Gadafit, për krime kundër njerëzimit, që të marrë edhe ai atributin e merituar të kriminelit, njësoj si miku i tij, Slobodan Milloshevigi, i cili nuk doli i gjallë prej Sheveningenit. ■



Jemeni



Një i moshuar jemenas proteston kundër qeverisë dhe presidentit të Jemenit Ali Badullah Saleh

Arsim JONUZI

Luftërat vijnë si stinët e vitit dhe njerëzit tashmë janë mësuar me to, duke i numëruar si të ishin vitet e jetës: lufta e parë, e dytë, e tretë… Por lufta më e rëndë në Jemenin e Veriut ishte lufta e gjashtë. Ajo e shkatërroi dhe e shembi përfundimisht vendin që mezi mbahej në këmbë. Çdo cikël i ri armiqësish, çdo cikël lufte ishte më i rëndë, më i pamëshirshëm dhe më i ndërlikuar se i mëparshmi dhe mbi të gjitha, armët e konflikteve të fundit ishin më të sofistikuara dhe më vrastare se ato të konflikteve të fillimit. Mbi të gjitha, edhe më të shtrenjta. Konfliktet rriten e shtohen si qelizat kanceroze të tumoreve dhe ushqehen nga vuajtjet e njerëzve dhe interesat ekonomike të pakicës që sundon duke derdhur gjak. Në këtë vend, misionet humanitare e kanë punën e thjeshtë. Kjo sepse në këtë vend mungon gjithçka, që nga uji i pijshëm, buka e gojës, streha për të kaluar natën, mjekimet më të domosdoshme dhe më të thjeshta dhe kështu me radhë… gjithçka, edhe një majë gjilpëre është e mirëpritur. Pas misionit të fundit, OKB dhe BE do të ofrojnë këtë vit disa ndihma financiare. Gjithçka që duhet bërë është të çohen ndihmat dhe furnizimet në vendet më problematike. Por sigurisht që nuk është ky problemi dhe gjërat nuk zgjidhen me kaq. “Ne na duhet akses, akses, akses”, - thotë anëtarja e



delegacionit të ndihmave. Ndërkohë guvernatori i zonës së Saadës thotë me prepotencë dhe arrogancë se është ai që e di më mirë se ku është nevoja më e madhe dhe se paratë e ndihmave duhet që t'i jepen atij dhe, më pas, ai do të dijë të bëjë shpërndarjen e duhur. Për sa i përket misionit të OKB-së dhe BE-së, ai ishte i jashtëzakonshëm, sepse udhëtime të tilla të përbashkëta nuk janë të zakonshme dhe në praktikën e punës së të dyja agjencive. Por situata në Jemenin Verior është aq e rëndë dhe aq serioze sa rregullat nuk kanë më shumë vlerë. Delegacioni ecën nëpër gërmadhat e qytetit të Saadës. Shkatërrimi, karakteristika e vetme që të bie në sy në këtë qytet, është i papërshkrueshëm. Për fat, ndërtesat janë në më të shumtën e rasteve prej balte dhe qerpiçi dhe shembja e tyre i ngjan një grumbulli dheu mbi të cilin gëlojnë fëmijët. Nëse godinat do të ishin prej çimentoje, atëherë situata do të ishte më e rrezikshme. Në këtë zonë elektriciteti vjen nga gjeneratorët dhe uji i pijshëm transportohet përmes autoboteve. Por janë të shumtë ata që ndihen të lumtur që jetojnë aty. Jashtë mureve, edhe pse të shembura të qytetit, situata është më e rëndë. Kequshqyerja e të miturve në ato zona është pesë herë më e madhe se në Darfur. Disa prej këtyre zonave nuk kanë parë me sy që prej pesë vitesh asnjë lloj mjeku, infermiereje, ilaçi, pra janë shkëputur tërësisht nga sistemi sanitar. Që nga gushti i vitit të kaluar, në krahinat e veriut ka pasur një pushim zjarri, por ndërkohë situata është e brishtë dhe askush nuk mund të thotë se sa do të zgjasë e gjithë kjo. Gjashtë luftërat e mëparshme sollën një sasi jashtëzakonisht të madhe arsenali armësh dhe janë të shumta palët e interesuara që ky vend të vazhdojë të qëndrojë në konflikt të përhershëm. Qeveria bën sikur lufton konfliktet. Sipas një diplomati të lartë të vendit, Houthis është një familje e fuqishme që, edhe pse askush në vend nuk e pranon, ka fuqi dhe nuk mund të kundërshtohet dhe se ka pushtet në shumë pjesë të vendit, në ato zona ku qeveria nuk ka. Houthis është një tribu hashimitësh, që i bën të quhen pasardhës të drejtpërdrejtë të Pejgamberit Muhamed. Feja e tyre është Zaidizmi, një degë e shiizmit, por megjithatë ritualet e tyre janë të ngjashme me ato të muslimanëve sunitë. Kështu Houthisët dhe sunitët luten në të njëjtat xhami. Por konfliktet mes tyre nuk janë aspak fetare. Sipas analistëve të kësaj çështjeje, Houthis ndihen të braktisur nga qeveria qendrore, sepse ajo nuk i përkrah për zhvillimin dhe ndryshimin e situatës së mjerë. Edhe qeveritarët e Sanaas i kanë cilësuar rebelët Houthis si mbështetës të “Al Kaedës” dhe këtë e kanë bërë për të justifikuar fushatën e tyre në luftën kundër terrorizmit, që e kanë ndërmarrë përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky justifikim i ka shërbyer edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të justifikojnë edhe përdorimin e armëve të tyre, për të luftuar kundër “Al Kaedës” sipas pretekstit, sepse në fakt këto armë shërbejnë për të luftuar Houthisët. Lufta në veri të Jemenit ka dhunuar dy nga kolonat themelore të stabilitetit të vendit: formulën politike të premtuar mbi bazën e ndarjes së pushteteve dhe parimin e ngadalshëm të të dy entiteteve sektare. Për sa i përket anëtarëve të skuadrës BE dhe OKB, ata me shumë vështirësi dhe pas shumë negociatash lejohet që të takohen me përfaqësuesit e Houthisëve dhe qeveria megjithatë ua bëri shumë të qartë se rreziku do të ishte i madh dhe se ata nuk do të mund të siguronin asgjë. Kjo sepse përtej disa pikave të kalimit, qeveria nuk merr përsipër sigurinë e njerëzve. Përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar takohen me sheikun Abu Ali. Luftëtarët e tjerë që gjenden në dhomën e takimit i kanë vënë të gjithë kallashnikovët mbi gju. Luftëtarët janë të gjithë shumë të rinj në moshë dhe disa madje janë fëmijë, ndoshta 12 a 13 vjeç. Deri në këtë moment kur perëndimorët po e shohin me sytë e tyre këtë fakt, nuk e kanë ditur se në Jemen ekzistonin ushtarët fëmijë. Luftëtarët i sigurojnë të sapoardhurit se ata do të jenë të mbrojtur dhe të sigurt në zonën e tyre dhe se nuk do të ndikojnë në shpërndarjen që do t'u bëhen furnizimeve të ndihmave. Ata shpresojnë se qeveria do t'i çelë pikat e kalimit dhe do t'i lejojë karvanët e ndihmave që të depërtojnë edhe në zonat e rrezikshme e të varfra. Sipas koordinatorit të ndihmave të OKB-së në këtë zonë, problemi kryesor është policia. Shpesh karvanët e ndihmave plaçkiten dhe stafi i punonjësve grabitet. Kjo bën që shumë pak ndihma të përfundojnë aty ku duhet. Jemeni është i vetmi shtet arab që ka nënshkruar me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në vitin 1951, Konventën për Refugjatët. Më të varfrit në këtë vend janë edhe ata më mikpritësit dhe më të dashurit. Jemeni, më i varfri ndër të gjitha vendet arabe, i ofron azil të gjithë refugjatëve të luftës. Në këtë pjesë të humbur të botës ka shumë të tillë që strehohen. Çdo javë refugjatë nga Somalia vijnë në brigjet e Gjirit të Adenit. Etiopasit ndodhen kudo në vend me gratë dhe fëmijët e tyre. Sipas shifrave të OKB-së, në Jemen ka 350 mijë somalezë. Vendi nuk mund të ofrojë mikpritje të denjë për refugjatët e luftës, sepse nuk ka as ujë të mjaftueshëm, as spitale dhe as qendra të posaçme për të ardhurit e traumatizuar. Madje as për popullin e tij. Të ardhurat e vendit nga shitja e naftës dhe gazit zhduken. Në këto rrethana vendi sa vjen e zhytet në një varfëri, izolim e errësirë dhe kjo e shndërron automatikisht një vend që shumë shpejt do të pësojë ndryshime të mëdha, si pasojë e kryengritjeve. ■

Intervistë me Dr. Murad Hofmann

Islami në Gjermani dje, sot dhe nesër

Unë mendoj që ministri ynë i punëve të brendshme e ka me sinqeritet kur mendon dhe thotë: "Ne duhet të bëjmë diçka për të integruar Islamin në Gjermani. Muslimanët dhe Islami janë këtu, madje për të mirë". Por deri para pak kohe kjo nuk ka qenë bindja e zyrtarëve gjermanë. Deri para pak kohe ata patën shpresuar që t'i hiqnin qafe muslimanët

Intervistoi: Abu Bakr RIEGER

Epërshëndesim përzemërsisht mysafirin tonë të nderuar Dr. Murad Hofmann që ka ndarë kohën për të biseduar për Islamin në Gjermani, por edhe për muslimanët gjermanë. Zotëri Hofmann deri më tani ka publikuar 14 libra për Islamin, të cilat ua rekomandoj t'i lexoni. Ai ka qenë për 33 vjet rresht i angazhuar në shërbimin diplomatik dhe është musliman që prej më tepër se 30 vjet.



Dr. Murad Hoffmann, ish-ambasador i Gjermanisë në Algjeri dhe Marok

ABU BAKR RIEGER: ***Pyetja ime e parë do të ishte më tepër një pyetje personale. Çfarë ka qenë ndjenja juaj e brendshme si gjerman i qytetëruar dhe i formuar ta pranoni Islamin në një kohë, kur sigurisht pranimi i Islamit ka qenë shumë ekzotik?***

Dr. Murad HOFMANN: Bismilahi Rrahmani Rrahim. Kjo është një pyetje e mirë, saqë njeriu sot s'mund ta marrë me mend, se sa ka qenë normale të bërit musliman në atë kohë; jo normale në kuptimin e të qenit në sy, por normale në kuptimin se nuk pati zgjuar shumë kureshtje. Mua më ndihmoi shumë fakti se në ministrinë e jashtme unë kisha shokë dhe të afërm, të cilët e njohin botën dhe me gjasë ky është shkaku përse janë më liberal sesa gjermani i zakonshëm, i cili ka pak kontakte me pjesën tjetër të botës.

ABU BAKR RIEGER: ***Horizonti i përvojës suaj tashmë përbën një shtrirje kohore mbi 30 vjeçare; si musliman gjerman, pas gjithë këtyre viteve (sa i përket Islamit), a mund të tregoni se a është përmirësuar gjendja apo është keqësuar?***

Dr. Murad HOFMANN: Kur unë e vështroj gjithë këtë hapësirë kohore, gjykimi im në lidhje me këtë del i ndryshëm, varësisht vështrimit tim statik a dinamik. Nëse i shikoj ato për nga dinamizmi, vërtet unë mbetëm pa fjalë. Në atë kohë në Gjermani kishte vetëm 3 xhami, në pamje dhe në konstrukt të plotë si xhami; një në Munih, një në Achen dhe një në Hamburg. Dhe të gjithë muslimanët e Gjermanisë takoheshin 3 herë në vit; një herë në Munih, një herë në Achen dhe një herë në Hamburg dhe që të gjithë muslimanët i zinin brenda këto xhami. Kurse tani një paramendim i tillë është absurd, për shkak se sot nuk bëhet më fjalë për mijëra, por për një numër prej miliona muslimanësh. Ky është një dallim shumë i madh. Dallimi i dytë është së në atë kohë Islami ende nuk identifikohej me dhunën, ndërsa për terrorizmin as që bëhej fjalë. Por kjo ndodhi me rastin e Gadafit e të Homeinit, në një mënyrë shumë të rrufeshme.

ABU BAKR RIEGER: ***Si, ose thënë më mirë, përse i vjen kaq vështirë një mus-***

Kush është Murad Hoffmann? Dr. Murad Wilfried Hofmann është lindur në vitin 1931 në Aschaffenburg dhe rrjedh prej një familje katolike. Më 1957 i kreu studimet për drejtësi në Shkollën e Drejtësisë në Munih dhe më 1960 në Harvard. Për 33 vjet rresht ka punuar në shërbimin diplomatik të Gjermanisë. Ai ka qenë ambasador i Gjermanisë në Algjeri dhe në Marok. Po ashtu, ka qenë drejtor i NATO-s për informim. Është konvertuar në vitin 1980 në Islam. Që prej atëherë ka publikuar 14 libra dhe ka mbajtur shumë kumtesa me tematikë islame. Në vitin 1992 publikoi librin e tij të njohur "Islami si alternativë", i cili zgjoi interesim të madh në mbarë botën islame. Kurse në vitin 2009 për kontributin e tij të palodhshëm prej 3 dekadash për Islam, u dekorua në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe me çmimin "Personaliteti islam i vitit". Akualisht Dr. Hofmann jeton dhe vepron në Bonn.

limani që në ditët e sotme të bëhet i suksesshëm dhe që jetën e tij ta ndërlidhë me karrierën dhe me përditshmërinë?Ku qëndron problemi që ka kaq pak muslimanë gjermanë që janë të njohur dhe të pranueshëm në shoqëri, të cilët në një mënyrë i kanë ndoshta të gjitha pozitat për ta ndërlidhur, si me thënë, Islamin me suksesin?

Dr. Murad HOFMANN: Unë para së gjithash besoj se kjo është për shkaqe historike. Islami erdhi në Evropë përmes Spanjës deri në jug të Francës dhe përmes Ballkanit deri në Bosnje, si dhe për një kohë të shkurtër edhe deri në Vjenë; dhe kështu, shtetet, të cilat në një mënyrë gjatë historisë kanë ardhur disi në kontakt me Islamin, kanë një qëndrim të ndryshëm për të. Qëndrimi më racional është ai i Spanjës, e cila tashmë është edhe krenare për historinë islame të vendit të vet. Gjermania në anën tjetër, për herë të parë ka rënë në kontakt me Islamin – nëse një gjë e tillë mund të quhet Islam – me rastin e rrethimit të Vjenës nga ana e osmanlinjve dhe ky, si takim i parë, natyrisht se është takimi më i keq i mundshëm. Prandaj, Islami është kuptuar si rrezik dhe nga këndvështrimi i gjermanëve ka mbetur si rrezik qysh deri në ditët e sotme. Ky është ai dallimi i madh.

ABU BAKR RIEGER: ***Në kohën e fundit ne përsëri po përjetojmë do të thosha një dëmtim të imazhit të muslimanëve në Gjermani, për shkak të pranisë së fenomenit se muslimanët me gjasë kanë qenë të angazhuar në aksione terroriste ose kanë pasur plane në lidhje me to. A shihni ju këtu një dëmtim të imazhit dhe a jemi distancuar sa duhet prej këtyre muslimanëve?***

Dr. Murad HOFMANN: Në lidhje me këtë unë më parë e shoh një simptomë. Sulme terroriste ka në gjithë botën. Fakti që një burrë e mbyt gruan e tij është diçka e përditshme në Gjermani. Por vetëm atëherë kur është fjala për muslimanët, veprimet u atribuohen besimit të tyre. Kurse asnjëherë nuk theksohet – së paku nuk formulohet në shtyp – që vrasja e bashkëshortes, do të mund të kishte të bëjë diçka me religjionin katolik, kur bashkëshortët janë ose kanë qenë katolikë. Kështu, unë më parë besoj se është fiksuar një qëndrim strukturor antislam, sesa që këto qëndrime të ketë pasur mundësi të vijnë nga ndonjë ngjarje.

ABU BAKR RIEGER: ***Herë pas here shfaqen akuza se muslimanët gjermanë, ndoshta për shkak të shumë veçorive tipike gjermane, si për shembull: saktësia në kohë, të qenit strikt dhe përpikëria, anojnë veçanërisht nga format radikale të Islamit. Ju a do ta konfirmonit këtë gjë, apo do ta vinit në pikëpyetje?***

Dr. Murad HOFMANN: Unë besoj se çdonjëri, i cili e pranon një religjion, domethënë që është konvertuar ose reviduar në religjionin e tij të natyrshëm; fillimisht anon për të qenë 100% – e që në fakt është e pamundshme – musliman, katolik, hebre ose çfarëdo qoftë tjetër. Kjo nuk është diçka specifike islame. Njeriu rritet në një religjion, për arsye se prindërit e marrin fëmijën me vete në kishë dhe për shkak se në shtëpi festohen kërshëndellat, gjë që është diçka krejt tjetër, sesa kur njeriu e zbulon një religjioni të ri dhe e adopton atë për vete. Për të bërë këtë gjë, njeriu vërtet duhet të merret në tërësi me religjionin, saqë mund themi se më vonë i konvertuari arrin me gjasë ta njohë më mirë atë sesa



Dr. Murad Hoffmann

shumë muslimanë, të cilët janë rritur me religjionin e tyre.

ABU BAKR RIEGER: ***Cila do të ishte këshilla juaj drejtuar një muslimani të ri gjerman, i cili është konvertuar dhe i cili është në kërkim të diturisë, të cilën supozojmë se nuk do ta gjejë vetëm në internet dhe si mund të përforcohen në Gjermani ofertat e bartjes së dijes autentike islame?***

Dr. Murad HOFMANN: Atij, i cili arrin ta gjejë Islamin në Gjermani, i duhet një portë; i duhet një xhami me një mjedis islam. Është pothuajse e pamundshme bie fjala që përjetimi i ramazanit të përjetohet në atmosferë të plotë, nëse njeriu agjëron disi i vetëm. Domethënë formimi i bashkësisë është shumë i rëndësishëm. Në anën tjetër, ajo ka një efekt tjetër – tani nuk dua ta shoh patjetër si disfavor – që muslimani gjerman i konvertuar, çdoherë e më shumë, ka më pak kontakt me rrethin e vet shoqëror të mëparshëm. Kjo ndodh pikërisht për shkak të ndalesës së alkoolit. Unë e kam përjetuar vetë këtë gjë. Kur njeriu ftohet (në ndonjë aheng), në Gjermani, kremtimi do të thotë alkool. Kremtimi pa alkool as që mund të mendohet këtu. Nëse dikush si ne i përgjigjet ftesës, shkon atje, ulet dhe nuk pi alkool, atëherë ai përshëndetet nga të pranishmit për një kohë relativisht të gjatë, që pas mbarimit të ndejës t'i dërgojë të de-



hurit për në shtëpi. Mirëpo, me ose pa dashje, ai perceptohet si një trup i huaj; dhe para se gjithash njeriu që s'është i dehur nuk mund të qeshë për shakatë, të cilat i bëjnë të dehurit, duke qenë se ata qeshin për gjëra të cilat shpeshherë nuk janë aspak qesharake për njeriun që nuk konsumon alkool dhe në këtë mënyrë fillon eliminimi. Nëse njeriu në Gjermani sillet si musliman, atëherë një ditë prej ditësh ai do të vërë re se e ka eliminuar në mënyrë parciale veten, ose është eliminuar (nga të tjerët).

ABU BAKR RIEGER: ***Ju qysh prej dekadash jeni musliman prominent. Çfarë në të vërtetë ka mbetur "gjermane" te ju?***

Dr. Murad HOFMANN: Unë besoj që secili njeri ka identitete të ndryshme. Njeriu nuk është vetëm gjerman, por edhe nga Kylni, edhe jurist, edhe i martuar; dhe në rastin tim mund të ketë një bashkëshorte të huaj sikur unë, me ç'rast njeriu depërton po ashtu edhe në një kulturë tjetër. Gruaja ime e parë për shembull ka qenë amerikane, ajo ka vdekur; gruaja ime e dytë ka qenë turke, ajo është ndarë, ka kërkuar të ndahet, sepse nuk ka mundur ta durojë islamin tim si turke. Dhe tani jam i martuar me një bullgare. Kështu, secilën herë hapet një derë krejt tjetër, drejt një kulture të re. Dhe unë besoj që kjo nuk është diçka tipike për muslimanët, por një përvojë e përditshmërisë njerëzore. Ai që nuk i hap dyert e tij, mbetet një proletar.

ABU BAKR RIEGER: ***Johan Volfgang Gëte në veprat e tij flet për qytetarinë botërore dhe ai vetë pati qenë shumë i fascinuar prej Islamit. Pyetja ime do të ishte: Përse muslimanët mbahen kaq të shtangur në nacionalizmat e tyre? Përse pikërisht ata – të cilët në fakt janë të predestinuar për qytetarinë botërore – janë burgosur kaq thellë në pikëpamjet e kombësive të tyre?***

Dr. Murad HOFMANN: Unë besoj që ky është një reaksion normal i emigrantëve. Emigrantët në fillim nuk e flasin ose e flasin shumë dobët gjuhën e shtetit pranues. Atyre u duhet çdo ndihmë e mbështetje e mundshme dhe për këtë arsye mbyllen. Unë këtë gjë e kam përjetuar me emigrantët gjermanë në Amerikë. Për shembull, ata e kanë formuar "German Town in New Jork", ose "Little Italy in Down Town Manhattan". Ky është një reaksion krejtësisht i natyrshëm. Por ajo që më shqetëson është fakti kur kjo gjë vazhdon për më shumë gjenerata. Por përse një gjë e tillë vazhdon me turqit në Gjermani? Sepse te një pjesë e madhe e tyre është zakon ta marrin bashkëshorten nga Turqia. Kjo do të thotë se integrimi fillon çdoherë nga zeroja me një grua turke, e cila si të thuash është importuar nga Anadolli.

ABU BAKR RIEGER: ***Si duket ekzistojnë përpjekje nga ana e shtetit – po e përmendi shkurt konferencën islame – për të integruar Islamin në Gjermani dhe për ta bërë atë vendas; ka xhami të reja, ka shumë aktivitete. Si e shihni të ardhmen e Islamit në Gjermani, a e shihni me optimizëm në kuptimin e harmonisë, apo me pesimizëm në kuptimin e konfrontimit të shumanshëm?***

Dr. Murad HOFMANN: Sa më shumë që Islami bëhet i dukshëm në Gjermani dhe sa më shumë që rritet në numër, aq më shumë rriten sipërfaqet fërkuese. Unë mendoj që ministri ynë i punëve të brendshme e ka me sinqeritet kur mendon dhe thotë: "Ne duhet të bëjmë diçka për të integruar Islamin në Gjermani. Muslimanët dhe Islami janë këtu, madje për të mirë". Por deri para pak kohe kjo nuk ka qenë bindja e zyrtarëve gjermanë. Deri para pak kohe ata patën shpresuar që t'i hiqnin qafe muslimanët. Me këtë tani vërtet se qëndrojmë më mirë. Ekzistojnë diku 128 xhami në pamje dhe konstrukt të plotë si xhami dhe i njëjti numër i xhamive është në ndërtim e sipër. Kështu që tashmë edhe nga ana infrastrukturore Islami është ankoruar në atë mënyrë saqë lirisht mund të themi se Islami është pjesë e peizazhit gjerman dhe se do të mbetet i tillë. Por kjo nuk do të thotë se konfliktet do të zhduken, – dhe me këtë po kthehemi prapë te fillimi i bisedës sonë – sepse qëndrimi gjerman kundrejt religjioneve të huaja nuk ka qenë kurrë tolerant. Deri në shekullin e 18-të në Gjermani janë ushtruar vrasje ndërmjet vete, vetëm pse njëri ka qenë protestant dhe tjetri katolik; dhe arsyeja që sot ende ka katolikë dhe protestantë në Gjermani, nuk është për shkak të tolerancës së ndërsjellë, por nga paaftësia e tyre për t'u zhdukur totalisht në shekullin e 17-të ndërmjet vete. Ky është sfondi gjerman. Dhe nga ky prizëm, Austria qëndron krejtësisht ndryshe, sepse austriakët si shtet shumëkombësh, prej shekujsh e kanë pasur mundësinë që të mësojnë se si të sillen me gjuhët, kulturat dhe me religjionet e tjera; dhe si rezultat i kësaj pozita e Islamit në Austri është diametralisht ndryshe sesa atë që e kemi këtu. Mirëpo, tani është e pamundshme t'ua japim gjermanëve këtë përvojë multikulturore.

ABU BAKR RIEGER: ***Siç e di, ju jeni po ashtu një udhëtues i madh. Ju keni qenë në të gjitha pjesët e botës me synime të ndryshme, por gjithmonë keni udhëtuar edhe për çështje të Islamit. A e keni ndier veten të pranueshëm si musliman në çdo vend në të cilin keni qenë gjatë karrierës suaj?***

Dr. Murad HOFMANN: Po, pothuajse gati në çdo vend, si për shembull në Malajzi, në Pakistan, në Afrikën Veriore, në Gjirin Persik; por në Arabinë Saudite jo edhe gjithaq. Në Medine, për shembull, unë kisha përshtypjen se atje ekziston qëndrimi i të qenit popull i përzgjedhur, ngjashëm si populli hebre dhe se kundrejt të porsaardhurve ka skepticizëm. Unë nuk ua zë për të madhe, sepse një musliman i ri i konvertuar, vërtet se ka shumë për të mësuar.

ABU BAKR RIEGER: ***Zotëri Dr. Murad Hofmann ju falënderojmë përzemërsisht për bisedën në IZ TV dhe po ashtu për opinionet tuaja dhe shpresoj të takohemi së shpejti sërish në studio.*** ■

Përktheu nga gjermanishtja:
Avni XHEMAJLI

A KËRKON FILLIMI I RI NË EGJIPT NJË KUADËR TË

John ESPOSITO. Bashkautore
Sheila B. LALWANI

Përmbysja e sundimit 30-vjeçar të Hosni Mubarakut dhe fillimi i ri në Egjipt ka shkaktuar frikën e ndryshimit të pasigurt në rajon në zemrat e shumë sunduesve. Kjo ka inspiruar protesta në Algjeri, Marok, Jordani, Siri dhe Jemen; krijimin e partisë politike në Arabinë Saudite; dhe shqetësimet në Republikën Islamike të Iranit, që është lëkundur aq shumë nga Lëvizja e Gjelbër në zgjedhjet e fundit presidenciale.

Fundi i regjimit të Mubarakut demonstron falsitetin e stereotipeve që kanë mbizotëruar zakonisht se arabët kundërshtojnë demokracinë, se Islami është i papërshtatshëm me sovranitetin e popullit dhe se kthetrat e sundimtarëve të shteteve të sigurisë janë të palëkundura. Protestuesit pro-demokratikë ishin të nxitur nga ankesat e gjata politike dhe ekonomike: mungesa e demokracisë, rritja e hendekut mes pakicës së pasur, klasës së mesme dhe të varfërve, korrupsioni i shfrenuar, rritja e çmimeve të ushqimit, niveli i lartë i papunësisë, mungesa e mundësisë dhe e së ardhmes për të rinjtë. Egjiptianët rivendosën dinjitetin dhe kontrollin në jetën e tyre, duke kërkuar fundin e korrupsionit të përhapur në vend përmes llogaridhënies së qeverisë, transparencën, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe të drejtën për të përcaktuar qeverisjen dhe të ardhmen e Egjiptit.

Kryengritjet në Tunizi dhe Egjipt kanë nxjerrë në pah një lëvizje me bazë të gjerë pro-demokratike, jo të udhëhequr nga një ideologji e vetme ose nga ekstremistë fetarë. Ajo që ka ndodhur nuk është një përpjekje për ardhjen në pushtet të islamistëve, por një thirrje me bazë të gjerë popullore. Shenjat, pankartat, deklarimet dhe kërkesat demonstruan se protestuesit e duan unitetin e Egjiptit, flasin për një Egjipt dhe këndojnë himnin kombëtar të Egjiptit; ata mbajnë në duar flamujt egjiptianë, jo ndonjë pankartë islame. Njerëzit, nga çdo sferë e jetës, profesionistët dhe punëtorët, ishin të bashkuar për një qëllim të përbashkët.

E habitshme? Jo edhe aq. Sondazhi botëror i Gallup-it, në më shumë se 35 vende me shumicë muslimane, që përfaqësojnë zërat e një miliardë muslimanëve, raportojnë se në Egjipt dhe në shumicën e vendeve islame, shumica kanë kërkuar një demokratizim më të madh, liri dhe sundimin e ligjit. Kjo nënkupton, për fat të keq, se SHBA-ja dhe shumë vende evropiane kanë vazhduar që të mbështesin regjimet autoritare me politikat e tyre afatgjate, duke i konsideruar si shtete të sigurta. Përkundër pretendimit të Amerikës për të promovuar demokracinë dhe të drejtat e njeriut, ashtu siç ka proklamuar administrata e Bushit, Amerika (pas gjithë presidentëve të fundit) ka pasur një trashëgimi të "përjashtueshmërisë demokratike", që shumica e kanë parë si një "standard të dyfishtë", promovimin e supozuar amerikan të demokracisë globalisht, por mbështetjen e regjimeve autoritare në botën islame. Kjo politikë, përderisa ishte atraktive për aleatët autoritarë dhe elitat e tyre të ngulitura, ka ushqyer anti-amerikanizmin dhe frikën e intervenimit perëndimor, pushtimin, okupimin dhe varësinë në anën tjetër.

Rruga përpara

Uashingtoni e ka monitoruar nga afër situatën në Egjipt, Tunizi dhe Jemen. Nga shteti i tij i SHBA-ve, Presidenti Obama foli për Egjiptin dhe e bëri këtë përsëri gjatë ndeshjes së përvitshme të futbollit amerikan, që njihet si Super Bowl, në televizionin Fox News, me komentuesin Bill O'Reilly. Presidenti Obama ripërsëriti mbështetjen e tij për popullin e Egjiptit, por ato fjalë duhet të mbështeten nga veprime të qarta.

Ne jetojmë në një botë që po ndryshohet në shumë drejtime, ashtu siç e ka bërë të ditur vazhdimisht edhe vetë Presidenti Obama prej fillimit në administrimin e ti, dhe kjo botë kërkon një respekt të ndërsjellë dhe bashkëpunim. Do të jetë sfidë për politikëbërësit amerikanë dhe evropianë që të lëvizin përtej mbrojtjes së barabartë të interesave kombëtare me stabilitet dhe siguri të regjimeve, përtej frikës së të panjohurës së një procesi, rezultatin e së cilit nuk mund ta kontrollojnë, drejt një politike të bazuar në parimet amerikane të vetëpërcaktimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Një kuadër i ri, i bazuar në punën me qeveri të votuara në mënyrë demokratike në Egjipt, Tunizi dhe vendet të tjera në regjion, përbën një rrezik më të vogël për një të ardhme të parashikueshme, që punon me një qeverisje më të pavarur me vizionin për interesat e tyre kombëtare. Ashtu siç e bëjmë me shumë shtete, aleatë dhe joaleatë, përreth botës, marrëdhëniet tona do të bazohen në interesat kombëtare dhe në interesat e përbashkëta politike, strategjike, ekonomike dhe ushtarake. Për dallim nga e kaluara, SHBA-ja duhet ta vendosë theksin primar tek investimet në ndihmën edukative, ekonomike dhe teknologjike të Egjiptit sesa në atë ushtarake, duke punuar veçanërisht me organizata joqeveritare të pavarura. Përpjekjet tona duhet të jenë për multilateralizmin e vetëdijshëm, duke i dhënë fund, siç e ka theksuar edhe Presidenti Obama, unilateralizmit amerikan.



Sidoqoftë, multilaterializmi (shumanshmëria) gjithashtu nënkupton partneritetin amerikan në zhvillimin ekonomik të Egjiptit me biznesmenët e pasur egjiptianë, të cilët nevojitet të investojnë në ekonominë e tyre, ashtu sikurse edhe vendet dhe kompanitë arabe të naftës, e jo vetëm iniciativat e thjeshta amerikane që do ta rrezikonin kapitalin. Ne duhet ta pranojmë se ka një tregim të ri në Lindjen e Mesme. Është kritike situata kur populli egjiptian po lëviz përpara dhe do të jetë njëjtë në kuptimin e ndërtimit të një uniteti kombëtar, në ndërtimin e një sistemi demokratik, pluralist dhe politik shumë-partiakësh që përfaqëson diversitetin e shoqërisë egjiptiane. Kjo do të ishte e rëndësishme për të siguruar një të ardhme të Egjiptit që nuk do të rrëmbehej nga ushtria. Përderisa ushtria ka premtuar të mbikëqyrë tran-

zicionin në demokraci, shumë eprorë të vjetër i kanë rritur interesat dhe apetitet për pushtet dhe privilegj, interesat për biznes dhe kulturën për një sundim ushtarak: të gjithë udhëheqësit e Egjiptit modern kanë qenë ish-ushtarakë Naseri, Sadati dhe Mubaraku. Ata kanë ardhur në pushtet përmes radhëve të tyre të besueshme dhe konsideroheshin si talentë. Në anën tjetër, nëse lëvizja pro-demokratike, por me dallime, mund të mbesë e bashkuar nën trysninë për demokratizim. SHBA-ja dhe Evropa mund të luajnë një rol të fuqishëm konstruktiv; veçanërisht me ndihmë ekonomike, teknologjike, edukative sesa ushtarake dhe posaçërisht të mbështesin organizatat joqeveritare të pavarura dhe organizata të tjera të shoqërisë civile, që do të përbënte një dallim të madh. Por çfarë është frika për një marrje të pushtetit nga Vëllazëria Muslimane?



Është koha të shikojmë në evidencën empirike. Që nga vitet e hershme të shek. XX, larg nga të qenit avokatë të ekstremizmit fetar, Vëllazëria Muslimane, sikurse kandidatët dhe partitë e tjera politike me orientim islam në Algjeri, Tunizi, Marok, Egjipt, Liban, Turqi, Kuvajt, Bahrejn, Pakistan, Malajzi dhe Indonezi, janë përcaktuar për zgjedhjen me vota, jo me plumba. Në mesin e kritikëve më të vrullshëm (dhe armiqve) kundër Vëllazërisë kanë qenë ushtarakët egjiptianë, duke përfshirë edhe Ajmen al Zavahirin e Al Kaidës. Për dekada, Vëllazëria Muslimane, edhe pse zyrtarisht ilegale, ka dëshmuar të jetë lëvizja më e madhe opozitare, jo e dhunshme politikisht dhe me marrëdhënie shoqërore në tërë shoqërinë e Egjiptit. Për dallim nga organizimi radikal ekstrem egjiptian, Vëllazëria ka garuar dhe ka arritur sukses në zgjedhje përkundër ngacmimeve të vazhdueshme qeveritare, përfshirë burgimin dhe arrestimin pa akuzë ose dënim. Dhe prapë ka mbetur jo e dhunshme. Në anën tjetër, qeveria e Mubarakut ka realizuar një represion të vazhdueshëm dhe të pandërprerë me dekada, zgjedhje të manipuluara dhe përdorim të dhunës nga leshkot qeveritarë për të trembur dhe ngacmuar të gjithë sekularistët dhe islamistët opozitarë. Ka kontrolluar krijimin dhe rregullimin e organizatave joqeveritare të shoqërisë civile dhe mediat dhe ka përdorur gjyqe ushtarake për të shmangur gjykatat me mendësi të pavarur të Egjiptit.

Por çfarë mund të thuhet për rolin e Vëllazërisë Muslimane në kohën e ndryshimit politik dhe në Egjiptin post-Mubarak?

Vëllazëria, pa dyshim, që do të vazhdojë të ketë një rol me ndikim; megjithatë, në një klimë të re dhe më të hapur pluraliste politike, ata do të jenë një nga lojtarët dhe partitë potenciale politike. Vëllazëria Muslimane, sikurse Ennahada e Tunizisë dhe sikurse shumë parti të tjera islame, në zgjedhjet e kaluara për shkak të mungesës së zgjidhjeve të tjera politike, kanë mbetur e vetmja lojë në treg. Ata mblodhën votat jo vetëm të anëtarëve dhe mbështetësve të tyre, por edhe të atyre që donin të shprehnin opozitën ose mosmiratimin me qeverinë. Vëllazëria as nuk e ka iniciuar dhe as nuk e ka udhëhequr lëvizjen protestuese në Egjipt. Shumë ekspertë besojnë se thelbi i mbështetjes së tyre do të arrinte 25% të popullatës më së shumti. Në zgjedhje të lira dhe të drejta me një sistem shumë-partiak, ata sigurisht që do të jenë të rëndësishëm, por jo domosdo faktor dominues. Dhe në të vërtetë, Vëllezërit Muslimanë, sikurse tërë egjiptianët e tjerë, kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje dhe të përfaqësohen në qeveri. Veç kësaj, Vëllazëria ka bërë të ditur se nuk do të ketë një kandidat që do të garojë për president dhe as nuk kërkon ndonjë pozitë në kabinetin qeveritar në zgjedhjet e ardhshme.

Populli egjiptian, ashtu sikur ai tunizian, ka arsye për të festuar triumfin dhe të kënaqë ndjenjën e fuqizimit dhe SHBA-ja ka çdo arsye për t'iu përveshur punës për transferimin e ri të pushtetit në Egjipt dhe Tunizi dhe procesin e vazhdueshëm të transformimit politik që po paraqitet në Lindjen e Mesme. Barak Obama, në fillim të presidencës së tij, shkoi në Kajro dhe afirmoi "besimin e tij të palëkundur se tërë njerëzit janë të etur për gjëra të zakonshme: mundësinë për të folur për çfarë kanë në mendje dhe për atë se si po qeverisen; besimin në sundimin e ligjit dhe administrimin e barabartë të drejtësisë; qeverinë që është transparente dhe nuk vjedh prej popullit; lirinë për të jetuar ashtu si duan vetë. Këto nuk janë vetëm ide amerikane, janë liritë e njeriut dhe për këtë ne do t'i mbështesim këto gjithkund. Kur vjen puna për ballafaqim me forca pro-demokratike, le të ecim në mënyrën e duhur".

Në tranzicionin politik që po vjen, qeveritë dhe reformatorët emergjentë në Tunizi dhe Egjipt, do të përballen me formimin e qeverive të unitet kombëtar, të demonstrojnë premtimet për liberalizim politik, shoqëri civile dhe të drejta të njeriut nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të atyre institucioneve civile dhe vlerave që mbështesin demokratizimin.

Testi provues do të jetë shkalla në të cilën politikat dhe veprimet e tyre do të reflektojnë pranimin e lirive themelore demokratike, diversitetin e mendimit, partitë e shumta politike dhe organizimet e shoqërisë civile, si edhe vlerësimin për konceptin e një "opozite lojale", në vend të shikimit të zërave dhe vizioneve politike alternative si një kërcënim ndaj sistemit politik. ■

Revista Paqja ka arritur marrëveshje të drejtpërdrejtë me autorin për lejimin e botimit të tekstit.

Përktheu: Osman D. GASHI

Në përkujtim të prof. d

Për gjuhën janë të lehta të thuhen, por për jetën të vështira të përjetohen: një ndërhyrje ushtarake (12 mars 1971), një grusht shteti (12 shtator 1980), një grusht shteti "post-modern" (28 shkurt 1997), një udhëheqës, i cili ka jetuar dhe është ballafaquar me vështirësi, zëvendëskryeministër dhe ministër i ekonomisë në tri koalicione të qeverisë (CHP-MSP, MC-1 dhe MC-2), kryeministër i qeverisë (PR- DYP) së 54-të të shtetit, lider i lëvizjes "Milli Gurush", profesor ordinar, më i miri i shkollave që i vijoi…

Bernard TAHIRBEGOLLI

Prof. Dr. Nexhmetin Erbakani rrjedh nga një familje me nam, Kozanogullari. Ishte fëmija i tretë i Mehmet Sabri Erbakanit (gjykatës i krimeve të rënda në Turqi) dhe zonjës Kamer, i lindur më 26 Tetor 1926, në Sinop të Adanasë së Turqisë.

Kishte dy vëllezër më të mëdhenj, Nizar Erbakan - profesor i sëmundjeve të brendshme në Ankara dhe Selahattin Erbakan- profesor i Oftalmologjisë në Izmir. Ndërsa vëllai pas tij ishte Kemalettin Erbakan - mjek stomatolog dhe e pesta me radhë motra Atifet Ajdınfarmaciste, ndërsa fëmija i gashtë dhe njëherësh vëllai më i vogël i Erbakanit ishte Akgün Erbakan- arkitekt.

Nexhmetin Erbakani shkollën fillore e filloi në qytetin e Kajseri-së për ta përfunduar më pastaj në Trabzon si nxënësi më i dalluar shkollës.

Shkollimin e mesëm e vazhdoi në Kolegjin e Meshkujve në Stamboll, ku edhe u diplomua në vitin 1943 me sukses të shkëlqyer dhe me epitetin e nxënësit më të mirë të Kolegjit.

Gjatë shkollimit të tij të mesëm ndodhën disa ngjarje që e vunë në pah personalitetin e Erbakanit, inteligjencën e tij, prirjen për t'u bërë prijës, etjen për shkencë, ndihmën për shoqërinë dhe humanitet.

Shokët e tij rrëfejnë se: "Erbakani ishte i vetmi në atë kohë në Kolegjin e Meshkujve në Stamboll që kishte marr notën maksimale në lëndën e fizikës te pedagogu i njohur me nofkën "Sifirci Avni"(Avniu i zerove), i cili deri atëherë askënd më parë nuk e kishte vlerësuar me këtë notë."

Po ashtu, edhe pedagogu i kimisë zotëri Refiku kishte deklaruar para nxënësve të klasës së Erbakanit se "deri më tani askush nga unë nuk ka marrë notë mbi 5 ose 6, ndërsa ky fëmijë (fjala ishte për Erbakanin) do të ma thyej këtë parim".

Një kujtim nga shkollimi i mesëm e ka ndarë me ne edhe vetë Erbakani në një intervistë dhënë për njërën nga të përditshmet turke në vitin 2007, ku ndër të tjera tregoi: "Përderisa ishim në Kolegj, u shpjegoja shokëve shumë mësime. Shpeshherë gjysma e ditës më kalonte duke i dhënë mësime shtesë shokëve të shkollës. Të shtunave dhe të dielave në mësimet e veçanta kishte deri 20 nxënës që mësonin tek unë! Për këtë e dinin edhe mësuesit tanë dhe më kishin dhënë leje për një gjë të tillë."

Nexhmetin Erbakani shkollimin e lartë e vazhdoi në Universitetin Teknik të Stambollit, Fakultetin e Makinerisë. Edhe pse atë kohë nxënësit më të mirë të kolegjit i kishin vendet e rezervuara në universitet, Erbakani nuk e shfrytëzoi këtë të drejtë dhe iu nënshtrua provimit pranues dhe u regjistrua.

Prapë ndodhi diçka e veçantë: për shkak të rezultatit shumë të mirë të treguar, Universiteti ia mundësoi që shkollimin ta vazhdojë nga viti i dytë.

Pra, ia përshpejtuan shkollimin me një vit për shkak të rezultatit shumë të mirë të treguar dhe i mundësuan të vijonte mësimet me studentët e tjerë që ishin një vit më mëdhenj se ai!

Në vitin 1948 u diplomua në Fakultetin e Makinerisë të Universitetit Teknik të Stambollit. Po atë vit u emërua asistent në Katedrën e Motorëve të të njëjtit fakultet.

Gjatë studimeve në universitet ia kishin vënë nofkën "Kush"(pëllumb), ngase me punën e tij thuajse fluturonte në arritje të njëpasnjëshme.

Ndërsa në vitin 1951 shkoi në "Aachen Technische Hochschule" të Gjermanisë, ku punoi për një vit e gjysmë dhe aty mbrojti doktoratën.

Përgjatë studimeve të tij të doktoratës, ai bëri tri teza të doktoratës dhe mori titullin Doktor Inxhinier. Së bashku me Prof. Dr. Schmidt, i cili punonte për ushtrinë gjermane, kreu kërkime dhe studime të fushës së vet.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Erbakani u bë shkencëtari i parë turk që vazhdonte doktoratën në universitetet e Gjermanisë.

Në vitin 1953 u kthye në Stamboll për të mbrojtur titul-



r. Nexhmetin Erbakanit

lin Docent. Pasi e mbrojti tezën e doktoratës për Docent, u bë kështu Docenti më i ri në gjithë Turqinë dhe njëherësh edhe Docenti më i ri në Gjermani me vetëm 27 vjet.

Në punën e tij shkencore bëri ridizajnimin dhe konstruktimin e tankeve LEOPARD (tanket e Gjermanisë që i ngrinë gjatë luftës së ftohtë), të cilat punojnë edhe në kushtet më të vështira klimatike; punojnë edhe me benzinë, me mazut, me vajguri e nëse duhet edhe me vaj ulliri!

Në vitin 1954 u kthye në Stamboll për të kryer shërbimin ushtarak, ku shërbeu në divizionin e makinerisë për 18 muaj.

Ndërsa në vitin 1956 themeloi grupin "Gumus Motor" të përbërë prej 200 ortakëve që do të prodhonte motorin e parë vendor në Turqi.

Fabrika e "Gumus Motor" ka filluar punën e prodhimit serik me 1 Mars 1960.

Po në këtë vit, në panairin e produkteve të "Gumus Motor"-it, iu drejtua audiencës me fjalët e arta: "Objektivi i ri është që në Turqinë tonë, tani e tutje, të prodhojmë edhe automjete", të cilat edhe u bënë promotorë për prodhimin e automjetit të parë "Devrim Otomobili", nga kush tjetër pos Erbakanit.

Më 10 të vitit 1967 u martua me zonjën Nermin Erbakan, një ekonomiste e diplomuar, që atëkohë e njihte shumë mirë anglishten, gjermanishten dhe frëngjishten, një bashkëpunëtore e shkëlqyer dhe njohëse e mirë e rrethanave vendore dhe ndërkombëtare.



Në përcjellje xhenazës së ish-kryeministrit të Turqisë, Nexhmetin Erbakan

Prof.Dr. Nexhmetin Erbakan me zonjën Nermin kishin tre fëmijë, Zejnepen e lindur në vitin 1967, Elifen në 1974 dhe djalin e vetëm Muhamet Fatih Erbakan të lindur në vitin 1979.

Jeta politike e Erbakanit

Jeta politike e Erbakanit filloi si Sekretar i Përgjithshëm i Unionit të Dhomave të Turqisë, prej nga u detyrua të jepte dorëheqje nga presioni i udhëheqjes së asaj kohe.

Karrierën e tij politike, më pas, kërkoi ta vazhdojë nga pozita e deputetit të Partisë Adalet ("Partia e Drejtësisë"), por u pengua me veto nga kryeministri i asaj kohe dhe kryetari i Partisë, Sylejman Demirel.

Në zgjedhjet e vitit 1969, kandidoi si deputet i pavarur i Konias, duke u zgjedhur kështu si deputet i pavarur, ku e filloi zyrtarisht jetën politike.

Më 1970 themeloi "Partinë e Legalitetit Kombëtar" (Milli Nizam Partisi), e cila brenda një kohe të shkurtër u mbyll nga Gjykata Kushtetuese.

Me kuadrin e këtij partie themeloi më 11 tetor 1973 "Partinë e Shpëtimit Kombëtar" (Milli Selamet Partisi).

Në periudhën 1974-1978 kreu detyrën e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të ekonomisë në qeverinë e Republikës së Turqisë në tri qeveri të ndryshme koalicioni.

Gjatë kësaj periudhe politikat e tij ishin të drejtuara me interes të veçantë për Qipron, zhvillimin e industrisë së rëndë brenda vendit, arritjen e anëtarësimit me të drejta të plota në Konferencën Islamike, ngritjen e vlerave morale dhe edukimit shpirtëror të brezave të rinj si dhe e një rëndësie të veçantë ishte hapja e shkollave fetare me shpërndarje proporcionalisht të barabartë në tërë Turqinë.

Gjatë viteve 1978-1980 qëndroi në opozitë.

Pas grushtshtetit të 12 shtatorit 1980, u mbajt për një kohë nën vëzhgim në ishullin Uzunada, kurse më 15 tetor të atij viti, së bashku me 21 drejtues të "Partisë së Shpëtimit Kombëtar", u arrestua me akuzën e "shndërrimit të P.Sh.K. në shoqatë ilegale dhe sjelljes në kundërshtim me laicizmin".

Mori pafajësinë dhe u lirua më 24 korrik 1981.

Mbështetur në Kushtetutën e vitit 1982, iu hoq e drejta për t'u marrë me politikë për dhjetë vjet.

Më 1987 në bazë të referendumit kombëtar u rikthye në politikë dhe u bë kryetar i "Partisë së Mirëqenies" (Refah Partisi).

Në zgjedhjet e vitit 1991 u zgjodh përsëri deputet i Konias.

Në zgjedhjet e vitit 1995 "Partia e Mirëqenies", e drejtuar nga Prof.Dr. Nexhmetin Erbaka, fitoi 158 vende në parlament, duke u bërë kështu partia e parë në Turqi.

Pasi koalicioni i dy partive DYP-ANAP ("Rruga e Drejtë" e Tansu Çilerit dhe "Mëmëdheu" i Mesut Jëllmazit)

s'pati sukses, Erbakani ngriti qeverinë e koalicionit REFAHYOL me "Rrugën e Drejtë" të Tansu Çilerit dhe më 28 qershor 1996 mori detyrën e kryeministrit, duke u bërë kështu kryeministri i 54-të i Republikës së Turqisë.

Kjo u komentua në forma të ndryshme nga qarqet ndërkombëtare. Në shumë gazeta zunë vend titujt si "Kryeministër Islamik", "Lideri Islamik i Turqisë".

Kështu, për herë të parë në historinë e Republikës së Turqisë në krye të politikës dhe të shtetit turk dilte një parti dhe një kryeministër me vijë të deklaruar islamo-nacionale.

Gjatë drejtimit të qeverisë së 54-të të Turqisë, Erbakani me anë të reformave të ndryshme ekonomiko-financiare e shpëtoi Thesarin e Shtetit nga nevoja për borxh të brendshëm. Ekonominë e shtetit e futi në rrugën e zhvillimit dhe rritjes. U realizuan ngritje rrogash të njëpasnjëshme krahas rritjes ekonomike, kurse esnafët u mbështetën me kredi të leverdishme.

Erbakani e mbështeti zhvillimin ekonomik në kapitalin e Anadollisë, me prirje për zhvillimin e një ekonomie nacionale të pavarur ekonomikisht dhe politikisht nga vendet e huaja e sidomos ato perëndimore.

Për herë të parë në historinë e Turqisë, në këtë periudhë të udhëheqjes së Erbakanit, u realizua buxheti i ekuilibruar i shtetit.

Duke e hedhur vështrimin në Lindje, në basenin e afërt tokësor dhe detar të Turqisë, Erbakani themeloi organizatën ekonomike D-8 (Bangladeshi, Egjipti, Indonezia, Irani, Nigeria, Pakistani dhe Turqia) dhe u bë lider i saj. D-8 (Developing-8) ishte një organizatë që vepronte e koordinuar nga tetë shtete me popullsi shumicë muslimane dhe synonte përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të muslimanëve në mënyrë paqësore karshi 5 miliardë të popullsisë së botës.

Si pasojë e gjithë këtyre zhvillimeve, më 28 shkurt 1997, pas një përgatitjeje relativisht të gjatë skenarësh që kishin për qëllim diskreditimin ideologjik dhe politik të Erbakanit dhe partisë së tij, u krye grushti i shtetit i quajtur "postmodern"

Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar të Turqisë, Erbakani u vu në pozitë të vështirë që e detyronte të jepte dorëheqje. Në fakt, sipas protokollit të koalicionit, Erbakani duhet t'ia linte postin Tansu Çilerit, të cilën duhej ta mandatonte presidenti Sulejman Demirel, gjë e cila nuk u bë dhe mandati iu dha Mesut Jëllmazit.

Dy-tre muaj më vonë, më 21 maj 1997, kryeprokurori i shtetit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese të hapte çështjen për mbylljen e partisë "Refah"(Mirëqenia), e cila edhe u mbyll, ndërsa Erbakani u dënua me burgim shtëpiak për shkak të moshës së shtyrë.

Pavarësisht nga burgimi politik shtëpiak, Erbakani megjithatë veproi si një mësues dhe këshilltar jozyrtar i ishanëtarëve të Partisë për Mirëqenie (Refah Parti), të cilët në vitin 1997 e themeluan Partinë e Virtytit (Fazilet Partisi).

Partia e Virtytit (Fazilet Partisi) u gjykua si antikushtetuese në 2001 dhe u mbyll.

Deri në këtë kohë edhe dënimi me burgim shtëpiak i Erbakanit përfundoi dhe së bashku me shokët nga ish-Partia për Mirëqenie, themeluan Partinë Lumturia (Saadet Partisi).

Prof.Dr. Nexhmetin Erbakan udhëhoqi Partinë Lumturia (Saadet Partisi) gjatë viteve 2003-2004 dhe përsëri nga 2010 e deri në vdekje.

Prof.Dr. Nexhmetin Erbakan vdiq më 27 shkurt 2011, në spitalin Guven të Ankarasë, ku ishte i shtrirë në njësinë intensive që nga mesi i janarit.

Shkrimet nga Prof Dr.Nexhmetin Erbakan

Nëse duam të flasim për librat e Erbakanit na duhet që në këtë koleksion të librave t'i përmbledhim të gjitha shkrimet që Prof.Dr. Nexhmetin Erbakan i ka bërë në gjuhën turke dhe në gjuhë të tjera, punimet dhe hulumtimet shkencore, përkthimet në gjuhën turke.

Pra, duhet të kemi parasysh që kemi të bëjmë me një personalitet që ka dalë si më i miri në të gjitha shkollat që ka vijuar mësimet, për një vit e gjysmë i ka bërë tri teza të doktoratës, ka konstruktuar motorin e parë në Turqi, ka prodhuar automjetin e parë të Turqisë, ka qenë lideri i Milli Gurush-it për shumë vite dhe ka qenë Docenti më i ri në tërë Turqinë.

Kontributi me shkrime i Erbakanit është në sferat e ndryshme, si në ato shkencore dhe hulumtuese, po ashtu edhe në ato fetare islame dhe e kalojnë në numër shifrën 60. ■

Allahu e mëshiroftë dhe ia bëftë xhenetin vendqëndrim!

Kryeministri i Turqisë, Erdogan, mban në duar arkivolin e Erbakanit gjatë funeralit në Stamboll me 1 mars 2011

Nga e kaluara jonë

NJË TALENT QË PREMTONTE SHUMË

Gloria ALIAJ

Në radhën e kompozitorëve shqiptarë të shekullit të XX-të, Feim Ibrahimi është një artist dhe kompozitor i gjysmës së dytë të shekullit, i cili, përveç frymës së re që solli në muzikë, krijoi edhe vepra të veçanta, të cilat, pa diskutim, kanë një vlerë të madhe për kulturën tonë kombëtare.

Feim Ibrahimi lindi në Gjirokastër, në vitin 1935, në një familje me tradita muzikore të rrafshit kryesisht folklorik, gjë që lidhet edhe me gjeografinë e vendit ku jetonte familja. Sprovat dhe dëshirat e para mbi artin dhe muzikën i shprehu qysh në moshë të vogël, ndërkohë që do të vazhdonte me tej me praktika kompozicionale dhe kualifikime që do ta çonin drejt një rruge profesionalizmi të vërtetë artistik. Ibrahimi ishte ndër kompozitorët e parë shqiptarë të arsimuar në vendin e vet, i cili kërkoi me ngulm të çonte përpara mendimin intelektual dhe t'i jepte muzikës nota të qarta të zhvillimit të saj evropian. Përpjekjet për t'u larguar nga metoda e realizmit socialist dhe kufizimet e saj drejt liberalizimit të ideve mbi muzikën dhe praktikave zhvilluese të artit si dhe besimi te liria, qoftë edhe e penguar e artistit, ishin ndër parimet që e udhëhoqën gjatë gjithë jetës së tij krijuese. Nga kjo pikëpamje është i motivuar edhe ndikimi i madh që patën në krijimtarinë dhe zhvillimin e tij intelektual e muzikor, kompozitorët e mëdhenj të muzikës botërore të shekullit të XX-të si: B. Bartok, Stravinsky, Hindemith, etj..

Në përgjithësi, krijimtaria muzikore e F. Ibrahimit përbëhet nga: dy koncerte për piano dhe orkestër, dy rapsodi për orkestër, simfonia tragjike, simfonia për orkestër harqesh, tokata për piano, suita e filmit "Ngadhënjim mbi vdekjen", koncert për violonçel dhe orkestër, koncert për oboe dhe orkestër, baleti "Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë" etj… Secila nga këto vepra, përveç faktit që njohën më shumë se të tjerat kritikën ideologjike të kohës, u vlerësuan ndërkohë nga mjediset artistike e nga publiku dhe u bënë pjesë e

rëndësishme e repertorit bashkëkohor të muzikës shqiptare, si shfaqje e teknikave të reja kompozicionale, emancipimit të tingullit, ideve përgjithësisht të pavarura etj.. Madje, disa prej tyre janë vlerësuar edhe me çmime të rëndësishme në "Koncertet e Majit" dhe veprimtari të tjera të një rëndësie të veçantë.


Feim Ibrahimi

Njeriu që e luftonte mediokritetin

Ashtu si shumë kompozitorë të tjerë, shqiptarë ose të huaj, edhe Ibrahimi u përpoq që, përmes një metode të lirë dhe krejtësisht individuale, të pasqyronte në veprat e tij realitetin e artit shqiptar. Pra, u mbështet gjerësisht në muzikën folklorike dhe veçoi jo pak elemente të rëndësishme të saj, duke pohuar ndërkohë që këto lloj kompromisesh nuk i pëlqenin, kur ato bëheshin pjesë e një mendimi të kufizuar e skematik. F. Ibrahimi ishte i ndërgjegjshëm e i lirë, edhe kur shkroi rapsoditë e tij nr.1 e nr. 2, të cilat janë shenja të qarta identifikimi për stilin dhe mendimin e tij artistik. Pavarësisht nga ndjeshmëria që kishte mbi rëndësinë e këtyre dy veprave, ndjeshmëri që nuk e lejonte t'i konsideronte ndër më të mirat e krijimtarisë së tij dhe që, për më tepër, e bënte t'i nënvleftësonte cilësimet e tyre, me to ai tregoi një përfaqësim të veçantë në përballje me publikun artistik. Kjo, për shkak të melodive të thjeshta e lehtësisht të këndueshme, intonacioneve të bukura popullore, karakterit të gëzueshëm të valleve dhe përdorimit të kulturuar e profesional të strukturave të tjera folklorike.

Temat e rapsodive në koncertin e përgjithshëm estetik, ndërtohen sipas strukturimit formal të këngëve e valleve popullore. Ato janë të thjeshta, di-atonike dhe kanë më shumë një karakter vokal se sa instrumental, ndërkohë që zhvillohen kryesisht me mënyrat e variacionit timbrit orkestral, duke ndërruar njëratjetrën dhe duke formuar kështu, blloqe kontraste që realizojnë idenë e zhvillimit. Pikërisht këto veçori Feim Ibrahimi i ka ngritur në një nivel të dallueshëm profesionist, duke përdorur për këtë forma të qarta e të lira që përmbyllen me kadencat përfundimtare të reprizës.

Gjatë kërkimeve për zbulimin e personalitetit krijues të kompozitorit më ra në dorë libri "Vikama e tingullit", shkruar nga bashkëshortja e tij, Vera Ibrahimi dhe më duket me vlerë të shpreh se, përveç arritjeve profesionale, zemra dhe shpirti i tij human, të shfaqura edhe në këtë libër, me bëjnë të mendoj se çdo sakrificë e bërë në emër të artit të vërtetë, është një punë që asnjëherë nuk mund të shkojë dëm. Në fund, më vjen mirë të citoj disa fjalë të thëna prej tij, sërish në librin e sipërpërmendur: "Të paktën nuk do të bëhem pengesë që krijuesit të ecin përpara…, do t'i ndihmoj ata, por do të ndihmoj edhe veten time; do t'i bëhem barrierë mediokritetit… E di se nuk është e lehtë, madje shumë e vështirë, por do të luftoj... Nuk kthehem mbrapsht…"!

Vështrim kritik

NJË SAPUN JETE PËR TË GJITHA MOSHAT

Refleksion mbi veprën poetike të Nezir Sefajt: "Si ta kthesh botën në stinë?"

Naser SHATROLLI

Bota stinohet në jetë kur atdheu këndon këngë për botën e trokut të kalit me bisht të bardhë, që vjen për të zgjuar kombin se qenka rrezikuar nga gjumë i vjetër. Dhe atdheu i Gjinit të moçëm ka mbetur në një stinë të mbajtur mend. Gjini i njomë po e dashuron zogun e botës, edhe pse ai zog nuk po i jep qumësht të mjaftueshëm për të fluturuar vetë, për t'i dhënë qumësht jete gjumit të kombit të tij. Ai po ecën nëpër shtigje korbash, po shkel nëpër kitarën e zezë, po fluturon me mëndje nën kupën e qiellit, po e vrojton banesën e tij atje ku i ka vezët e stinës, vezët që duan të çelin botën e tij të re, botën që as ai se ka shijuar, botë që ka ngelur në stinën e fytyrës së tij, në thinjat e tokës së tij me ngjyra blu.


Një pëllumb i ri po gërgëllon në vargjet e Nezir Sefajt, një violinë plakë po kundërmon erë të keqe afër bërllog-hanit të kravatës së lakosur. Ai po ushqen vargun për të pasur jetë vargu në teatrin e filmit të pudrosur. Madona e tij shekullore po vjen nëpër vite, nëpër dhëmb nate për të bërë dritë me ngjyrë toke, për të bërë grim jete me aromë dheu. Dheu po bëhet ujë i pijshëm dhe s'po ka nevojë me kullu n'sitë të sherrit baltën. Kënga, balada, jehu i trokut, i sheshit, i bjeshkës, i zogut, i Ulqinit, i viteve të kalasë, i mjekrës së shprishur të Gjinajve, i nënës së sherrit, të cilës po i lutet mos me u rrëzu edhe pak, i mikut, i sojit e besës, konakut e dertit, të gjitha po dëshiron t'i rehatojë në vargun e rinisë së Gjinit të ri. Gjinin po e do aq shumë historia e re, se e vjetra po e shtyn të renë mos ta harrojë të vjetrën, e Gjini po fluturon çerdhe më çerdhe për hir të atdheut e dheut, për të fjetur me gjumin e Shqypnisë, në gjumin e atdheut të saj.

Një poezi po vjen, po vjen në formë oshtime nëpër Drinin e Zi, për t'i turbulluar rosat, dhe për ta zgjuar pulëbardhën, mjellmën e atdheut të përgjakur për ta larë me nota jete, me nota kënge, me nota zjarrmie, me lejen e besës së Jezuit. Në degët e kryquara ai po e mbaron çerdhen e botës së vet, për me i trasue kafshët e shumta që e kanë pushtuar qytetin e njeriut të ditur, që e kanë pushtuar mëhallën me dele të prera, me qenin e Sharrit të çakorduar nga lista e librave të Bulgakovit. Të gjithëve po ju fal vargje të ujitura me sy atdheu, me sy Shqipnie, me lot atdhetarie, me heronjtë e pudrosur në veglat e kuajve të zi që shkelin mbi telat e varrosur, mbi shallin e intelektualit që po flet me gjuhën e qetësisë. Bërllog-hanja po ja blen kalin atij për t'ia ndalur ecjen, për t'ia frikësuar librit kopertinat e lirisë së shkruar fërkaz. Heronjtë e jetës së tij po i përgatit për jehun e shpatës së thyer, duke i mashtruar me pare të lagëta. Jo more, e sotmja këtu nuk është, nuk shihet as nuk ka me u pa, se e sotmja është duke shkuar, po nesër kam frikë se s'kemi për ta kujtuar të sotmen se nuk e kemi kaluar të sotmen hala. Është pra, libri i radhës i Nezir Sefajt me mjekër të zezë, që vetëm bardhë mendon, por asnjëherë nuk i jep mundësi lëkurës së tij me pa dritën, se fajin e historisë e fsheh në mjekrën e tij, e mjekra është avokat i krijuesit. Ai po pi kupën e diellit ndër sy hëne, edhe dielli po i thotë gëzuar, jemi dy drita që ndriçojmë njëna-tjetrën dhe nga drita jonë po sheh populli për me vjedhë lirinë e tjetrit, këngën, dëshirën, ujdinë, besën, kokën, lapsin, ëndjen, qershinë, kullosën, drithin, atdheun e vet pe humb për atdheun e tjetrit.

Autori e shëron atdheun me vargje filozofike, me metaforë e mbulon çatinë e Gjinit. Në shtëpinë e metaforës fut kafshët për t'i mbuluar me baltë harrese, dhe ju jep ujë jete atyre që meritojnë arkën e mendjes. Në kupë e vendos dashurinë e Zotit dhe ua dhuron lejlekëve shtegtarë për ta çuar porosinë në botë. Stinë për stinë. Me veshje mosharrese i vesh malet e kohës për mos t'u mërdhiri nga i ftohti i brendshëm që vjen nga jashtë.

/dëgjojeni atdheun tek zgjohet/ atdheut, kurr mos e thuaj se mund t'ja lash borxhin/ djalë Gjini kush është/nga raftet do të heqim peshën tonë/ na është lodhur gjumi/ si toka na janë lodhur ëndrrat/djelmi e Kosovës mi shfaq edhe njëherë tingujt se ika të vdes Gjin/ rrethi familjar janë pleq e të rinj/llojet e dheut, i kuq, i zi, i verdhë,i hirtë, shkrifët/ truall ku lëvizin natyrshëm, kafshët, njerëzit, ujrat/

Një libër i radhës me përplot figura, qetësi e urtësi. Një stinë e re përplot me hava në poezinë e Sefajt po gurgullon. Heronjtë e tokës i ka kurorëzuar me gji mali në stinën e qershisë, stinë të cilën Gjini e dizajnon në trupin e vet me lëkurë qershie, njëherësh, vesh botën me kokën e fuqisë së magnumit, që kali i zi me bisht të bardhë, do të ecë trak-truk, duke lënë shenja nëpër hapat shekullorë motet që kanë shkuar e ato që do të vijnë. Pra, një libër përplot lakmi. Një sapun jete për të gjitha moshat, do të thosha. ■



Nezir Sefaj

SATANIZMI - IDEOLOGJI E DHUNËS

Festim RIZANAJ

I

Satanizmi që njihet si "adhurimi i djallit" është një prej ideologjive më torturuese dhe dhunuese në shoqërinë njerëzore. Satanizmi është një pjellë e hebraizmit, gjegjësisht ka lindur nga sektet e fshehta kabaliste hebraike. Gjer në shekullin e VIII-të është zhvilluar si një sekt i fshehtë hebraik, duke praktikuar magjinë e zezë. Më 1960, në Kaliforni të Amerikës, Andon Szandor Lavej, hebreu me prejardhje hungareze, themeloi satanizmin modern. Themelet e para i kishte vendosur satanisti britanik që njihej me nofkën "bishë" (The Beast 666), Aleister Crowley në fillim të vitit 1900. Filozofia e tij ishte 'bëj çka të duash'. Ai thoshte se kjo filozofi inspirohej nga djalli në shkrimin e librit The Book of Law (Libri i Ligjeve). Në vitin 1966, Lavej e shpalli veten themelues të 'kishës së djallit'. Edhe ky, si mësuesi i tij, mision kryesor e konsideronte shkatërrimin e religjioneve si besime në një Zot, ashtu që të kishte më shumë pasues të tij, të cilët do t'i shërbenin djallit.

"Satanizmi nuk është vetëm grup ateist, por edhe anti-teist (kundër Zotit)", - thotë ai.

II

Satanistët nuk besojnë në Zot, në engjëj, parajsë, ferr, librat e shenjtë, shpirt dhe djall. Besojnë vetëm në atë që është materiale. Kurse djallin nuk e besojnë, por e marrin si simbol për kundërshtimin e feve. Ata bazohen në teorinë e Darvinit se njeriu është një kafshë e evoluar. Në një nga postimet e Kishës së Djallit, ceket besimi i satanistëve: Satanistët nuk besojnë diçka mbi natyrën, ekzistencën e Zotit ose djallit. Për satanistët, njeriu është Zot i vetvetes.

Njëri nga priftërinjtë satanistë, Peter Gilmore, ka thënë: "Njeriu është një kafshë, prandaj detyrohet të jetojë si kafshë. Nga teoria e Darvinit janë ndikuar edhe fashizmi dhe komunizmi, që morën jetën e 120 milionë njerëzve. Duke u mbështetur në idetë e Nietzches u shfaq grupi neo-nazist. Lavey ka thënë: 'Nietzche ishte një satanist në mendimet dhe idetë e tij dhe ka ndikuar tek unë'.

Po ashtu edhe themeluesi i komunizmit, Karl Marks, gjatë studimeve në Universitetin e Berlinit, kishte shkruar poezi dhe i kishte emërtuar me ermin "Oulanem", emër që është përdorur në mistikë për djallin.

Hulumtuesi i satanizmit Jefrry Stefan konsideron se ekzistojnë shtatë shkallë të afrimit te satana.



Në shkallën e parë gjenden falltarët dhe ata që merren me magji, ndërsa në shkallën më të lartë janë Iluministët-"ithtarët e pastër të satanës".

III

Në shekullin e XIX-të, francezi me prejardhje hebraike, Elifas Levi, bëri simbolin që përdoret edhe nga "tempulli i djallit", ndërsa Lavey simbolin e Bafometit, që njihet si bricjap androgjen, gjysmë grua, gjysmë burrë. Simboli tjetër i rëndësishëm është "Pentagrami", ose Ylli Pesëcepësh, që njihet dhe jep pamjen e bricjapit të errësirës, Bafometit.

Satanistët kanë si ritual të tyre "meshën e zezë", që për herë të parë e hasim në fund të shek. të XVII-të dhe fillim të shek. të XVIII-të. Për kryerjen e këtyre meshave, satanistët kishin ftuar priftërinj katolikë, të cilët ishin përjashtuar nga kisha. Një nga këta, ish-prift, satanisti Gvidburg, përshkruan se si ishin mbajtur këto mesha. Femra lakuriqe shtrihej në krevat, duke lëshuar poshtë kokën dhe këmbët. Në gjoksin e saj vendosnin një peshqir me kryq, kurse në stomak vendosnin një gotë. Prifti Gvidburg, pastaj e priste me thikë fytin e foshnjës në barkun e nënës dhe e mbushte gotën me gjak. Trupin e fëmijës e ruanin, në mënyrë që nga ai, më vonë, të bënin pluhurin magjik.

Në shumicën e teksteve sataniste, muzika rok, e sidomos "Heavy Metal" (rok i rëndë) që njihet si 'klithma e satanës', paraqet një derilium ritual me të cilin adhurohet satana. 'Shfrytëzohet një ritëm, i cili i përgjigjet aktit seksual', - thotë John Tod hulumtues i satanizmit. Nëse njerëzit një kohë i nënshtrohen këtyre tingujve, ata më vonë bëhen më shqetësues, më depresivë e pastaj edhe më agresivë. Ai i cili ka durim t'i dëgjojë tekstet e kësaj muzike, shpejt do të përfundojë se mesazhi i tyre është: kundërvënia ndaj shoqërisë, prindërve dhe vlerave të tjera tradicionale. Që prej "mbretit të muzikës rok" Elvis Prisli, që ishte një narkoman dhe homoseksual, duke vazhduar me grupin legjendar "Beatles", pastaj Led Zeppelin, Rolling Stone, Metallica, The Eagles, Pink Flojd, etj. përveç muzikës shkatërruese japin edhe mesazhet e tyre të fshehta për adhurimin e satanës. P.sh. në kapakun e CD-së së grupit rok "Eagles" është fotoja e themeluesit të 'tempullit të djallit' Andon Szandor Lavej. Ka edhe grupe më ekstreme, të cilët koncertet i mbajnë ne vende të pista, me gjakderdhje, të errëta dhe gjatë koncertit grisin librat e shenjtë fetarë. Edhe në kinematografinë botërore kemi të inkuadruar në satanizëm.

Aktoret e bukura, të tilla si Xhejn Mansfield dhe Merilin Monro, për-

doreshin nga njerëzit e elitës si vegla seksi. Xhejn Mansfield merrte pjesë në ritulet satanike për të përmirësuar karrierën në Hollivud.

IV

Satanistët i kushtojnë kujdes të veçantë rinisë. Ata i premtojnë rinisë kënaqësi seksuale, pasuri, famë dhe ndikim ose fuqi. Hulumtuesi Jefrry Stefan shkruan: "Satanisti, pasi që vendos kontakt me një adoleshent, pas një kohe e thërret në takim ku i premton drogë dhe seks gratis. Pastaj e fotografon në situata komprometuese (të droguar dhe këtë e shfrytëzon për t'i bërë shantazh). Takimet zbavitëse "party" përcillen me muzikë të rëndë "heavy metal". Në një gjendje të tillë të dehjes narkotike, kjo muzikë depërton në ndërdije, në atë mënyrë që njeriu identifikohet me fjalët dhe ritmin e këngës, të cilën e përjeton.

Kur pyetet i riu se pse ka zgjedhur të bëhet satanist, disa përgjigje janë: "Jam i hidhëruar me Zotin pse mi ka marrë prindërit që kur isha i vogël". "Unë jam bashkuar me satanistët, sepse kërkoja paqe". "Kërkoja liri".

Të rinjtë që kanë probleme familjare, që nuk kanë harmoni në shtëpi, duke kërkuar harmoni diku tjetër bëhen pre e satanistëve. Së pari fillojnë duke sakrifikuar macet, lepujt dhe kafshë të tjera dhe duke ua pirë gjakun. Pastaj kalojnë edhe ekstreme më të mëdha, duke mbytur njerëz për satanën deri në vetëvrasje, pra duke sakrifikuar edhe vetveten se 'ne nuk i takojmë këtij vendi'.

Po cek rastin e dy të rinjve nga Los Anxhelosi:17 vjeçari Riki Kaso dhe 18 vjeçari Himi Trojano për vrasje rituale kishin zgjedhur si viktimë 17 vjeçarin Hari Lowers, duke e vrarë në mënyrën më mizore.

Problemet familjare, mosinteresimi për rininë, teoria e Darvinit, që po mësohet ende nëpër shkolla, muzika rok, droga, alkooli, etj. janë shkaktarë që rinia të përfundojë më së keqi, në satanizëm. ■



Hani e pini, po

Faktori më i rëndësishëm në shfaqjen e shumë sëmundjeve kronike (kancerit, sëmundjeve iskemike të zemrës dhe diabetit) pa dyshim është ushqimi. Statistikat tregojnë se rreth 30% e sëmundjeve të kancerit vijnë si rezultat i të ushqyerit të gabuar. Një ushqim i llojllojshëm, me një shumanshmëri në të ushqyer, paraqet plotësimin e të gjitha materieve ushqyese, vitaminave, materieve minerale dhe bioelementeve. Rëndësi të madhe ka që ushqimi të shijohet me masë pa e tepruar, për këtë është e këshillueshme që të ushqyerit të ndahet në tri deri gjashtë racione në ditë

Artan N. BEJTA

Ushqimi dhe obeziteti (mbipesha)

Dekadat e fundit kudo në botë është i pranishëm çdo ditë e më shumë obeziteti (mbipesha). Statistikat tregojnë se më tepër se 1 miliardë njerëz në botë janë sot me mbipeshë trupore, e prej tyre afërsisht 300 milionë janë të dhjamosur rëndë. Po ashtu, shifrat flasin se në Evropë, nga viti 1980 e këtej, kemi rritje të numrit të njerëzve me mbipeshë për 3 herë dhe se problemi më i madh është se ai po rritet edhe te fëmijët. Si një epidemi e re, obeziteti po pushton gjithnjë e më tepër në mënyrë të fshehtë njerëzit nga e gjithë bota, ndoshta për shkak të nënvlerësimit, paditurisë ose pasivitetit shoqëror. Me këtë problematikë, pa dyshim, po rriten edhe problemet e tjera shëndetësore dhe shoqërore.

Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e mbipeshës

Dy faktorët që më së tepërmi po kontribuojnë në paraqitjen e mbipeshës janë: stili i ri i të ushqyerit dhe stili i ri i aktivitetit.

Stili i ri i të ushqyerit - Sot në vendet ku është shfaqur mbipesha kemi një kequshqyerje që nuk lidhet me sasinë e konsumimit të ushqimit por me varfërinë, paaftësinë dhe paditurinë për të zgjedhur dhe blerë ushqimet e duhura dhe të mira për shëndetin. Pra, problem në paraqitjen e obezitetit nuk paraqet sasia e madhe e marrjes së ushqimit, sa paraqet cilësia, përbërja dhe gatimi e tij, si edhe kaloritë e mëdha që ato përmbajnë. Te shtresat e varfra, ose më mirë t'i quajmë grupet jo të favorizuara të shoqërisë, është shtuar ndjeshëm konsumimi i ushqimeve të pasura me produkte, të cilat direkt lidhen si faktorë të rrezikut për t'u shfaqur obeziteti (sheqernat dhe yndyrat shtazore), e po ashtu janë më të lira në çmim.

Një treg i lirë me një marketing të lartë gjithmonë krijon preferenca të reja ushqimore të popullatës. Një ndikim të madh, gjithashtu, ka edhe fakti se ushqimet e freskëta natyrale fruta, fibra, bukë të zezë, qumështi dhe produktet e tij po lihen pas dore, duke i zëvendësuar gjithnjë e më tepër me ushqimin e industrializuar, të gatshëm ose gjysmë të gatshëm (Fast Food, Sandviç, Coca Cola, Fanta, çokollata dhe pijet alkoolike), me shije të re e me kalori shumë të lartë e që kanë përbërje yndyrore, sheqerore dhe alkoolike.

Stili i ri i aktivitetit - Si faktor i dytë në paraqitjen e mbipeshës, pa dyshim, është stili i ri i jetesës që është përhapur viteve të fundit, që karakterizohet nga një aktivitet i pakësuar dhe, gjithashtu, nga një rehati muskulore e çrregulluar. Ndoshta fajtor është automobilizmi, që është duke e zëvendësuar ecjen e dikurshme me këmbë ose biçikletë, si edhe ashensori që e ka zëvendësuar ngjitjen në këmbë të shkallëve, duke shkaktuar kështu të ashtuquajturën "rehati fizike". Po ashtu, gjithnjë e më tepër po rritet qëndrimi i stërzgjatur para TV-së dhe kompjuterit, duke shkaktuar kështu pasivitet fizik në vend të lëvizjeve aktive, sporteve dhe punës.

E keqja e obezitetit

Duhet kuptuar një herë mirë se e keqja e mbipeshës nuk është vetëm estetike. Mbipesha është faktori kryesor në paraqitjen e shumë sëmundjeve të gjata dhe vdekjeprurëse. Bilanci i këtyre sëmundjeve, sot, në botë, është shumë i madh. Si rezultat i kësaj, sot në botë numërojmë rreth 600 milionë njerëz me hipertension arterial, 177 milionë

mos e teproni!

me diabet, 20 milionë me kancer dhe 20 milionë me sëmundje iskemike të zemrës e të arterieve të trurit. Statistikat botërore tregojnë se vdekjet e shkaktuara nga mbipesha janë shumë të mëdha. Sot, në botë, brenda vitit kemi rreth 7 milionë të vdekur prej sëmundjeve iskemike të zemrës, 5 milionë prej çrregullimeve vaskulare të trurit, 7 milionë nga hipertensioni, 7 milionë nga kanceri dhe 4 milionë të vdekur në vit nga diabeti.

Që ta largosh nga vetja këtë të keqe (mbipeshën) nevojiten vetëm masa të thjeshta, jo të kushtueshme dhe të realizueshme kudo, si dietat ushqimore dhe aktiviteti i përditshëm fizik.

Dieta ushqimore

Vajrat, yndyrat - Përdorimi i yndyrës në sasi të tepruar favorizon jo vetëm mbipeshën, por edhe shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme e posaçërisht arteriosklerozën (ngushtimin e enëve të gjakut). Për këtë arsye duhet të kemi kujdes nga yndyrat e fshehta, gjatë përdorimit të: prodhimeve të suxhukut, llojeve të djathërave të pasura me yndyrë, fërgimit (përgatitja me vaj të vluar), salcave me kajmak ose ëmbëlsirave. Vajrat bimore janë më shumë të pëlqyera se sa yndyrat e kafshëve. Gjërat ushqimore që përmbajnë kryesisht yndyrë të shtazëve, krahas shumë thartirave të tepërta yndyrore, janë të pasura edhe me kolesterinë. Për këtë arsye ju duhet të keni kujdes në përdorimin e tyre.

Ëmbëlsirat dhe gjësendet e kripura – Këto lloj ushqimesh duhet të shijohen me masë. Konsumimi i shpeshtë i sheqerit i dëmton dhëmbët dhe çon në shtimin e peshës. Për këtë arsyem ëmbëlsirat dhe pijet me sheqer duhet të shijohen me masë. Kripa e kuzhinës, pa dyshim, është faktor i rëndësishëm që ndikon në rritjen e shtypjes së gjakut.

Qumështi, prodhimet e qumështit, mishi dhe peshku - Për çdo ditë, me një ndryshim të koordinuar, duhet të hahet: mishi, peshku, vezët, djathi ose prodhime të tjera që përmbajnë hekur. Peshku, falë vlerës së lartë të yndyrave, zë një vend të veçantë në të ushqyerit e shëndetshëm. Për këtë shkak është i arsyeshëm përdorimi i 1-2 racioneve me mish peshku në javë. Qumështi, kosi, djathi dhe gjiza janë artikuj ushqimorë me një kualitet të lartë. Qumështi dhe produktet e qumështit do të duhej që të konsumoheshin disa herë në ditë.

Perime dhe pemë (5 në ditë me ngjyra të ndryshme) - Për të siguruar marrjen e vitaminave, materieve minerale dhe substancave sekondare të bimëve janë posaçërisht të rëndësishme perimet, pemët dhe sallatat e freskëta. Këto duhet të konsumohen 5 herë në ditë, duke u dhënë përparësi: *tri herë perimeve dhe dy herë pemëve*. Me përzgjedhjen e perimeve të larmishme do të merren materiet sekondare bimore të nevojshme për organizmin tonë.

Aktiviteti fizik - Dihet se aktivitetet trupore kanë ndikim pozitiv mbi shëndetin, forcojnë sistemin mbrojtës të organizmit, e vënë në ritëm sistemin e tretjes, rrisin harxhimin e energjisë, shmangin mbipeshën dhe forcojnë eshtrat. Në këtë mënyrë lëvizja mban gjendjen hormonale në rregull, ndihmon zhdukjen e stresit dhe zvogëlon rrezikun nga kanceri ose nga ndonjë sëmundje tjetër kronike.

Aktiviteti trupor nxit qarkullimin e gjakut në inde të zorrëve, e me atë edhe lëvizshmërinë e zorrëve (peristaltikën). Me këtë rast, materiet e përpunuara transportohen (barten) më mirë dhe nuk qëndrojnë gjatë në të njëjtin vend. Secili që bën aktivitet fizik ose që nget biçikletën së paku gjysmë ore në ditë, jep një kontribut të çmueshëm për shëndetin e tij.

Aktivitetet e përditshme, për secilën moshë, kërkojnë më së paku një gjysmë ore lëvizje në ditë, në formën e aktiviteteve të përditshme, me një intensitet mesatar. Ky propozim bazë premton një ndikim domethënës dhe të gjithanshëm në shëndetin dhe në kualitetin e jetës. Me intensitet mesatar nënkuptojmë çdo aktivitet trupor, gjatë së cilës njeriu së paku merr frymë më shpesh, por jo patjetër që të djersitet. Ecja e shpejtuar, ngasja e biçikletës ose shumë punë të kopshtit janë shembuj për këtë formë të lëvizjes.

Mbajtja stabile e peshës së trupit

Mbipesha dhe humbja e peshës mund të jenë problem serioz për shëndetin. Kilogramët e tepërta mund të humbin vetëm nëse stili i jetës kontrollohet mirë dhe shprehia e të ushqyerit dhe aktivitetit fizik respektohen për një kohë të gjatë dhe zbatohen në mënyrë të rregullt. Me këtë rast duhet pasur kujdes në uri dhe ngopje si dhe duhet të analizohet marrja e prodhimeve me një dendësi të madhe të energjisë. Në të kundërtën lejohen artikujt ushqimorë, që përmbajnë shumë ujë dhe pak energji dhe që hahen me ëndje. Këto janë mbi të gjitha perimet dhe pemët, por natyrisht edhe pijet pa sheqer. Qëndrimi i papërshtatshëm ndaj ngrënies si p.sh. ngrënia për shkak të monotonisë ose ngarkesës, shujtat e ngutshme ose ndryshimet në kohë të ngrënies duhet të shmangen. Energjia e shpenzuar mund të rritet kur aktivitetet trupore si: *marshimi i shpejtë, ngasja e biçikletës ose notimi* janë të përditshme.

Në këtë rast, marrja e energjisë shtesë duhet të zvogëlohet lehtë dhe harxhimi i energjisë me anë të lëvizjeve të rritet më shumë. Humbja e peshës duhet të rritet ngadalë dhe në kontinuitet (vazhdueshmëri), ndërsa sjelljet dhe shprehitë e reja duhet të bëhen si një përditshmëri në mënyrë afatgjate. ■



- Ëmbëlsirat dhe të gjitha pijet që përmbajnë sheqer duhet të shijohen me maturi. Konsumimi i shpeshtë i sheqerit i dëmton dhëmbët dhe çon në shtimin e peshës.
- Secili që bën aktivitet fizik apo që nget biçikletën së paku gjysmë ore në ditë, jep një kontribut të çmueshëm për shëndetin e tij.
- Pemët dhe perimet duhet të konsumohen 5 herë në ditë, duke u dhënë përparësi: tri herë perimeve dhe dy herë pemëve. Me përzgjedhjen e perimeve të larmishme do të merren materiet sekondare bimore të nevojshme për organizmin tonë.
- Përdorimi i yndyrës me sasi të tepruar favorizon jo vetëm mbipeshën, por edhe shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme e posaçërisht arteriosklerozën (ngushtimin e enëve të gjakut). Për këtë arsye duhet të kemi kujdes nga yndyrat e fshehta, gjatë përdorimit të: prodhimeve të suxhukut, llojeve të djathërave të pasura me yndyrë, fërgimit (përgatitja me vaj të vluar), salcave me kajmak ose ëmbëlsirave.
- Si një epidemi e re, obeziteti po pushton gjithnjë e më tepër, në mënyrë të fshehtë, njerëzit nga e gjithë bota, ndoshta për shkak të nënvlerësimit, paditurisë ose pasivitetit shoqëror. Me këtë problematikë, pa dyshim, po rriten edhe problemet e tjera shëndetësore dhe shoqërore.
- Që ta largosh nga vetja këtë të keqe (mbipeshën) nevojiten vetëm masa të thjeshta, jo të kushtueshme dhe të realizueshme kudo, si dietat ushqimore dhe aktiviteti i përditshëm fizik.


Kushtrim Lushtaku


Valdet Rama

OREBRO MBËSHTETET TEK SULMUESIT SHQIPTARË

Klubi suedez Orebro është përforcuar me dy sulmues shqiptarë nga Kosova,Valdet Ramën nga Mitrovica dhe Kushtrim Lushtakun nga Skënderaj. Që të dy kanë nënshkruar kontratë dyvjeçare, deri në janarin e vitit 2013

Alban BILALLI

Valdet Rama dhe Kushtrim Lushtaku janë dy emra të rinj me të cilët u përforcua kohët e fundit klubi i kategorisë së parë suedeze në futboll. Valdet Rama la Bundesligën gjermane, ligën e tretë më të fortë në botë, për të luajtur në futbollin suedez që është i një niveli shumë më të ultë se sa Bundesliga. Rama këtë nuk e vlerësoi si kthim prapa në karrierën e tij. Ai është shprehur se është larguar nga Bundesliga për t'u kthyer më i fortë pas dy vitesh. "Unë nuk e shoh kthim prapa në karrierë shkuarjen në Suedi, pasi Orebro do të garojë në Ligën e Evropës dhe aty mund t'i dëshmoj vlerat e mia. Orebro është një klub i mirë dhe jam i bindur se do të kem hapësirën e duhur. Për mua është një eksperiencë e re, por unë nuk do të kënaqem me pak sukses. Dua të shpërthej dhe të bëhem një ndër lojtarët më të mirë në Ligë", është shprehur Rama. Po ashtu, Rama është shprehur se është mërzitur duke qëndruar si rezervist te klubi i Hanoverit dhe nuk ishte e lehtë për t'u larguar nga Bundesliga. "Nuk ishte aspak e lehtë të largohesha nga njëra prej ligave më të mëdha evropiane, siç është Bundesliga. Unë kohëve të fundit humba durimin për të zënë vend në përbërjen e parë, prandaj edhe vendosa të largohem. Unë në një të ardhme të afërt e shoh veten sërish te ndonjë skuadër e Bundesligës. Bundesliga për çdo futbollist është ëndërr. Në kampionatin e Suedisë shkoj për të dëshmuar veten se jam futbollist që jap kontribut për skuadrën. Këtë do ta dëshmoj gjatë kohës që do të jem në Suedi", - ka thënë Rama.

Valdet Rama është reprezentues i Përfaqësueses së Kosovës. Ai më herët ishte edhe kandidat për t'u ftuar në ekipin e Shpresave (U-21) të Gjermanisë. Rama njihet si futbollist mjaft teknik dhe me goditje të mirë. Këtë stinor ka zhvilluar 10 ndeshje me skuadrën e dytë të Hanoverit që garon në Kategorinë e Katërt të Gjermanisë.

Edhe klubi suedez është shprehur mjaft i lumtur që arriti të nënshkruajë kontratë me sulmuesin nga Kosova."Valdet Rama është pikërisht tipi i lojtarit që po e kërkonim. Ai i ka kualitetet e duhura për ta përforcuar sulmin tonë. Mund të luajë në krahun e majtë të sulmit, por edhe në të djathtë dhe në qendër na ofron disa opsione. Ndër të tjera, ai ka luajtur në Bundesligën gjermane", - theksoi drejtori sportiv i Orebros, Lennart Sjogren.

Përforcimi tjetër i Orebros është sulmuesi nga Skenderaj, Kushtrim Lushtaku. 21-vjeçari, i cili deri më tani ishte pjesë e skuadrës nga Bundesliga 2, Munchen 1860, ka pranuar ofertën e Orebros, para asaj të Kalmarit. Drejtori sportiv i Orebronit është shprehur mjaft i lumtur nga ajo që ka parë në prova sulmuesin shqiptar dhe ka vendosur të nënshkruajë me Lushtakun. "Kushtrimi na la përshtypje të mira, si person dhe si futbollist. Nuk mund të presësh më shumë sesa që tregoi ai në periudhën sa qëndroi në prova këtu. Me këtë përforcim, ne do ta kompletojmë ekipin për sezonin e ardhshëm", - ka thënë drejtori sportiv i Orebros, Lennart Sjogren për uebfaqen suedeze na.se.

Lushtaku për transferimin e tij në Suedi është shprehur se klubi Orebro i ofroi kushte më të mira. "Është e vërtetë se Orebro më bëri ofertë konkrete dhe më të mirë sesa Kalmari dhe vendosa ta pranoj ofertën e Orebros. Jam i kënaqur me kushtet që më janë ofruar. Jam i kënaqur edhe me skuadrën për të cilën do ta jap maksimumin nga vetja. Shpresoj që nga Orebro të kaloj në klube akoma më të njohura evropiane", - është shprehur Lushtaku.

Lushtaku është shprehur mjaft i lumtur që në Orebro do t'i gjejë edhe dy futbollistët e tjerë nga Kosova, Denis Abdullahin dhe Valdet Ramën.

"Sigurisht se më vjen shumë mirë që do të luaj bashkë me Valdetin dhe Denisin. Valdetin e kam shok edhe më përpara, ndërsa tani jam njohur edhe me Denisin, i cili vërtet ishte një djalë shumë i mirë", - është shprehur Lushtaku. ■

HAPËSIRË PËR REKLAMIM NË REVISTËN 'PAQJA'!

Studio për prodhimin e kuzhinave

KezzA

5 VITE GARANCION

kkeza@hotmail.com
mob. +377 (0)44 141 909
tel & fax. +381 (0)38 243 863
Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes ***Raiffeisen Bank***

Made in Kosova



MEDICINE HOSPITAL INTERNATIONAL



Zemra juaj e sigurtë në duart tona

PËR HERË TË PARË NË KOSOVË ËSHTË **HAPUR**

KIRURGJIA E ZEMRËS

SPITALI SPECIAL PËR SËMUNDJE KARDIOVASKULARE

MAGJISTRALJA PRISHTINË SHKUP, PREOC, 10000 PRISHTINË

WWW.IMHKOSOVA.COM

MOB.: 044 936 720
TEL.: 038 500 601
FAX.: 038 500 601